

---

**SISTEMI ZGJEDHOR  
DHE PARTIAK  
NË KOSOVË**

---

**PERSPEKTIVA E ZHVILLIMIT  
TË DEMOKRACISË  
BRENDAPARTIAKE**

---







# **SISTEMI ZGJEDHOR DHE PARTIAK NË KOSOVË**

**PERSPEKTIVA E ZHVILLIMIT TË DEMOKRACISË  
BRENDAPARTIAKE**

**SISTEMI ZGJEDHOR DHE PARTIAK NË KOSOVË  
- PERSPEKTIVA E ZHVILLIMIT TË DEMOKRACISË BRENDAPARTIAKE**

**Publikuesi:**



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave - KIPRED  
Centar za monitoring i istraživanje CeMI

**Redaktor:**

Lulzim Peci

**Autorët:**

Mentor Agani  
Gent Gjikolli  
Albert Krasniqi  
Blerim Murtezi  
Violeta Haxholli

**Dizajni grafik:**

Studio Mouse – Podgorica, Montenegro

**Faqosja dhe printimi:**

Obscure Multimedia

**Tirazhi:**

300

**HEQJA DORË:** RRPP promovon hulumtimet shkencore në fushën sociale në Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mali të Zi dhe Serbi). Hulumti në shkencat sociale ndihmon në të kuptuarit e nevojave të reformave specifike të vendeve të rajonit dhe në identifikimin e implikimeve afatgjata të zgjedhjeve politike. Hulumtuesit marrin mbështetje përmes granteve kërkimore, metodologjike dhe trajnimeve tematike, si dhe mundësitë për krijimin e rrjeteve dhe nëpërmjet mentorimit rajonal dhe ndërkombëtar. RRPP koordinohet dhe drejtohet nga Interfaculty Institute for Central and Eastern Europe (IICEE) në Universitetin e Fribourg (Zvicër). Programi është plotësisht e financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Departamenti Federal i Punëve të Jashtme.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e SDC-së dhe Universitetit të Fribourg-ut.



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



**Regional Research**  
Promotion Programme | Western Balkans



UNIVERSITÉ DE FRIBOURG  
UNIVERSITÄT FREIBURG

**Mentor Agani  
Gent Gjikoili  
Albert Krasniqi  
Blerim Murtezi  
Violeta Haxholli**

# **SISTEMI ZGJEDHOR DHE PARTIAK NË KOSOVË**

**PERSPEKTIVA E ZHVILLIMIT TË DEMOKRACISË  
BRENDAPARTIAKE**



**BALKAN COMPARATIVE  
ELECTORAL STUDY:  
IMPACT OF PERSONAL VOTE  
ON INTERNAL PARTY DEMOCRACY**



# Përmbajtja

<b>HYRJE</b> .....	<b>7</b>
<b>RRETHANAT HISTORIKE</b> .....	<b>10</b>
<b>1. SISTEMI POLITIK</b> .....	<b>15</b>
<i>Mentor Agani</i>	
1.1. Rrethanat historike .....	15
1.2. Pavarësia pas shpërbërjes së Republikës Socialiste ederative të Jugosllavisë (RSFJ) – Aspektet legale .....	19
1.3. Sistemi aktual politik dhe rendi kushtetues në Kosovë – Autoriteti legjislativ dhe ekzekutiv.....	23
<b>2. SISTEMI PARTIAK</b> .....	<b>29</b>
<i>Gent Gjikolli</i>	
2.1. Baza juridike e formimit të partive politike .....	29
2.2. Zhvillimi i pluralizmit politik nga fundi i sistemit njëpartiak deri më sot .....	31
2.3. Partitë elektive .....	33
2.4. Partitë relevante .....	36
2.5. Koalicionet partiake .....	37
2.6. Proceset e brendshme në partitë politike .....	39
2.7. Rregullimi ligjor i financimit të partive politike.....	40
<b>3. SISTEMI ZGJEDHOR</b> .....	<b>47</b>
<i>Albert Krasniqi</i>	
3.1. Sistemi zgjedhor i kosovës.....	47
3.2. Njësitë zgjedhore.....	52
3.3. Tipat e fletëvotimeve .....	52
3.3.1. Për parlament.....	53
3.4. Përlllogaritja e votave në mandate.....	54
3.5. Përshtatshmëria e sistemit zgjedhor me standardet ndërkombëtare.....	55
3.5.1. Votimi i fshehtë.....	56
3.5.2. Votimi i përgjithshëm – Universaliteti .....	57
3.5.3. Votimi i drejtpërdrejtë .....	58
3.5.4. Votimi i barabartë .....	58
3.5.5. Votimi i lirë .....	59
3.5.6. Zgjedhjet periodike.....	60

<b>4. ORGANIZIMI I SUBJEKTEVE POLITIKE DHE DEMOKRACIA E BRENDSHME PARTIAKE.....</b>	<b>63</b>
<i>Blerim Murtezi</i>	
4.1. Korniza ligjore .....	63
4.2. Organizimi i brendshëm i subjekteve politike në Kosovë.....	64
4.3. Të drejtat dhe kufizimet e anëtarëve .....	66
4.4. Funksionimi dhe ndikimi i nivelit lokal.....	67
4.5. Roli i grave, të rinjëve, dhe komuniteteve në vendimmarrjen e partive politike...70	
4.6. Zgjedhja e kandidatëve për poste publike.....	72
4.7. Roli i liderit të partisë .....	74
<b>5. FUSHATA E ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE 2014 .....</b>	<b>79</b>
<i>Violeta Haxholli</i>	
<i>Asistentët hulumtues: Njomza Sejdullahu and Besart Zhuja</i>	
5.1. Kuadri ligjor për organizimin dhe financimin e fushatës parazgjedhore.....	79
5.2. Programet e subjekteve politike për zgjedhjet e qershorit.....	82
5.3. Ndikimi i vendimeve të qeverisë në fushatën parazgjedhore.....	86
5.4. Hapësira mediale për fushatën parazgjedhore të subjekteve politike .....	89
<b>PËRFUNDIM .....</b>	<b>91</b>
<b>Literatura.....</b>	<b>94</b>
<b>Lista e tabelave.....</b>	<b>105</b>
<b>KONTRIBUTET .....</b>	<b>106</b>



## **RRETHANAT HISTORIKE**

J.M. Colomer ka thënë se “sistemi efektiv elektoral për një qeveri demokratike përfaqësuese duhet të ketë rregulla për të dyja palët, si për përfaqësimin e partive ashtu edhe për përfaqësimin personal”. Vendet e Ballkanit kanë kaluar nëpërmjet një tranzicion demokratik të trazuar dhe shumë të dhunshëm, i cili ka rezultuar me sisteme politike të paqëndrueshme të dominuar nga partitë politike. Përfaqësimi partiak dominon mbi përfaqësimin personal. Partitë dominojnë mbi institucionet. Partitë e forta në kombinim me institucionet e dobëta janë duke e dëmtuar sundimin e ligjit. Udhëheqësia partiake është duke imponuar pushtet të fuqishëm, por në mungesë të legjitimitetit.

Për shkak të sistemit elektoral, përfaqësuesit janë më të përgjegjshëm ndaj udhëheqësisë partiake se sa ndaj qytetarëve të cilët i votojnë ata. Në mënyrë që të kemi përfaqësues më të përgjegjshëm, në mënyrë që të kemi udhëheqësi më të përgjegjshme partiake, zyrtarë shtetërorë më të përgjegjshëm ne duhet të kemi më shumë parti politike të demokratizuara. Qytetarët janë në kërkim të një ndikimi më të fuqishëm në përzgjedhjen e përfaqësuesve të tyre, anëtarët e partive politike kanë nevojë që të shtrijnë ndikimin e tyre më tepër në proceset e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të parlamentit, zyrtarët shtetëror dhe përzgjedhjen e udhëheqësisë së partive.

Ky projekt ka për qëllim që të hulumtojë ndikimin e sistemit elektoral në demokracinë e brendshme partiake dhe ndikimin e saj në sundimin e ligjit. Më saktësisht, ndikimi i personifikimit të sistemit elektoral në demokracinë brenda partiake dhe ndikimi i saj në përmbushjen e detyrave nga ana e zyrtarëve shtetëror të zgjedhur dhe të emëruar në sundimin e ligjit. Hulumtimi do të përfshijë katër shtete (Serbinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën dhe Malin e Zi).

Në të gjitha këto katër raste, sistemet elektorale janë duke prodhuar rezultate negative. Ky hulumtim do të ndihmojë që të hetohen dhe analizohen rezultatet negative që janë prodhuar nga sisteme të tilla elektorale, por gjithashtu edhe arsytet e problemeve të tilla dhe gjithashtu do të propozohen disa rekomandime të ndryshme të politikave. Hulumtuesit do të përpiqen që të gjejnë përgjigjet se përse sistemet e njëjta apo të ngjashme janë duke prodhuar rezultate të ndryshme në vendet me demokraci të konsoliduar krahasuar me ato vende me demokraci të pa-konsoliduar. Rezultatet do të kenë një rëndësi akademike, por gjithashtu do të ofrojnë edhe rekomandime konkrete të politikave për kohën kur të gjitha vendet janë në proces të shprehjes së interesit për reforma elektorale.

Ky projekt bie nën sektorin “Qeverisja dhe Decentralizimi” dhe ndërlidhet me temat e sundimit të ligjit, korrupsionit, moralit dhe politikës, praktikës kushtetuese dhe politike, përgjegjësisë demokratike dhe përgjigja e qeverisë lokale (dhe qendrore) si dhe legjitimiteti i institucioneve politike.

## HYRJE

Kjo pjesë e punimit tonë të përbashkët i ka pesë kapituj ku në mënyrë të njëpasnjëshme trajtohen sistemi politik, sistemi partiak dhe sistemi zgjedhor i Kosovës, si dhe demokracia e brendshme në partitë politike të Kosovës dhe fushatat që ato i bëjnë gjatë zgjedhjeve.

Në kapitullin hyrës, për sistemin politik, vëmendja është përqendruar në specifikat e zhvillimit historik të Kosovës që kanë ndikuar që përvoja e saj në ndërtimin e sistemit politik të sotëm të jetë e tillë çfarë ka qenë. Janë përmendur forcat politike dhe shoqërore që kanë ekzistuar në Kosovë para vitit 1989, mënyra si ato janë zhvilluar në vitet 1990, gjatë përpjekjeve për t'u pavarësuar nga Jugosllavia, si dhe ngjarjet kryesore nga aspekti juridik gjatë periudhës nga viti 1989 (shembja e komunizmit) e deri në vitin 2010 (vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008). Në pjesën e dytë, janë trajtuar disa nga aspektet më të rëndësishme të sistemit politik aktual të Kosovës, ku janë shikuar roli i Presidentit dhe ai i Parlamentit, si dhe specifikat e raportit midis pushtetit ligjvënës dhe atij ekzekutiv në kontekstin kosovar.

Sistemi partiak i Kosovës shqyrtohet në kapitullin e dytë, ku në fillim në mënyrë kritike përshkruhet dhe analizohet baza juridike e formimit dhe funksionimit të partive politike të Kosovës, dhe, po ashtu, jipet një përshkrim i shkurtër historik i zhvillimit të pluralizmit politik të saj që nga shembja e komunizmit e deri më sot. Më pas përmenden të gjitha partitë politike elektive të Kosovës me një përqendrim në partitë kryesore, ku përshkruhen faktorët kryesorë që kanë ndikuar në profilizimin politik të tyre: lufta e Kosovës (1999) dhe zhvillimet e brendshme që e kanë përcjellur periudhën para kësaj lufte (domethënë, mënyra si grupimet e ndryshme politike janë profilizuar dhe kanë filluar të trajtohen si “krahu i luftës” dhe “krahu i paqes”), si dhe faktorët e ndryshëm ideologjikë e politikë që në periudhën e pasluftës kanë ndikuar në kristalizimin e tyre në partitë e sotme politike të Kosovës. Në skenën politike të Kosovës nuk ka parti që janë aq të mëdha sa ta marrin pushtetin pa bërë koalicione me partitë e tjera, kështu që në këtë punim trajtohen edhe disa nga specifikat e krijimit të koalicioneve partiake. Po ashtu, në këtë kapitull trajtohen edhe specifikat më të rëndësishme të proceseve brendapartiake, posaçërisht të atyre që kanë të bëjnë me reformimin dhe demokratizimin e tyre të brendshëm, si dhe aspektet kryesore juridike që e rregullojnë financimin e partive politike dhe të fushatave të tyre zgjedhore.

Sa i përket kapitullit për sistemin zgjedhor, ky në fillim ofron përshkrimin e mënyrës si ky sistem ka ndryshuar në zgjedhjet e Kosovës – si është kaluar nga listat e mbyl-

lura në lista të hapura, së pari me 10, e më pas me 5 kandidatë – dhe i jep shkaqet që i kanë ndikuar këto ndryshime. Po ashtu, këtu përshkruhen dhe analizohen edhe pasojat e futjes së listave të hapura – në zgjedhjet e viteve 2010 dhe 2014, 39% të deputetëve të Kuvendit të Kosovës janë zgjedhur në saje të përvetësimit të listave të hapura. Përndryshe, sistemi zgjedhor i Kosovës i ka disa tipare që nuk kanë ndryshuar që nga fillimi i sistemit shumëpartiak: sistemi zgjedhor është proporcional, me një zonë të vetme zgjedhore, ku numri i ulëseve për minoritete është 20 nga gjithsej 120, dhe kuota gjinore është 30%. Në këtë kapitull shikohet si kanë ndikuar kombinimet e tipareve të sistemit zgjedhor që kanë ndryshuar dhe të atyre që nuk kanë ndryshuar që nga zgjedhjet e para (për shembull, çfarë pasojash në rrjedhat politike ka patur sistemi proporcional me lista të mbyllura, dhe çfarë sistemi proporcional me lista të hapura, etj.). Po ashtu, ky kapitull përshkruan edhe një varg çështjesh që kanë të bëjnë me sistemin zgjedhor të Kosovës: tipat e fletëvotimeve, përllogaritja e votave në mandate, përshtatshmëria e sistemit zgjedhor të Kosovës me standardet ndërkombëtare, si dhe disa tipare të votimit – votimi i fshehtë, i përgjithshëm, i drejtpërdrejtë, i barabartë, i lirë, etj.

Demokracia dhe demokratizimi i brendshëm i partive politike të Kosovës është një nga çështjet më të rëndësishme për demokratizimin e tërësishëm të Kosovës. Në kapitullin për demokracinë e brendshme partiake është theksuar që demokracia, si pluralizëm i alternativave politike është një përvojë e re për Kosovën, si dhe ajo që funksionimi i brendshëm i subjekteve politike është i përcaktuar nga forca të jashtme, të tilla si sistemi zgjedhor, kultura politike, rregullat e zgjedhjes, etj. Nga ky këndvështrim, kapitulli i përshkruan strukturat organizative dhe proceset e vendimmarrjes së brendshme të subjekteve politike të Kosovës, dhe analiza bazohet në katër subjektet kryesore: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Këtu analizohet korniza ligjore që ka të bëjë me proceset e demokracisë së brendshme, organizimi i brendshëm i subjekteve politike, të drejtat dhe kufizimet e anëtarëve të partive politike, funksionimi i subjekteve në nivelin lokal, roli dhe ndikimi i grave, të rinjve dhe i komuniteteve, etj. Një përqendrim i rëndësishëm është në funksionimin e brendshëm të partive politike kur fjala vjen te aspekte që janë shprehje e nivelit të demokracisë së brendshme: në përzgjedhjen e kandidatëve për postet politike, si dhe në rolin e liderëve partiakë në proceset e brendshme të partive të tyre politike.

Të gjithat që janë përshkruar dhe analizuar në kapitujt e deritashëm në një mënyrë të logjikshme çojnë në mënyrën në të cilën partitë politike të Kosovës i zhvillojnë fushatat e tyre parazgjedhore. Në fillim analiza bëhet nga këndvështrimi i zgjedhjeve të kaluara, ato të qershorit 2014, që çuan në një krizë qeveritare që zgjati për rreth gjysmë viti, deri në krijimin e Qeverisë së re në dhjetor 2014. Këtu

fushata zgjedhore, me vendimin e Komisionit Qendror Zgjedhor zgjati vetëm 10 ditë, mirëpo, subjektet politike aktivitetet e kishin filluar shumë më heret. Këtu ato i shfrytëzuan mangësitë e ligjit në fuqi për zgjedhjet e përgjithshme, që nuk i përcaktonte veprimet e parafushtës në një mënyrë eksplicite. Përqendrimi është edhe në mungesën e transparencës sa i përket financimit të fushatës – nga katër subjektet e mëdha politike të Kosovës (PDK, LDK, LVV, AAK), deri më sot vetëm dy prej tyre i kanë publikuar raportet financiare të fushatës në ueb-faqet e tyre zyrtare. Premtimet, programore dhe jo-programore, që u dhanë gjatë fushatës ishin tejet ambicioze, dhe shprehnin objektiva vështirë të arritshme – kishte premtime për rritje marramendëse ekonomike dhe të punësimit. Shtrirja e fushatës ishte kryesisht në baza rajonale, në bastionet kryesore të subjekteve politike përkatëse, me përpjekje të herëpashershme për zgjerimin e elektoratit në zonat e tjera. Këtu përmenden edhe disa nga mundësitë më të mëdha që i kishte PDK, në saje të asaj që para zgjedhjeve ishte partia në pushtet: për shembull, përgatitjet dukshëm më të hershme për fushatën zgjedhore, si dhe mbulimin më të mirë medial të aktiviteteve të saj zgjedhore. Në këtë kapitull temat që e kanë përqendrimin kryesor janë disa: korniza ligjore që ka të bëjë me fushatat zgjedhore, programet e partive politike, ndikimi i vendimeve të qeverisë në fushatën parazgjedhore, si dhe hapësira mediale për fushatën parazgjedhore të subjekteve politie.

Sa i përket përzgjedhjes së temave të shqyrtuara ky punim është një përpjekje për ta ofruar një analizë sa më gjithëpërfshirëse të aspekteve politike kosovare që kanë të bëjnë me partitë politike dhe me sistemin shumëpartiak. Ndërkaq, sa i përket mënyrës së trajtimit të këtyre temave, është bërë përpjekje që analiza e ofruar të jetë sa më e thellë dhe metodike. Në punimin e ardhshëm do të bëhet krahasimi i sistemeve shumëpartiake të disa vendeve të Ballkanit, ku të dhënat e këtij punimi, së bashku me ato të punimeve për vendet e tjera do ta vendosin sistemin shumëpartiak të Kosovës në kontekstin e Ballkanit Perëndimor.



Mentor Agani

## **PJESA E PARË**

# **SISTEMI POLITIK**





## **1. SISTEMI POLITIK**

### **1.1. Rrethanat historike**

Në këtë pjesë ne do të diskutojmë veçantitë e zhvillimeve historike në Kosovë, të cilat kanë ndikuar në shfaqjen e një sistemi shumë partiak në Kosovën e pas luftës, dhe në mënyrat se si ato kanë ndikuar në rrethanat në Kosovë, gjë që kanë bërë që përvoja dhe gjendja e saj të jenë të dallueshme kur krahasohet me atë të vendeve tjera rajonale, të cilat i kanë takuar ish bllokut komunist.

Së pari, ne do të përmendim rrymat sociale dhe politike që karakterizohen nga Kosova para rënies së komunizmit. Si pasojë e gjendjes së veçantë të Kosovës para vitit 1968, kanë ekzistuar dy forca kryesore politike-sociale brenda shoqërisë kosovare. E para, Lidhja Institucionale e Komunistëve të Kosovës (një degë e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë), dhe e dyta, lëvizja e grupeve të ndaluara të mbështetësve të regjimit të Enver Hoxhës në Shqipëri, e cila kishte prirje marksiste-leniniste. Duke pasur parasysh përmirësim të konsiderueshëm të gjendjes së shqiptarëve të Kosovës nga viti 1968 deri të paktën në vitin 1981, tendenca kryesore politike ka qenë përfitimi nga mundësitë që papritmas ishin shfaqur para kosovarëve (Agani, M. dhe Istrefi, 2011: 179-83). Këtu, arritja më e madhe ishte miratimi i Kushtetutës në vitin 1974.

Kjo gjendje përfaqësonte një tipar që e dallon përvojën e mëtejshme të Kosovës nga ajo e të gjitha vendeve të tjera që kishin dalë nga blloku komunist. Ndërsa në vendet e tjera ish-komuniste lufta politike gjatë periudhës pas vitit 1968 ishte në mes të komunistëve që ishin në pushtet dhe opozitës liberale dhe të çliruar që ishte përhapur në gjithë shoqërinë; në Kosovë, lufta vazhdoi në mes të komunistëve të Lidhjes së Komunistëve, të cilët ishin në pushtet dhe kishin ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt liberalizimit, dhe komunistët e tipit stalinist të cilët ishin të frymëzuar nga Shqipëria e Enver Hoxhës. Për më tepër, kjo ideologji ekstreme e majtë ishte në një masë të madhe e shprehur si patriotizëm (Agani, M. 2015: 5-8)

Pas demonstratave të mëdha të vitit 1981, përparimi i Kosovës në kuadër të Jugosllavisë filloi të zvogëlohet, si pasojë e politikave gjithnjë e më armiqësore që

po imponoheshin nga Serbia. Ky progres ka vazhduar për një kohë nga inercia, por shumë shpejt ai u përmbys. Duke pasur parasysh se Lidhja e Komunistëve të Kosovës dhe besueshmëria e saj në shoqërinë kosovare varej në një masë të madhe në këtë progres, rënia e saj i dha një mundësi të mirë grupeve marksiste-leniniste të përpiqen për të marrë mbi vete ndikimin shoqëror për çfarë kishin një dëshirë të zjarrtë. Kjo është ajo që ata bënë, dhe ndikimi i tyre mbi qëndrimet e shqiptarëve të Kosovës filloi të rritet. Reagimi i shqiptarëve të Kosovës drejt rritjes së politikave agresive të aplikuara nga Serbia ishte një gatishmëri në rritje për të pranuar qëndrimet agresive ndaj Serbisë dhe Jugosllavisë (Agani, M. dhe Istrefi, 2011: 179-85). Lidhja e Komunistëve të Kosovës po e kuptonte (deri në një masë të caktuar) se çfarë po ndodhte, dhe mund të ketë pasur përpjekje nga ana e tyre me qëllim të ndikimit për një zhvillim më të mirë, por ishte nën zgjedhën e Lidhjes së Komunistëve e Jugosllavisë, dhe në veçanti, të Serbisë, e cila nuk ishte e gatshme të pranonte asnjë gjë më pak, pos dorëzimit të plotë të Kosovës para kërkesave të saj.

Menjëherë pas shfaqjes së Memorandumit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Millosheviqi mori pushtetin dhe kjo ngjarje u përcoll me trazira në Mal të Zi dhe Vojvodinë, ku Millosheqi mori kontroll mbi regjimet e sapoformuara dhe të vogla. Pas kësaj erdhën ndryshimet e dhunshme me Kushtetutën e vitit 1974 në Kosovë, dhe me këtë, edhe premtimet e Millosheviqit si dhe kundërshtimet e Memorandumit në lidhje me Kosovën de fakto u përmbushën.

Megjithatë, kjo ishte një fitore shkatërrimtare për Serbinë. Para se gjithash, si pasojë e tërë këtyre ngjarjeve, lidhjet që po i mbanin njësitë federale të Jugosllavisë të bashkuara, tanimë ishin shkatërruar në masë serioze, dhe, në anën tjetër, koha nuk ishte e duhura. Pikërisht në kohën kur njësitë e përmendura federale iu nënshtruan kontrollit të Lidhjes së Komunisteve të Serbisë (e cila tashmë po udhëhiqej nga ana e Millosheviqit), Komunizmi filloi të shembet nëpër tërë Evropën Qendrore dhe Lindore. Dhe ky moment i ri u shfrytëzua në mënyrë të përsosur nga shqiptarët e Kosovës. Lidhja e Komunistëve të Kosovës u shpërbë brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore – në më pak se një javë. Dhe kjo u pasua gjithashtu me diskreditim të plotë të grupeve marksiste-leniniste, ndikimi i të cilave gjatë viteve 1980ta po rritej në mënyrë të vazhdueshme. Prandaj, në vitin 1989, këto grupe u tërhoqën në errësirë, dhe për këtë gjë mërita i takon dy faktorëve të mëdhenj (Agani, M. dhe Istrefi, 2011: 183-7). Së pari, hapja në mënyrë graduale e Shqipërisë Komuniste për të parë mjerimin e “parajsës” së regjimit stalinist të Enver Hoxhës. Dhe, e dyta, ngjarjet e mëdha që po ndodhnin në tërë ish vendet komuniste të Evropës po i tregonin haptazi të gjithë shqiptarëve të Kosovës rrugën që Evropa kishte zgjedhur (Agani, M. dhe Istrefi, 2011: 183-7).

Rrjedhimisht, në fund të vitit 1989, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) u shfaq si partia e parë politike jo-komuniste në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore.

Megjithatë, edhe shfaqja e LDK-së krijoi një gjendje që dallonte nga ajo e ish vendeve komuniste. Në këto vende tjera, kur (ish) partitë e tyre komuniste ishin larguar nga pushteti, ata kaluan në opozitë. Në Kosovë, të dy llojet e komunistëve në dispozicion u zhdukën përnjëherësh. Në thelb, në Kosovë, viti 1989 nuk shënoi kalimin nga sistemi një-partiak në një sistem shumë-partiak, por, përkundrazi, kalimin nga sistemi i majtë komunist një-partiak në një sistem një-partiak të djathtë (Agani, M., 2015: 5-8). Në të vërtetë, pas vitit 1989 krijimi i partive të reja politike ka qenë i lejuar, dhe ka pasur shumë që janë shfaqur gjatë kësaj periudhe kohore; megjithatë, në të dy zgjedhjet e organizuara në Kosovë gjatë viteve 1990, të gjitha këto parti të tjera së bashku nuk ka arritur të marrin më shumë se 3% të votave, në një situatë kur LDK-ja rregullisht po fitonte rreth 97-98% të tyre. LDK-ja paraqiste një kundërshtim ndaj regjimit të Millosheviqit dhe Serbisë – për sa i përket marrëdhënieve të brendshme në mes të Shqipërisë së Kosovës, marrëdhënia pozitive/opozitë nuk ka qenë ende e artikuluar, duke pasur parasysh faktin se nën tiraninë e regjimit të Millosheviqit të gjithë shqiptarët e Kosovës u bënë një.

Madje një veçanti dalluese për Kosovën ka qenë fakti se teksa në vendet e tjera ish komuniste shembja e komunizmit shënoi një triumf të shoqërisë civile, në Kosovë shoqëria civile filloi të zhvillohet pikërisht pas zhdukjes së komunizmit. Megjithatë, zhvillimi i shoqërisë civile në Kosovë ishte i shpejtë, dhe brenda një periudhe të shkurtër kohore shoqëria civile kosovare arriti suksese të shumta dhe të mëdha (Agani, M., 2012: 13-32). Disa faktorë kanë ndikuar këtu dhe ne do t'i përmendim vetëm dy. I pari, regjimi i Millosheviqit kishte marrë nën kontroll të gjitha institucionet në Kosovë, dhe si rezultat shqiptarët e Kosovës kishin mbetur jashtë tyre, që do të thotë se ata kishin mbetur në shoqëri, që shumë shpete e transformuan në një shoqëri civile të shkëlqyer. Dhe faktori i dytë, LDK-ja nuk po e njihte sundimin e Serbisë së Millosheviqit, kështu që as nuk u lodh që të bashkohej me institucionet politike – është e pamundur të veprohet nëpërmjet institucioneve që nuk i njeh fare. Prandaj, rruga e vetme që kishte mbetur për shqiptarët e Kosovës për artikulim politik të kërkesave të tyre ishte aktivizimi civil. Rrjedhimisht, brenda një kornize shumë të shkurtër kohore, shqiptarët e Kosovës arritën të organizojnë të ashtuquajturin “shtetin paralel”, në të cilin shumica e aktiviteteve të organizuara nga një shtet po kryheshin në baza vullnetare. Suksesi më i madh ishte në fushën e arsimit: gati për një dekadë, sistemi i arsimit në Kosovë, me më shumë se 400.000 pjesëmarrës, duke filluar nga kopshtet e fëmijëve deri në Akademinë e Shkencave dhe Arteve, puna po kryhej në baza vullnetare. Në të njëjtën mënyrë, ndoshta me sukses më të ulët, kishte arritje edhe në fusha të tjera si në ekonomi, sistemin shëndetësor, sistemin e mirëqenies sociale, etj. (Agani, M., 2012: 13-32).

Prandaj, reagimi i shqiptarëve të Kosovës ndaj shembjes së shtetit të Kosovës nga ana e Serbisë së Millosheviqit ishte të organizohej një shtet tjetër “paralel”, dhe ata

e bënë një gjë të tillë duke aplikuar një mosbindje të përgjithshme shoqërore dhe jo të dhunshme ndaj autoriteteve të Serbisë, në mënyrë që t'i shmangeshin konfrontimit ushtarak, për të cilin ata ishin në dijeni se nuk ishin të gatshëm. Në këtë lëvizje civile paqësore, shqiptarët e Kosovës po llogaritin se Jugosllavia ishte në shkatërrim e sipër për shkak të luftërave që po zhvilloheshin në vendet e tjera, dhe, në ndikimin e përshtypjeve nga rënia e komunizmit, ata kishin shpresa të mëdha se komuniteti ndërkombëtar do të gjente rrugën për t'i shpërblyer ata për rrugën paqësore që kishin zgjedhur të ndiqnin në një ambient tejet violent.

Megjithatë, kjo lëvizje jo e dhunshme e udhëhequr nga LDK-ja pësoi një goditje të madhe në Konferencën e Dejtonit, ku çështja e Kosovës nuk ishte marrë fare në konsideratë. Duke pasur parasysh se objektivi kryesor i lëvizjes jo të dhunshme qytetare të LDK-së ishte pavarësia e Kosovës, mos përfshirja e çështjes së Kosovës në këtë Konferencë u ofroi një mundësi të jashtëzakonshme grupeve të tërhequra marksiste-leniniste ta paraqesin LDK-në si të dështuar. Këto grupe shfrytëzuan këtë mundësi, duke filluar një fushatë për ndërprerjen e rezistencës paqësore dhe për fillimin e një rezistencë të dhunshme. Kjo çoi në përleshjet e para të armatosura me Policinë Serbe dhe Ushtrinë Jugosllave në vitin 1997, dhe në shfaqjen e UÇK-së (Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës) brenda skenës politike-ushtarake të Kosovës (Agani, M. dhe Istrefi, 2011: 179 -202). Në mesin e tyre ka pasur një numër të udhëheqësve, pakënaqësitë e të cilëve kundër LDK-së ishin në përmasa të barabarta me pakënaqësitë e tyre kundër Serbisë. Dhe, ajo që është më e rëndësishme, është shfaqja e UÇK-së, që në thelb shënon, jo vetëm fillimin e luftës kundër Serbisë, por, edhe, krijimin e parakushteve për skenën politike shumë partiake në Kosovën e pasluftës ( Agani, M., 2015: 5-9).

Duke pasur parasysh proporcionin në mes të krimeve të kryera në Bosnje dhe mosgatishmërinë e komunitetit ndërkombëtar për t'i parë ato duke u përsëritur në Kosovë, rritja e konflikteve ka çuar drejt rritjes së përfshirjes së komunitetit ndërkombëtar në zhvillimet në Kosovë. Në fund, komuniteti ndërkombëtar organizoi Konferencën e Rambujesë, me qëllim të përfundimit të konfliktit, i cili po rrezikonte të dilte jashtë kontrollit. Pas gati një muaji negociatash në mes të përfaqësuesve të skenës politike ushtarake të shqiptarëve të Kosovës dhe delegacionit Serbo-Jugosllav, përfaqësuesit kosovarë ranë dakord që të pranojnë dhe të nënshkruajnë Marrëveshjen e Rambujesë (Pëlqimin), ndërsa përfaqësuesit serb nuk pranuan që ta nënshkruajnë. Kjo çoi në kampanjën 78 dite të bombardimeve të Aleancës së NATO-s kundër Serbisë dhe Jugosllavisë, e cila filloi më 24 mars dhe përfundoi më 12 qershor 1999. Më 12 qershor, njësitë policore dhe ushtarake të Serbisë dhe Jugosllavisë filluan të tërhiqen nga Kosova, dhe kjo tërheqje vazhdoi për një javë, periudhë kohore gjatë së cilës trupat e Aleancës së NATO-s hynë dhe morën kontrollin mbi Kosovën.

## **1.2. Pavarësia pas shpërbërjes së Republikës Socialiste ederative të Jugosllavisë (RSFJ) – Aspektet legale**

Rruga e Kosovës drejt arritjes së pavarësisëF ishte e gjatë dhe e vështirë, dhe ishte përcjellë me vuajtje të mëdha. Faza përfundimtare e konfliktit të Kosovës filloi shumë më herët se sa konfliktet e vendeve të tjera të ish Jugosllavisë, dhe gjithashtu edhe përfundoi dukshëm më vonë. Ne mund të themi se gjendja e konfliktit ishte karakteristikë e Kosovës, të paktën, prej vitit 1981 deri në vitin 1999, ku intensiteti po ndryshonte nga niveli i një konflikti të ngrirë deri në gjendje luftime. Në këtë pjesë, ne do të fokusohemi në aspektet juridike të arritjes së pavarësisë së Kosovës, dhe ne do të përmendim dhe shkurt do të analizojmë disa nga ngjarjet kryesore të këtij procesi. Periudhën kohore që do të përfshijmë do të jetë ajo e vitit 1989 deri të paktën në vitin 2010. Arsyet për zgjedhjen e këtyre viteve do të qartësohet nga analiza në vijim dhe ngjarjet që do të diskutohen do të numërtohen.

1. Më 28 mars 1989 regjimi i Millosheviqit arriti të ndryshojë Kushtetutën e Kosovës. Ky ishte edhe një ndër qëllimet e tij të premtuara gjatë fushatës elektorale para se të vinte në pushtet. Në kundërshtim me ngjarjet e mëparshme të zhvilluara në Mal të Zi dhe Vojvodinë, ku këto dy njësi federale ishin vendosur nën kontrollin e Serbisë, zhvillimet në Kosovë dolën të jenë të përgjakshme. Shumë shqiptarë të Kosovës u vranë, qindra u plagosën dhe mijëra u burgosën si rezultat i dhunës që kishte shpërthyer si pasojë e kësaj ngjarjeje (Malcolm, 57-334 :2002). Kushtetuta që ishte miratuar ishte quajtur “Kushtetuta e Tankeve”, duke pasur parasysh se gjatë procesit të miratimit të saj, ndërtesa e Kuvendit të Kosovës ishte i rrethuar nga tanket e Ushtrisë Jugosllave. Kjo kushtetutë kishte hequr pothuajse të gjitha elementet e shtetësisë nga Kosova kishte pasur në bazë të kushtetutës së mëparshme, me përjashtim të faktit se Kuvendi i Kosovës kishte ruajtur pushtetin krijimit të kushtetutës në Kosovë.

2. Data 23 dhjetor 1989 shënon krijimin e LDK-së (Lidhjes Demokratike të Kosovës), e cila ishte partia e parë jo-komuniste e shfaqur në Kosovë qysh prej përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Shfaqja e LDK-së erdhi në një kohë kur konfliktet, të cilat më vonë sollën shpërbërjen e Jugosllavisë, kishin arritur majat e tyre. Menjëherë pas themelimit të saj, LDK-ja u bë përfaqësuesja më e madhe dhe e vetmja e aspiratave politike të shqiptarëve të Kosovës, dhe me vete solli plotësisht një ideologji dhe kulturë politike të re. Tipari më dominues i qasjes së saj ishte rezistenca aktive paqësore dhe civile ndaj masave të Serbisë. Qysh prej themelimit të saj dhe deri në arritjen e pavarësisë së Kosovës, LDK-ja ishte një ndër faktorët kryesorë në të gjitha proceset që u shfaqën në Kosovë.

3. Ashtu siç është përmendur, ndryshimi i Kushtetutës në mars të vitit 1989 nxori Kosovën në mënyrë të dhunshme jashtë çdo elementi të saj shtetëror; megjithatë, Kuvendi i Kosovës ruajti institucionin me të drejtën për të ndryshuar (si dhe për të miratuar) kushtetutën e Kosovës. Ky fakt u shfrytëzua nga deputetët shqiptarë të Kuvendit të Kosovës, të cilët, më 2 korrik 1990 u mbledhën pranë Kuvendit të Kosovës, dhe pas arritje së kuorumit, adaptuan Deklaratën Kushtetuese, me anë të së cilës Kosova u shpall Republikë brenda Jugosllavisë, që nënkuptonte se do të kishte status të barabartë me Serbinë dhe Malin e Zi (Malcolm, 2002: 334-57). Duhet të vihet në pah se kjo Deklaratë Kushtetuese njihet brenda shqiptarëve të Kosovës si Deklarata e Pavarësisë. Reagimi i Serbisë ndaj kësaj ngjarje ishte të shpallte masat emergjente.

4. Deklarata Kushtetuese e shpalli Kosovën Republikë të Jugosllavisë, por ajo nuk mbeti vetëm me këtë dispozitë. Kështu, rreth dy muaj pas shpalljes së kësaj deklarate, të njëjtët deputetë të Kuvendit të Kosovës u mbledhën në Kaçanik, më 7 shtator 1990, dhe në një takim që ishte fshehur nga autoritetet serbe, ata miratuan Kushtetutën e Republikës, të cilën e kishin shpallur dy muaj më parë. Serbia reagoi duke filluar përpjekjet për të ndëshkuar deputetët, të cilët, në ndërkohë, kishin ikur nga Kosova në emigracion. Pastaj, Serbia kishte mohuar vlefshmërinë e vendimit. Kuorumi i deputetëve në këtë takim u konfirmua.

5. Ngjarjet e mësipërme u pasuan nga organizimi i Referendumit Kosovar në lidhje me Pavarësisë (1991), krijimi i Qeverisë së Kosovës në ekzil (në Gjermani, 1991), dhe zgjedhjet e para dhe të dyta të brendshme kosovare që u zhvilluan në vitin 1992, respektivisht në vitin 1992. Në ndërkohë, u shfaq UÇK-ja, dhe Kosova u zhyt në luftë, dhe intensiteti i luftimeve ishte vazhdimisht në rritje (Malcolm, 2002: 334-57). Duhet të theksohet këtu se UÇK-ja do të paraqiste burimin e dy prej partive më të mëdha të Kosovës së pas luftës: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), të cilat u krijuan si opozitë ndaj LDK-së. Përkundër faktit se ata kishin prirje të majta, kundërshtimi i tyre ndaj LDK-së nuk ka qenë ideologjik, por më tepër një çështje se si pavarësia e Kosovës duhet të arrihej (Agani, M., 2015).

6. Rritja e intensitetit të luftës solli një rritje të përfshirjes së komunitetit ndërkombëtar në zhvillimet kosovare. Kjo eventualisht çoi në negociatat për zgjidhjen e konfliktit në Rambuje, Francë, në muajt shkurt-mars 1999. Pas gati dy muajsh bisedimesh, organizuar nga aktorët kryesorë të komunitetit perëndimor, versioni përfundimtar i Marrëveshjes së Rambujesë ishte zhvilluar dhe dhënë për nënshkrimin nga të dyja palët. Pas kundërshtimeve të shumta në tekstin e Marrëveshjes, përfaqësuesi i delegacionit kosovar nënshkroi dokumentin (Agani, F., 1999: 402-28); Delegacioni serb dështoi për ta nënshkruar atë, dhe, kjo, rrjedhimisht, çoi në fillimin e fushatës 78-ditore të bombardimeve të Serbisë dhe Jugosllavisë të zhvilluar nga Aleanca e NATO-s.

Teksti i marrëveshjes, i cili kishte dështuar përfshinte pjesë të cilat përkohësisht po e ruanin sovranitetin e Jugosllavisë mbi Kosovën – edhe pse Jugosllavia ishte detyruar që të tërhiqte trupat e saj nga Kosova – por gjithashtu aty përfshihej një dispozitë e cila thoshte se “tre vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, një takim ndërkombëtar do të mbahet për të përcaktuar mekanizimin e zgjidhjes përfundimtare për çështjen e Kosovës, duke iu nënshtruar vullnetit të popullit ...” (Marrëveshja e Rambujes, 1999). Kishte anëtarë nga radhët e delegacionit kosovar të cilët ishin të pakënaqur me faktin se atyre do t’u duhej që të prisnin për tre vite (edhe pse nuk ishte plotësisht e qartë se si do ta çlironin Kosovën për një periudhë më të shkurtër kohore se sa kjo – apo se si do ta çlironin Kosovën para se gjithash), dhe kjo ishte arsyeja se përse ata e shtynë nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. Në anën tjetër, delegacioni serb dhe ai jugosllav nuk ishin të kënaqur me idenë që zgjidhja përfundimtare e Kosovës, pas tre vitesh, do të duhej të bazohej në vullnetin e popullit – kjo nënkuptonte referendum dhe pavarësi për Kosovën pas tre vitesh (Agani, F., 1999: 402-28).

7. Fushata e bombardimeve të NATO-s përfundoi me nënshkrimin e dy dokumenteve: Marrëveshja Teknike Ushtarake e Forcave Ndërkombëtare të Sigurisë (KFOR) dhe Qeverive të Serbisë dhe Jugosllavisë (9 qershor 1999) dhe Rezoluta 1244 e KS së KB (Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara) (10 qershor 1999) (Rezoluta 1244 e KB, 1999).

Marrëveshja Teknike Ushtarake përcaktoi tërheqjen e të gjitha forcave të RFJ-së nga Kosova, dhe hyrjen e Forcave të NATO-s (KFOR) në Kosovë dhe në anën tjera Rezoluta 1244 themeloi UNMIK-un – Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara.

UNMIK-u u krijua me qëllim të administrimit të Kosovës pas tërheqjes së autoriteteve të Serbisë. Në pjesën hyrëse të Rezolutës 1244, KSKB riafirmon zotimin ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të RFJ-së, një detaj që është theksuar shumë herë nga Serbia, por të paktën, në dy vende tjera, kjo Rezolutë përmend zgjidhjen përfundimtare të Kosovës, në pajtim me Marrëveshjen e Rambujesë (Rezoluta 1244 e KB, 1999) – dhe këto, siç është përmendur, kanë pasqyruar që kjo zgjidhje do të ndodhte brenda periudhës kohore tre vjeçare, duke iu nënshtruar vullnetit të popullit të Kosovës.

Ekzistojnë disa rregullore të ndryshme që janë adaptuar nga UNMIK-u, por më të rëndësishmet janë dy: Rregullorja e muajit Janarit të vitit 2000, në lidhje me themelimin e Strukturës së Përbashkët të Përkohshme Administrative, e cila përfshinte themelimin e Këshillit Tranzitor të Kosovës, i cili përcaktoi fuqinë politike të Kosovës për të ardhmen e afërt, dhe Rregullorja e muajit Maj të vitit 2001, mbi Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, e cila i ktheu Kosovës strukturën kushtetuese.

**8.** Hapat më të rëndësishëm drejt pavarësisë së Kosovës filluan të paraqiten në vitin 2005. Në muajin qershor të vitit 2005, Sekretari i Përgjithshëm emëroi Ambasadorin Norvegjez, Kai Aide, si të Dërguarin e tij Special për të kryer një shqyrtim gjithëpërfshirës të situatës në Kosovë. Në shqyrtimin e tij të kryer në tetor 2005, Kai Eide ka vlerësuar se “ka ardhur koha për të kaluar në fazën tjetër të procesit politik.” Shumë shpejt pas kësaj, në nëntor të vitit 2005, Sekretari i Përgjithshëm më pas emëroi ish-Presidentin e Finlandës, Marti Ahtisaarin, si të Dërguarin e tij Special për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës. Parimet udhërrëfyese për këtë proces përcaktonin se “zgjidhja e negociuar duhet të jetë një prioritet ndërkombëtar.” Një numër i raundeve të negociatave pasoi gjatë periudhës shkurt - shtator të vitit 2006, në të cilin delegacionet e Kosovës dhe Serbisë diskutuan për çështjet relevante në marrëdhëniet e tyre (si decentralizimi, trashëgimia kulturore, objektet fetare, çështjet ekonomike, si dhe të drejtat e komuniteteve). Në muajin shkurt 2007 Marti Ahtisari paraqiti një projekt-propozim gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, dhe në mars 2007 u zhvillua raundi i fundit i bisedimeve në Vjenë për të diskutuar propozimin e Ahtisaarit. Nuk pati asnjë përparim shtesë gjatë këtyre negociatave. Në fund të marsit 2007 raporti i Ahtisarit iu dorëzuar KS të OKB-së. Në këtë raport Ahtisari theksoi se “pas më shumë se një viti të bisedimeve të drejtpërdrejta, negociata dypalëshe, dhe këshillimeve me ekspertë, është bërë e qartë se palët nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje mbi statusin e ardhshëm të Kosovës ... Është mendimi im i fuqishëm se potenciali i negociatave që të prodhojnë ndonjë rezultat reciprokisht të pranueshëm për statusin e Kosovës është tani i shteruar... Ka ardhur koha për të zgjidhur statusin e Kosovës. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të historisë së kohëve të fundit në Kosovë, realitetin e Kosovës së sotme, dhe duke marrë parasysh bisedimet me palët, kam ardhur në përfundim se e vetmja zgjidhje e zbatueshme për Kosovën është pavarësia, që do të mbikëqyret për një periudhë fillestare prej komunitetit ndërkombëtar” (Ahtisari, 2007).

**9.** Për kundër mosmarrëveshjeve në lidhje me çështjet e përmendura më sipër në KS të OKB-së, këto ngjarje shtruan rrugën për shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Kjo ishte ajo çfarë kishte ndodhur, më 17 shkurt 2008, dhe kështu Kosova filloi procesin e pavarësisë së mbikëqyrtur, duke u bazuar në planin e Ahtisarit, ku përfaqësuesit ndërkombëtar kishin funksione qeverisëse në krah me autoritetet kosovare. Pavarësia e mbikëqyrtur përfundoi në Shtator 2012 dhe Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) si dhe trupat paqeruajtëse të NATO-s vazhdojnë të mbesin në Kosovë.

Duke pasur parasysh faktin se ka pasur anëtarë të përhershëm të KS të OKB që kanë qenë kundër pavarësisë së saj, Kosova nuk është bërë anëtare e OKB-së. Në vend të kësaj, ajo filloi të mbledhë njohjet nga vende individuale – dhe deri më tani, prej 195 janë 111 vende, që janë anëtare të OKB-së, që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Përkundër këtij suksesi, Kosova përpara vetes ka vështirësi të konsiderueshme, dhe



ne do të përmendim vetëm dy që më të mëdhatë. Në mesin e vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën, ka pesë prej tyre që janë anëtare të BE-së, dhe kjo krijon një vështirësi të konsiderueshme për perspektivën e Kosovës për anëtarësim në BE. Nga ana tjetër, një pjesë e veriut të Kosovës është de facto më tepër e kontrolluar nga Beogradi, sesa nga autoritetet qendrore të Prishtinës, dhe kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme për funksionimin normal të Kosovës.

**10.** Në gusht 2008, Serbia ka kërkuar nga OKB-ja që të kërkojë mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND). Pyetja e parashtruar ishte: «A është shpallja e pavarësisë së njëanshme nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes së Kosovës në përputhje me të drejtën ndërkombëtare?» Kjo pyetje e hapi procesin gjyqësor që zgjati deri më 22 korrik 2010, kur mendimi i GJND-së ishte dorëzuar. GJND-ja konsideroi se Shpallja e Pavarësisë nuk kishte paraqitur shkelje të së drejtës ndërkombëtare, dhe, ndër gjërat e tjera të rëndësishme nga pikëpamja kosovare, ajo përcaktoi se Deklarata është lëshuar nga përfaqësuesit e popullit të Kosovës, duke vepruar jashtë institucioneve normale Përkohshme të Vetëqeverisjes (Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, 2010).

Si një përgjithësim i gjerë i këtij procesi, argumentet e Serbisë dhe përkrahësve të saj ishin se nuk ka asnjë dispozitë nga e Drejta Ndërkombëtare që i japin Kosovës të drejtën për të shpallur pavarësinë. Nga ana tjetër, argumentet e Kosovës dhe të mbështetësve të saj ishin se në të Drejtën Ndërkombëtare gjithashtu nuk ka asnjë dispozitë që e ndalon Kosovën nga shpallja e pavarësisë së saj. Në thelb, ky proces ligjor ishte një garë midis mendjeve të dy shteteve ligjore, njëra anë që e konsideron të drejtën ndërkombëtare si një “të drejtë”<sup>1</sup> ndërkombëtare, dhe ana tjetër që e konsideron të drejtën ndërkombëtare si një “ligj” ndërkombëtar.

### **1.3. Sistemi aktual politik dhe rendi kushtetues në Kosovë – Autoriteti legjislativ dhe ekzekutiv**

Për sa i përket sistemit politik, Republika e Kosovës është shumë partiake, parlamentare, përfaqësuese, republikë demokratike. Institucionet kryesore të pushtetit të sistemit politik të Kosovës janë Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës, dhe Presidenti i Kosovës. Qeveria e Kosovës, e cila ushtron autoritetin ekzekutiv në Republikën e Kosovës, është e përbërë nga ministra të qeverisë dhe Kryeministri

1 Në shumë gjuhë, përfshirë edhe atë serbe dhe shqipe, shprehja për të drejtën ndërkombëtare është përkthyer në mënyrë literare në gjuhën angleze si “international right” (“e drejtë ndërkombëtare” e që duhet të jetë “international law”)

i Kosovës, i cili është gjithashtu kreu i Qeverisë. Presidenti është kreu i shtetit dhe ai/ajo gjithashtu ka një rol në degën ekzekutive. Pushteti legjislativ është i ndarë në mes ekzekutivit (që është Qeveria) dhe Kuvendit të Kosovës. Gjyqësori është i pavarur nga ekzekutivi dhe legjislativi (Kushtetuta e Republikës së Kosovës).

Kuvendi i Kosovës është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli. Ai përbëhet nga 120 deputetë, të zgjedhur me votim të fshehtë, në bazë të listave të hapura, për një mandat katërvjeçar. Prej ulëseve 20 janë ato rezervuara, 10 për serbët e Kosovës, dhe 10 për pakicat e tjera të Kosovës. Ndër të tjera, Kuvendi miraton ligje, vendos të ndryshojë Kushtetutën (me 2/3 e të gjithë deputetëve të tij, duke përfshirë 2/3 e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara dhe të garantuara), miraton buxhetin e Republikës së Kosovës, ratifikon traktatet ndërkombëtare, zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit, zgjedh dhe mund të shkarkojë Presidentin e Kosovës, zgjedh Qeverinë dhe shpreh mosbesimin mbi të, mbikëqyr punën e Qeverisë, mbikëqyr politikën e jashtme dhe të sigurisë, jep pëlqimin për dekretin e Presidentit mbi shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, etj. Deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk mund të ushtrojnë asnjë funksion ekzekutiv. Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës shpallen nga Presidenti i Kosovës (Kushtetuta e Republikës së Kosovës). Presidenti i Republikës së Kosovës është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit. Ai/ajo përfaqëson Republikën e Kosovës, brenda dhe jashtë, i shpall zgjedhjet dhe, pas tyre, thërret mbledhjen e parë të Kuvendit, shpall ligjet dhe ka të drejtën e kthimit të ligjeve të miratuara (një kthim për ligj), nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare, udhëheq politikën e jashtme të vendit, është Komandanti Suprem i Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK), emëron Komandantin e FSK-së, emëron kandidatin për Kryeministër dhe për krijimin e Qeverisë, emëron dhe shkarkon Kryetarin e Gjykatës Supreme, vendos për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, etj. Presidenti i Kosovës zgjidhet nga Kuvendi, dhe ai/ajo duhet të marrë 2/3 e shumicës së të gjithë deputetëve, ose, nëse ky është nuk është rasti, ai/ajo duhet të marrë në votimin e radhës, shumicën e thjeshtë të të gjithë deputetëve. Në rast se Presidenti nuk zgjidhet në votimin e tretë, Kuvendi do të shpërbëhet, dhe zgjedhjet e reja do të lajmërohen (Kushtetuta e Republikës së Kosovës).

Qeveria e Kosovës, siç u përmend, ushtron pushtetin ekzekutiv dhe përbëhet nga Kryeministri, zëvendëskryeministri(at), dhe ministrat. Ajo zbaton ligjet e miratuara nga Kuvendi, propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme, promovon zhvillimin ekonomik, propozon projektligje në Kuvend, nxjerr akte juridike të nevojshme për zbatimin e ligjeve, propozon buxhetin, etj. Kryeministri përfaqëson dhe udhëheq Qeverinë, siguron që Ministrinë veprojnë në pajtim me politikat qeveritare, siguron zbatimin e ligjeve, drejton Këshillin e Sigurisë së Kosovës, emëron

Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, në bashkëpunim me Presidentin emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, etj. (Kushtetuta e Republikës së Kosovës).

Këtu në këtë pjesë të fundit ne do të përmendim shkurtimisht disa aspekte të marrëdhënies në mes të degëve të legjislativit dhe ekzekutivit në Kosovë, që kanë treguar të jenë paksa problematike në funksionimin e përditshëm të të dyjave. Së pari, ne do të diskutojmë disa aspekte të pozitës së Presidentit të Kosovës. Ekziston një përshtypje që posti i Presidentit është shumë i dobët krahasuar me atë të Qeverisë. Kjo është për shkak se aktorët e njëjtë politik që kanë krijuar Qeverinë, kanë rol themelor në emërimin dhe përzgjedhjen e Presidentit. Rrjedhimisht, në kontekstin kosovar, Presidenti shumë herë ka vetëm dy alternativa për përmbushjen e detyrave të tij/saj: në qoftë se Presidenti dëshiron të përmbush detyrat e tij/saj siç duhet, atëherë presidenti do të zbulojë se ai/ajo është i pafuqishëm; dhe nëse presidenti do që të krijojë përshtypjen e të qenit i fuqishëm, ai/ajo do të duhet (de facto) t'i nënshtrohet plotësisht Qeverisë. Kur këto situata shfaqen në pah, zgjedhja e shtruar para Presidentit është shumë e thjeshtë: Presidenti i pafuqishëm ose President i fuqishëm. I vetmi ilaç që mund të na vijë në mendje për këtë problem është që të kemi President të zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.

Çështja e dytë problematike në lidhje me postin e Presidentit është niveli i fuqisë së tij/saj ekzekutive, e cila është haptazi e dobët. Në të vërtetë, Presidenti është Komandant i Përgjithshëm i FSK-së, dhe ai/ajo ka të drejtë të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme, etj. Megjithatë, në kontekstin kosovar (prania ushtarake e bashkësisë ndërkombëtare përmes NATO-s), këto gjëra nuk kanë shumë rëndësi. Nga ana tjetër, emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës - një çështje me të vërtetë e rëndësishme – bëhet nga kreu i Qeverisë, që është Kryeministri. Tani - për të marrë vetëm një shembull të rëndësishëm - ka shumë çështje në Kosovë për sa i përket korrupsionit. Këto ankesa gjithmonë kanë të bëjnë me korrupsionin e Qeverisë, dhe asnjëherë nuk bien mbi korrupsionin e Presidentit. Nëse ata që janë më të dyshuar për korrupsion janë pikërisht ata që emërojnë kryesuesin e Policisë, pse duhet pra të befasohemi nga prania e vazhdueshme korrupsionit? Në të vërtetë, ekziston edhe gjyqësori, dhe, sipas Kushtetutës, është Presidenti, ai i cili emëron dhe shkarkon gjyqtarët, nga nivelet më të ulëta të Gjykatave, deri në Gjykatën Supreme. Megjithatë, gjyqësori është zinxhiri më i dobët në sistemin e pushtetit të Kosovës. Ka pasur shumë diskutime politike në lidhje me atë se pse gjyqësori kosovar është kaq i dobët dhe i çrregullt; megjithatë, nuk ka pasur përpjekje për të shpjeguar në mënyrë akademike dobësitë e gjyqësorit me aktivitetet e mundshme të qëllimshme të aktorëve brenda degëve të tjera të pushtetit, me qëllim të mbajtjes së gjyqësorit të dobët në lidhje me ato degët e tjera. Dhe, çështja e tretë është e lidhur me dobësitë e legjislativit në mbikëqyrjen e ekzekutivit. Kështu, një studim i kryer kohët e

fundit ka treguar se ekziston një nivel shumë i ulët i mbikëqyrjes së qeverisë nga ana e Kuvendit. Në të vërtetë, ky studim tregoi se «anëtarët e qeverisë ende nuk arrijnë të marrin pjesë në seancat plenare parlamentare apo mbledhjet përkatëse të komisioneve parlamentare.»

Në fund, sistemi shumë-partiak i Kosovës përbëhet nga parti të shumta, dhe asnjëri prej tyre nuk mundësi ta marrë pushtetin vetëm. Që nga përfundimi i luftës, nuk ka pasur zgjedhje, në të cilën ndonjë parti do të kishte fituar gjysmën e votave. Ndërsa ky tipar i sistemit politik kosovar mund të jetë i favorshëm për demokracinë - askush nuk është mjaft i fuqishëm për të bërë ndonjë gjë pa të tjerët - dhe një gjë e tillë gjithashtu krijon pengesa të cilat e bëjnë funksionimin e tij shumë të ngadalshëm. Kështu, për shembull, zgjedhjet e fundit parlamentare të qershorit 2014 u përcollën me një krizë politike, ku u desh gjysmë viti që të formohej Qeveria e re.

Gent Gjokolli

## **PJESA E DYTË**

# **SISTEMI PARTIAK**



## **2. SISTEMI PARTIA**

### **2.1. Baza juridike e formimit të partive politike**

Funksionimi dhe veprimtaria e subjekteve politike në Kosovë është e garantuar me Kushtetutën e Kosovës në kuadër të të drejtave dhe lirive themelore (Neni 44.1), ku garantohen edhe liria e asociimit që përfshin edhe të drejtën e çdo qytetari për të themeluar organizata, në këtë rast politike. Po ashtu, sipas nenit 45.1 të Kushtetutës së Kosovës, çdo shtetas i saj që ka arritur moshën 18 vjeç e gëzon të drejtën për të zgjedhë dhe për tu zgjedhur. Përfundimisht mund të ketë vetëm kur kjo e drejtë refuzohet me vendim gjyqësor.

Baza juridike për zgjedhjet në Kosovë është e përcaktuar nga Kushtetuta, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligji për Zgjedhjet Lokale, si dhe Ligji për Financimin e Subjekteve Politike, dhe këto e paraqesin legjislacionin primar. Përmes këtyre ligjeve organizmi i zgjedhjeve dhe veprimtaria e subjekteve politike rregullohen vetëm pjesërisht, pasi që pjesa më e madhe e kësaj bëhet përmes legjislacionit sekondar, me anë të rregullave zgjedhore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Deri më tani ky institucion ka nxjerrë 17 Rregulla zgjedhore, përmes të cilave rregullohen aspektet e zgjedhjeve, të regjistrimit të partive politike dhe të raportimit të tyre. KQZ përbëhet nga 11 anëtarë, ku katër vende janë të rezervuara për komunitetet, dhe është nga një anëtar nga çdonjëri nga gjashtë grupet më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend (KQZ, 2015). Mund të thuhet që formati i tanishëm i KQZ-së e favorizon pozitën kundrejt opozitës për shkak të dominimit në numrat përbërës prej 7 me 3, duke pasur gjithashtu parasysh katër anëtarët që vijnë nga radhët e komuniteteve, që zakonisht janë pjesë e koalicionit qeverisës.

Të gjitha procedurat e regjistrimit, raportimit, përmbajtjes së statuteve dhe organizimit të zgjedhjeve të brendshme të partive politike janë në kompetencë të KQZ-së, që këtë e bën përmes Rregullave të saj. Një ndër Rregullat më të rëndësishme të KQZ-së është Rregulla Nr. 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive

Politike. Në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (Neni 12.3, 64.2 a dhe b), si dhe atij për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Neni 14 dhe 20), KQZ ka themeluar edhe Zyrën për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike. Zyra që vepron në kuadër të KQZ-së është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit të partive politike, certifikimin e të gjitha subjekteve politike që do të përfshihen në fletëvotim dhe kufizimin e shpenzimeve të fushatave dhe dispozitave për deklarim financiar. (Zyra për RPPC - KQZ, 2015)

Mekanizmat që garantojnë respektimin e legjislacionit për funksionimin e partive politike nuk janë fuqizuar asnjëherë aq sa të jenë në gjendje ta monitorojë me efikasitet veprimtarinë e partive politike dhe t'i sanksionojnë partitë kur ato shkelin legjislacionin në fuqi, dhe kjo rrjedhimisht ka shpërfaqur edhe praktikat jodemokratike brenda partive politike (Krasniqi dhe Shala, 2012: 5). Sipas vlerësimeve të ekspertëve, Zyra për Regjistrimin e Partive Politike, si mekanizëm kontrollues dhe sanksionues që vepron në kuadër të KQZ-së, ka dështuar ta luaj rolin që duhet të ketë. Kjo ka ndikuar negativisht edhe te partitë politike pasi ato nuk janë ndjerë të obliguara t'u përmbahen kërkesave ligjore për funksionimin e partive. Intervistat e KIPRED-it me ekspertë zbulojnë që shkaku kryesor që kjo Zyre nuk performon siç duhet është mungesa e kapaciteteve. Zyra nuk ka personel të mjaftueshëm për t'i kryer detyrat që i kërkon ligji. Gjithashtu, vlerësohet se ka mungesë të integritetit profesional të stafit të zyrës, që di të përkulet para presioneve të politikës (Krasniqi dhe Shala, 2012: 16).

Procedurat për regjistrim kërkojnë që partitë politike të dorëzojnë kërkesën për aplikim, simbolin e partisë, të dhënat e përfaqësuesve të partisë, dokumentin e themelimit, së paku 500 nënshkrime të votuesve të regjistruar, statutin e partisë që duhet të jetë në përputhshmëri me kërkesat ligjore (Rregullore e KQZ-së, 2013: Neni 3), programin politik, deklaratën e fundit financiare, nënshkrimin e deklaratës për respektimin e Kodit të Mirësjelljes së Partive Politike si dhe ta bëjnë pagesën e taksës për regjistrim prej 500 Euro. Pas aplikimit, Zyra shqyrton kërkesat dhe në afat prej tridhjetë ditësh njofton KQZ-në për statusin e aplikimit. Nëse dokumentacioni konsiderohet i kompletuar, KQZ shpall njoftimin në gazeta si dhe në faqen e vet zyrtare në internet brenda shtatë ditësh. Çdo subjekt politik e ka të drejtën për të kundërshtuar kërkesën në bazë të arsyeve të paraqitura me shkrim në këtë Zyrë. Nëse ka kundërshtime, ato shqyrtohen dhe merret vendim për refuzim apo miratim të kërkesës. Në rast të refuzimit, partitë njoftohen me shkrim për arsyet e refuzimit. Brenda njëzet e katër orëve të ardhshme partitë mund të ushtrojnë ankesë në Komisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ndërkaq apeli duhet të vendoset brenda shtatëdhjetë e dy orëve pasi të jetë shpallur. Nëse nuk ka kundërshtime, atëherë konstatohet që nuk ka arsye për refuzim dhe Zyra brenda tre ditësh KQZ-së ia rekomandon regjistrimin e partisë politike. Pas regjistrimit, partia është



e obliguar ta mbajë Kuvendin brenda gjashtë muajsh nga data e regjistrimit, dhe ky Kuvend është i obliguar ta zgjedhë kryetarin e partisë dhe organin më të lartë ekzekutiv (Rregullore e KQZ-së nr. 1/2013, Neni 15.3).

Pra, siç e shohim, organizmi i zgjedhjeve dhe veprimtaria e subjekteve politike në Kosovë bëhet kryesisht përmes Rregullave zgjedhore të KQZ-së, dhe pjesërisht në bazë të ligjeve. Ndër prioritetet e reformave politike në Kosovë do të duhej të ishte fuqizimi i Zyrës për Regjistrim të Partive politike që ka mungesë kapaciteti, si dhe mungesë personeli e integriteti që do t'i shërbente për kryerjen e detyrave të parashtruara nga ligji, gjë kjo që do t'i mundësonte t'i sanksionojë partitë politike deri te ndalimi i pjesëmarrjes në zgjedhje. Gjithashtu, integriteti profesional i Zyrës në fjalë, që nuk do ta lejonte zmbropsjen para presioneve të politikës, dhe që do t'i mundësonte informimin e rregullt të opinionit publik, do ta luante një rol thelbësor në avancimin e demokracisë brendapartiake në Kosovë (Krasniqi dhe Shala, 2012: 17).

## **2.2. Zhvillimi i pluralizmit politik nga fundi i sistemit njëpartiak deri më sot**

Demokracia si pluralizëm i alternativave politike, është përvojë e re për Kosovën. Ndonëse sistemi shumëpartiak është instaluar në të njëjtën kohë kur pluralizmi politik është përhapur në tërë Evropën Juglindore, kushtet e represionit nën të cilin gjendej Kosova qysh prej heqjes së autonomisë së saj nga Serbia më 1989, nuk lejuan hapësirë për jetë të mirëfilltë politike pluraliste e demokratike. Edhe pse gjatë viteve 1990 në Kosovë vepronin shumë parti politike, këto nuk vepronin në një ambient që lejonte zhvillim normal të jetës politike dhe të demokracisë. Shqiptarët e Kosovës partinë e parë e themeluan më 23 dhjetor 1989, dhe kjo njihet si Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Partitë e tjera të themeluara në atë kohë ishin Partia Social-Demokrate e Kosovës, Partia Parlamentare e Kosovës, Partia Demo-Kristiane, Partia Fshatare, Partia Liberale, Partia Demokratike Turke, dhe Partia e Aksionit Demokratik e Boshnjakve të Kosovës (IKS, 2011: 70-85), që ndërtuan një sistem paralel të vetëorganizimit politik, jashtë sistemit okupues Serb me shpërfaqjen e një kuazi-sistemi pluralist. Baza ligjore e këtyre partive ishte Kushtetuta e Kosovës e vitit 1990 që lejonte të drejtën e mbledhjes së lirë dhe të organizimit të qytetarëve.

Përgjatë dhjetëvjetëshit të aktivitetit paralel politik, në Kosovë zgjedhjet u organizuan dy herë, në vitin 1992 dhe 1998, dhe që të dyjat u fituan me një numër shumë

të madh të votave nga LDK-ja. Përfundimi i luftës, ndërmejt viteve 1998 dhe 99, shënoi një kthesë të rëndësishme ku Kosova kishte një skenë politike që përbëhej prej LDK-së që në atë kohë thirrej në legjitimitet të zgjedhjeve të vitit 1998, dhe krahut tjetër politik, që thirrej krahu i luftës, dhe mbështetej në trashëgiminë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në atë periudhë së bashku me vendosjen e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), u krijua hapësirë e re për zhvillimin e pluralizimit politik dhe ndërtimin e institucioneve demokratike, si në nivelin lokal, ashtu edhe në atë qendror. Shumë nga partitë e vjetra vazhduan të vepronin, ndërkohë që u themeluan edhe parti të reja. Kësisoj, tranzicioni i mirëfilltë politik nga sistemi njëpartiak në sistemin pluralist në Kosovë filloi të ndjehej vetëm pas luftës. Ishte ky një tranzicion i vonuar për më shumë se një dekadë.

Që nga viti 1999, në Kosovë janë mbajtur pesë zgjedhje parlamentare, dhe atë në vitet 2001, 2004, 2007, 2010 dhe 2014. Dy zgjedhjet e para parlamentare të viteve 2001 dhe 2004 u administruan nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Zgjedhjet e vitit 2007 u monitoruan nga Parlamenti Evropian (Pack, 2007: 2), ndërsa zgjedhjet e vitit 2010 nga misioni ndërkombëtar për vëzhgim “Enemo” (Enemo, 2010). Zgjedhjet parlamentare të fundit për Kuvendin e Kosovës të vitit 2014, si zgjedhje të dyta parlamentare që u mbajtën pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, ishin zgjedhjet e para parlamentare që u mbajtën në tërë territorin e vendit sipas ligjeve të Kosovës. Kjo ishte rezultat i Marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve Beograd-Prishtinë të 19 prillit të vitit 2013 (EEAS, 2013).

Në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës që u mbajtën në vitin 2001, pjesëmarrja në votime ishte 64% ku u zgjodhën 100 deputetë, kurse 20 vende ishin të rezervuara (Zgjedhjet e Përgjithshme - KQZ, 2015). Në këto zgjedhje LDK doli e para me 46%, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 26%, koalicioni serb “Kthimi” 11%, kurse Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) doli me 8% të votave (Crisis Group, 2001: 9). Zgjedhjet e dyta parlamentare u mbajtën në tetor 2004 ku pjesëmarrja në votime ishte 51%, dhe këto sërish e konfirmuan LDK-në si partinë e parë me 45%, të përcjellur nga PDK-ja me 28%. Ndërkohë, sistemi shumëpartiak në Kosovë po formësohej gradualisht, dhe ky dita-ditës e shënonte heterogjenitetin në rritje të partive të vogla që përfaqësonin grupe diversive të shoqërisë. Në mesin e 17 partive politike që garuan, kishte edhe parti të reja nga radhët e minoriteteve si serbët, turqët, boshnjakët, si dhe nisma qytetare (Zëri i Amerikës, 2010). Ndërkaq, zgjedhjet e vitit 2007 u mbajtën më 17 nëntor, dhe në to për herë të parë u vendos ‘pragu elektoral’ prej 5%. Pjesëmarrja e përgjithshme ka qenë 40.10% kurse PDK ishte partia me më së shumti vota, me 34.%, LDK me 22.6% si dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AKR) me 9.6% (Zgjedhjet e Përgjithshme - KQZ, 2015).

Më 17 shkurt 2008 Kuvendi i Kosovës shpalli Pavarësinë e Kosovës, dhe me këtë u hapën edhe dyert për kalimin e të gjitha kompetencave shtetërore tek institucionet vendore. Faza e pas-pavarësisë u karakterizua me ngritjen e institucioneve të tjera shtetërore që më parë nuk kishin ekzistuar apo kishin qenë të administruara nga misionet ndërkombëtare. Ky hap i konsolidimit demokratik e institucional njëkohësisht u shfaq edhe si sfidë e madhe për shoqërinë kosovare.

Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, u mbajtën dy zgjedhje parlamentare, në vitet 2010 dhe 2014. Në zgjedhjet e vitit 2010, pjesëmarrja e votuesve ishte 45%, dhe PDK sërisht fitoi zgjedhjet me 32%, LDK u radhit e dyta me 27%, ndërkaq Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me 13% si subjekt i ri politik garoi për herë të parë në zgjedhje. (KQZ, 2011: 2). Ndërsa, në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2014, pjesëmarrja e votuesve ishte 43%, ku PDK së bashku me partitë tjera të koalicionit parazgjedhor fitoi zgjedhjet me 30% të votave të përgjithshme, ndërsa LDK doli e dyta me 25% dhe LVV grumbulloi 13% të votave (KQZ, 2014: 2).

Ishte e pritshme që në këtë periudhë më të maturuar politike, zhvillimi ekonomik dhe orientimi programor dhe ideologjik i subjekteve politike të fillojë të artikulohej në mënyrë më koncize, dhe që me këtë skena politike në Kosovë do të konsolidohej edhe më mirë. Mirepo, konsolidimi dhe profilizimi ideologjik i partive politike në Kosovë nuk ishte i lehtë. Pengesë kryesore e këtij procesi ka qenë faza emergjente e rindërtimit ekonomik e social në të cilin shoqëria kosovare u gjet pas luftës. Përballja me nevojën e menjëhershme për rindërtim fizik të vendbanimeve, plotësimi i nevojave emergjente për mbijetesë fizike – në ditët e para të pasluftës – si dhe konsolidimi i institucioneve vendore, pa pasur ende kohë për t'u përqendruar në zhvillim ekonomik dhe të politikave sociale në vitet pas fazës emergjente, si dhe çështja e pazgjidhur e statusit të Kosovës, kanë bërë që partitë politike të mos jenë në gjendje të përpilojnë dhe garojnë me politika rreth çështjeve thelbësore (Krasniqi dhe Shala, 2012: 9).

### **2.3. Partitë elektive**

Skena politike e Kosovës e viteve 90-të trashëgoi vetëm LDK-në si parti që e vazhdoi funksionimin e saj të plotë dhe dominant edhe pas luftës e deri më sot. Partitë e tjera si Partia Social-Demokrate e Kosovës, Partia Parlamentare e Kosovës, Partia Demo-Kristiane, Partia Liberale etj, ose u shuan, ose mbetën me ndikim minimal, apo, thënë ndryshe, kanë mbajtur gjallë vetëm ekzistencën e tyre. Është i një rëndësie të veçantë viti 1999 i cili edhe sjelli ndryshime rrënjësore në skenën politike

pluraliste të Kosovës. Në këtë vit ndodhi ndarja e madhe në partitë që thirren në përfaqësimin e trashëgimisë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kundrejt krahut tjetër 'paqësor', të udhëhequr nga LDK-ja. Është kjo periudha që edhe sot e tutje vazhdon të mbizotërojë në Kosovë, edhe pse në ndërkohë janë shfaqur subjekte të tjera të rëndësishme politike, si LVV që nuk identifikohet me asnjërin nga dy konceptet e lartpërmendura politike, apo AKR që ishte në koalicion qeverisës me PDK-në gjatë viteve 2014-2010 dhe tenton të promovojë planet për zhvillim ekonomik më shumë se çdo koncept tjetër politik. Sidoqoftë, edhe përkundrejt këtij rivaliteti të koncepteve në vitet e pasluftës, këto parti dallimet mes tyre nuk i kanë parë si pengesë për formim të koalicioneve qeveritare, si AAK – LDK pas zgjedhjeve të vitit 2004, apo PDK – AKR në vitin 2010, si dhe dy koalicionet paszgjedhore mes PDK-së dhe LDK-së në vitet 2007 dhe 2014. Edhe pse me numër të vogël të banorëve, bazuar në të dhënat e KQZ-së, numri i përgjithshëm i subjekteve politike të certifikuara për të marrë pjesë në zgjedhjet e fundit qendrore (2014) ishte 30 (tridhjetë), dhe prej tyre, 18 ishin parti politike, 7 nisma qytetare, 1 kandidat i pavarur, dhe 4 koalicione (Koha, 2014). Nga partitë pjesëmarrëse në zgjedhjet e fundit, 23 ishin parti të vogla që numërojnë nga 2,500 deri në 7,500 votues (KQZ, 3-2 :2014). Gjithashtu, në 20 vitet e fundit në Kosovë janë krijuar dhe shuar një numër i partive politike që janë udhëhequr kryesisht nga grupe të vogla intelektuale të vendit, si p.sh. Partia Parlamentare e Adem Demaçit, e Rexhep Qosjes (DBD), pastaj e Veton Surroit (ORA), e Shpend Ahmetit dhe Ilir Dedës (FER), e kështu me radhë (IKS, 2011: 70-85). Gjithashtu edhe në ditët e sotme kemi formim të subjekteve të reja, grupe këto që përfaqësojnë interesa të ndryshme shoqërore dhe që kryesisht ndërlidhen me çështje etnike apo fetare. Në anën tjetër është shumë i shprehur krijimi marrëdhënieve klienteliste në mes të partive politike dhe elektoratit kosovar, duke pasur parasyh faktin që mbi 30% të popullsisë së Kosovës (144,829 veta) janë të papunë (ASK, 2013: 9). Lidhja e elektoratit me parti politike është duke u bërë më tepër për shkaqe të përfitimeve personale se për shkak të bindjeve politike, meqë kjo në realitetin kosovar krijon avantazhe dhe privilegje në punësimin në sektorin publik. Më poshtë është e dhënë lista e plotë e të gjitha subjekteve politike me numrat e tyre përfaqësues me të cilët kanë garuar në zgjedhjet e fundit qendrore (2014).

**Tabela 1:** Partitë garuese në zgjedhjet qendrore, 2014

31 Partia Liberale Egjiptiane
32 Partia Demokratike e Ashkalive
33 Progresivna Demokratska Stranka
34 Partia Rome e Bashkuar e Kosovës
35 Lëvizja Vetëvendosje
36 Koalicija Vakrat
37 Partia e Fortë
38 Srpska Lista
39 Pokret za Demokratski Prosperitet
40 Aleanca Kosova e Re
41 SocialDemokratija
42 Kosovaki Nevi Romani Partia
43 Boshnjačka Jedinstva Lista
44 Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
45 Hasan Gashi
46 Nova Demokratska Stranka
47 Iniciativa e Re Demokratike
48 Koalicija za Gora
49 Partia e Ashkalive për Integrim
50 Stranka Demokratske Akcije
51 Centar Demokratke Unije
52 Kosova Turk Adalet Partisi
53 Bosnjačka Stranka Demokratske Akcije Kosovo
54 Lidhja Demokratike e Kosovës
55 Pokret za Gora
56 Samostalna Liberalna Stranka
57 Kosova Demokrati Turk Partisi
58 Partia Demokratike e Kosovës, Partia e Drejtësisë, Lëvizja për Bashkim, Partia Shqiptare Demokristiane
59 Nisma për Kosovën
60 Lëvizja e Grupimit Tradicional Shqiptar

*Burimi: Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve*

## 2.4. Partitë relevante

Njësoj si dhe gjatë të tërë periudhës së pasluftës, edhe në skenën e sotme politike të Kosovës kemi dominim të dy subjekteve politike, të PDK-së dhe LDK-së, që e kanë përqindjen më të lartë të votuesve, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal. Edhe pse këto dy subjekte njëkohësisht i përfaqësojnë edhe dy krahët e ndryshëm konceptual politik – PDK-ja krahun e luftës, dhe LDK-ja atë 'paqësor' – këto që të dyjat ideologjikisht thirren në të djathtën.

Ideologjia e subjekteve të tjera me baza elektorale më të mëdha, që janë të përfaqësuara në Kuvendin aktual të Kosovës, si LVV dhe Nisma për Kosovën është e deklaruar si e qendrës së majtë, ndërsa subjekti tjetër relevant, AAK-ja, është i deklaruar si i qendrës së djathtë (Malazogu dhe Gautam, 2014: 5). Marrë në përgjithësi, mund të thuhet që në skenën politike kosovare ka dominim të deklarimit djathtist të subjekteve politike. Gjithashtu, edhe nga aspekti i historikut ideologjik të subjekteve politike në Kosovë, etablimi i tyre në kuadrin e kuadratit të dëshiruar ideologjik ishte po ashtu i vonuar, meqë sfidat për subjektet dhe udhëheqjen kosovare ishin Standardet para Statusit, detyra këto të përcaktuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (dokumenti "Standardet për Kosovën" që iu dorëzua autoriteteve kosovare përmbante 8 pika) (OKB, 2004:9-135). Këto detyra Kosova duhej t'i realizonte deri në vitin 2005, ashtu që më pastaj të vlerësoheshin arritjet me qëllim që të iniciohej faza e ardhshme e përcaktimit të statusit final të saj. Negociatat me Serbinë për çështjen e statusit final të Kosovës, të ndërmjetësuara nga i emëruari i posaçëm i sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, ish-Presidenti finlandez Ahtisaari, filluan në fillimin e vitit 2006 dhe zgjatën 15 muaj (Wellner, 2008: 61). Pasi që propozimi i Presidentit Ahtisaari nuk pati mundësi të kalojë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, për shkak të kërcënimit të vetos të Rusisë, Kosova në koordinim me aktorët kyç të bashkësisë ndërkombëtare e shpalli pavarësinë me 17 shkurt 2008.

Sot, Kuvendi i Kosovës ka një përbërje diverse. nga subjekte të ndryshme, ku dalimin kryesor e bën qasja e tyre etnike, duke mos përjashtuar edhe atë ideologjike dhe fetare. Nga 120 ulëset në Kuvend, 100 vende i kanë fituar partitë e shumicës shqiptare, kurse komunitetet pakicë kanë arritur të sigurojnë vetëm 20 ulëset e garantuara, që janë të ndara në 10 për serbët dhe po aq për komunitetet jo serbe (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 64).

Më poshtë është e dhënë përbërja e plotë e Kuvendit sipas të dhënave nga KQZ-ja, ku në bazë të numrit të votave është bërë përllogaritja proporcionale e përqindjeve të fituara në zgjedhje dhe e numrit të ulëseve në Kuvend (KQZ, 2014: 2-3). Vlen të theksohet që përpos subjekteve që zyrtarisht ishin kandiduar në zgjedhje, ka patur

edhe lëvizje të deputetëve nga njëri grup parlamentar në tjetrin, mirëpo kjo nuk e ka ndikuar koalicionin qeverisës (PDK me 35 vende, LDK me 33 vende, LVV me 16 vende, Lista Serbe me 10 vende, AAK me 9 vende, Nisma për Kosovën me 6 vende, Grupi 6+ me 6 vende, dhe Pa grup me 5 vende).

**Tabela 2:** Partitë e përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës bazuar në rezultatin e zgjedhjeve të fundit qendrore, 2014

Emri i partisë	Përqindja	Votat	Numri i ulëseve në Kuvend
Partia Demokratike e Kosovës, Partia e Drejtësisë, Lëvizja për Bashkim, Partia Demokristiane e Kosovës, Partia Konservatore e Kosovës	30,38%	222.181	37
Lidhja Demokratike e Kosovës	25,24%	184.594	30
Lëvizja Vetevendosje	13,59%	99.398	16
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës	9,54%	69.793	11
Lista Serbe	5,22%	38.199	9
Nisma për Kosovën	5,15%	37.68	6
Partia Demokratike Turke e Kosovës	1,02%	7.424	2
Partia Përparimtare Demokratike	0,82%	5.973	1
Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës	0,46%	3.335	1
Partia e Re Demokratike	0,39%	2.837	1
Partia Liberale Egjiptiane	0,27%	1.960	1
Partia e Ashkalinjëve për Integrim	0,22%	1.583	1
Koalicioni për Gorën	0,16%	1.193	1
Partia e Re Rome e Kosovës	0,09%	645	1

Burimi: Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve

## 2.5. Koalicionet partiake

Nëse partitë politike i ndajmë sipas madhësisë së tyre, atëherë mund t'i kategorizojmë në tre grupe të ndryshme: parti politike të mëdha, të ndërmjetme, dhe të vogla. Në grupin e parë, partitë e mëdha gëzojnë bazë të fortë dhe lojalitet nga elektorati. Një nga përparësitë e partive të mëdha është mundësia më e shpejtë për të ardhur në pushtet duke u bërë parti qeverisëse apo duke e udhëhequr ndonjë koalicion

qeverisës. Pastaj kemi grupin e dytë, që mund të quhet si 'i ndërmjetëm', që ka mangësi të resurseve dhe të fuqisë së majftueshme politike për të fituar, por që ka resurse të mjaftueshme si elektorat dhe ulëse në Kuvend për të patur rëndësinë e vet të vendosjes. Në fund kemi edhe grupin e tretë që përfaqëson interesa të klasave të ndryshme (apo të ngushta) shoqërore, dhe që lëviz në krahe të ndryshme politike ashtu sikurse edhe grupi i dytë.

Si parti kryesore në Kosovë me bazën më të madhe votuese janë LDK dhe PDK. Në Kosovë, përpos këtyre dy partive politike nuk ka patur ndonjë parti tjetër që t'i ketë fituar zgjedhjet parlamentare (Zgjedhjet e Përgjithshme - KQZ, 2015). Me këtë nënkuptohet që këto dy parti kanë edhe bazën elektorale më të madhe në vend. Ndërkaq, si parti të ndërmjetme kemi LVV-në dhe, posaçërisht AAK-në, që vazhdimisht kanë ndryshim të madhësisë elektorale, dhe që kanë rol domethënës në formimin e koalicioneve qeveritare.

Si grup të tretë kemi partitë e vogla që kryesisht janë organizata jo-efikase në mundësitë e tyre për të qeverisur, për shkak të numrit të vogël të votuesve që është i pamjaftueshëm në sistemin zgjedhor në Kosovë. Qëllimi final i këtyre partive të vogla është që objektivat e tyre t'i realizojnë përmes futjes në qeverisje me partitë tjera të mëdha, ku në të njejtën kohë kjo lëvizje e tyre politike është e mjaftueshme për akomodimin e ndonjë grupi të vogël të njerëzve të afërt të tyre. Si arsye kryesore për lëvizjet e tilla nga partitë e vogla është pragu zgjedhor prej 5%, që për to është vështirë i kalueshëm (Zgjedhjet e Përgjithshme - KQZ, 2015).

Në historinë politike të Kosovës së pasluftës që ka zgjatur pak më shumë se një dekadë, me përjashtim të LDK-së që në fillim kishte përqindje të lartë votuesish, nuk ka pasur dominim absolut të subjekteve politike. Si rrjedhojë, brenda mundësive të tyre në sistemin politik të Kosovës, subjektet politike gjithnjë kanë qenë të detyruara të lidhin koalicione me subjekte të tjera për t'i arritur numrat për një qeverisjeje stabile.

Subjektet relevante politike të sipërpërmendura janë marrë si shembull për shkak të primatit të tyre në skenën politike të Kosovës në zgjedhjet e fundit. Po ashtu, këto parti, statutet e tyre partiake i kanë harmonizuar me sistemin aktual zgjedhor, ku ndër të tjera rregullohen edhe lidhja e koalicioneve për qeverisje, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal (këtu bën përjashtim partia Nisma për Kosovën, që ende nuk posedon statut, dhe Lista Serbe që nuk është e regjistruar si parti politike). Sipas gjetjeve, kompetenca për lidhje të koalicioneve ndryshon (ose, është e shpërndarë) në dy organe të partive në fjalë; në Këshillet Drejtuese dhe në Kryesitë e partive (rregullimi i lidhjes së koalicioneve sipas statuteve të partive politike në Kosovë është e trajtuar më gjerësisht në kapitullin 6. Demokracia Brendapartiake).

Pra, në Kosovë kemi një skemë politike ku ardhja në pushtet e partive politike është



e pamundur pa lidhje të koalicioneve. Meqë formësimi ideologjik i shumicës së partive politike në Kosovë është ende në fazat fillestare, këto nuk kanë alternativa të shumta të zgjedhjes së partnerëve qeverisës, dhe kjo dëshmon se që nga përfundimi i luftës, në Kosovë të gjitha qeveritë janë formuar me koalicione pas-zgjedhore.

## **2.6. Proceset e brendshme në partitë politike**

Sfidat kryesore të demokracisë së brendshme të partive politike, si në Kosovë, ashtu edhe në rajon, janë dominimi i elitave, zgjedhjet jo-konkurruese të lidërshiptit, përzgjedhja diskriminuese e kandidatëve, dhe klientelizmi (Daskalovski, 2012: 10). Këto janë probleme tipike të partive politike në të gjithë botën, dhe veçanërisht në demokracitë në zhvillim, ku pasqyrohen në zgjedhje dhe në funksionimin e brendshëm të partive, ku lidërshipti që e ka pushtetin brenda organizatës, nuk ka ndonjë interes për reformat demokratike që të dëshiruara nga përkrahësit e partisë (Carothers, 2006: 2). Këtë e dëshmojnë edhe partitë politike në Kosovë, që ngurrojnë, apo nuk e dojnë reformimin e tyre. Një nga shkaqet kryesore është prishja e status-quo brenda partive, që i mbron interesat e grupacioneve dhe të anëtarëve të caktuar të partisë. Gjithashtu mund të hasim edhe ndërrimin e liderit të ndonjë partie pa ndryshim të lidërshiptit, mirëpo, këto ndryshime sipërfaqësore nuk rezultojnë në ndonjë reformë demokratike brendapartiake. Në mesin e partive të mëdha në Kosovë, LDK-ja e ka ndryshuar liderit përmes votimit, mirëpo kjo ka dështuar në reformimin e partisë, dhe LVV-ja, e ka ndryshuar po ashtu liderin përmes votimit, mirëpo nuk e ka ndryshuar lidërshiptit dhe nuk ka vullnet të shprehur për procese reformuese.

Nëse i shikojmë statutet e partive politike në Kosovë mund të thuhet se ato janë të rregulluara mjaft mirë, duke i dorëzuar kompetencat specifike në organet relevante të partisë. Kur jemi tek kompetencat e fituara nga subjekti, shqetësues është push-teti joformal të anëtarë të caktuar, si dhe mënyra jo-formale e vendimmarrjes në subjektet në Kosovë. Lideri dhe njerëzit e afërt me të ushtrojnë më tepër fuqi se që u përcaktohet me statut. Jo rrallë vendime të rëndësishme për partinë merren në takime joformale. Trajtat joformale të vendimmarrjes shpesh paraqiten si mënyra kryesore e marrjes së vendimeve më të rëndësishme për subjektin që e përfaqësojnë, duke i lënë në hije të gjitha organet e partisë dhe kërkesat që dalin nga dokumentet themelore të saj. Vendime shumë të rëndësishme ndër-partiake, dhe posaçërisht ato që kanë të bëjnë me koalicionet qeverisëse, janë marrë nëpër baret e Prishtinës. (Krasniqi dhe Shala, 2012: 10-12). Këtu nuk është edhe aq i rëndësishëm vendi, sa

mënyra dhe procesi i vendimmarrjes, meqë anashkalohen të gjitha organet e partisë dhe detyrimet dhe përgjegjësitë që dalin nga dokumentet themelore të saj, përfshirë këtu edhe anashkalimin e vullnetit dhe të zërit të elektoratit që ato e përfaqësojnë.

## 2.7. Rregullimi ligjor i financimit të partive politike

Aktiviteti financiar i partive politike në Kosovë është i rregulluar me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe me Rregullën zgjedhore të KQZ-së për Financimin e Subjekteve Politike dhe Sanksionet. Legjislacioni aktual ka pësuar ndryshime, ku ndër më kryesoret janë ato pas kritikave të Komisionit Evropian në Raportet e Progresit për Kosovën dhe në Studimin e Fizibilitetit (Komisioni Evropian, 2012: 13), pas të cilave Kuvendi i Kosovës ka ndryshuar dhe plotësuar Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike.

Fondet publike për financimin e subjekteve politike apo të kandidatëve politikë janë të bazuara në resurset shtetërore/qeveritare. Subjektet politike duhet të kenë qasje të barabartë në fondet publike, ndërsa rregullat lidhur me këto fonde duhet të jenë specifikuar qartë në ligj. Këto fonde ndahen në financime publike direkte dhe në financime publike indirekte, varësisht nga forma përmes së cilës resurset publike janë vënë në dispozicion. Financimi publik direkt bëhet për partitë politike në trajtë të parave – zakonisht përmes transfereve bankare periodike. Kurse, financimi publik indirekt u referohet resurseve në vlerë monetare që shteti i ofron për partitë politike, siç mund të jenë hapësirë falas në media për aktivitetet zgjedhore, dhënia në dispozicion e hapësirave publike për organizimin e aktiviteteve dhe të tubimeve, lirimimi nga taksat, etj. (TEKN, 2012: 23)

Ligji për Financimin e Subjekteve Politike rregullon mënyrën, kushtet e financimit, administrimin, mbikëqyrjen, transparencën dhe raportimin për shpenzimin e pasurisë dhe të të ardhurave të subjekteve politike në Republikën e Kosovës. Neni 3 i këtij Ligji subjektet politike i përcakton si persona juridik jo fitimprurës.

Sipas Nenit 4 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, burimet financiare dhe materiale të subjekteve politike përbëhen nga: a) kuota (pagesat) e anëtarësisë; b) kontributet; c) financimi nga Buxheti i Republikës së Kosovës; d) çdo pasuri e fituar në mënyrë të paraparë me këtë ligj; dhe e) të ardhurat nga aktivitetet e subjektit politik të përcaktuara me nenin 6 të këtij Ligji.

Ndër burimet e tjera të sipërpërmendura kemi edhe fondimin publik të subjekteve politike që bëhet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, përkatësisht nga Fondi

për mbështetjen e subjekteve politike (Neni 7). Ky Fond funksionon në kuadër të KQZ-së, ku shumica e mjeteve buxhetore dedikuar për mbështetjen e subjekteve politike nuk mund të kalojë 0.34% të Buxhetit të Kosovës. Kjo shumë dedikohet për financimin e aktiviteteve të rregullta të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend në bazë të numrit të ulëseve për atë mandat (Neni 9).

Për regjistrimin e të gjitha të ardhurave, së bashku me shpenzimet e mjeteve që i ka, subjektet politike caktojnë një zyrtar të autorizuar financiar. Pos për to, zyrtari i autorizuar financiar mban përgjegjësi edhe për dorëzimin e raportit final të mjeteve të shpenzuara, për dorëzimin e Raportit të Deklarimit Financiar të Fushatës, për detyrimet e tjera lidhur me të ardhurat, shpenzimet, paraqitjen e qëllimeve, dhe për ndarjen e shumës së mjeteve të subjektit (Neni 14).

Sa i përket fushatave zgjedhore, në Kosovë shpenzimet e këtij procesi janë të përcaktuara me ligj, ku për financimin e tyre Kuvendi i Kosovës mund të ndajë mjete nga Buxheti i Kosovës jo më shumë se 0.05% të shumës së përgjithshme të buxhetit (Neni 10). Gjithashtu, subjektet politike nuk mund të shpenzojnë më shumë se 0.5 Euro për votues të regjistruar (Rregullore e KQZ-së nr. 12/2013, Neni 3.1). Nga shumica e përgjithshme e mjeteve, 90% ndahen për subjektet në bazë të numrit të vendeve në Kuvend, kurse 10% e tyre ndahen proporcionalisht për subjektet e tjera politike të regjistruara dhe të certifikuara nga KQZ, për zgjedhjet përkatëse.

Ligji për Financimin e Subjekteve Politike gjithashtu parasheh kontribute për subjektet politike, që me ligj kategorizohen në persona fizikë që mund të kontribojnë në vlerë prej jo më tepër se dy mijë (2.000) Euro për një vit kalendarik, pastaj personat juridikë që mund të kontribojnë në vlerë prej jo më tepër se dhjetëmijë (10.000) Euro për një vit kalendarik, dhe këto burime financiare janë të ndaluara për shpenzime që sjellin përfitime personale (Neni 5). Po ashtu, si të ardhura financiare për subjektet politike mund të jenë edhe veprimtaritë financiare fitimprurëse, si publikimet, botimet, shitja e materialeve reklamuese, e posterëve me emblemën ose akronimin e subjektit politik dhe të burimeve të tjera të lejuara me ligj, ku gjitha të hyrat dhe të dalat nga aktivitetet financiare të subjekteve politike duhet të regjistrohen nëpër regjistrat financiarë (Neni 6).

Të gjitha subjektet politike janë të obliguara ta dorëzojnë Raportin e Deklarimit Financiar të Fushatës në Zyrën për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike në KQZ, jo më vonë se 45 ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve (Rregullore e KQZ-së nr. 12/2013, Neni 4.1). Raportimit financiar i subjekteve politike në Kosovë është i rregulluar me ligj, përkatësisht me nenin 15 to Ligjit Nr.03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike. Sipas këtij ligji që rregullimin financiar e përcakton në hollësi, partia është e obliguar të mbajë evidencë të saktë dhe të hollësishme për shënimet financiare për një periudhë shtatëvjeçare, dhe subjektet e regjistruara politike, për

çdo vit, dhe më së largu deri më 1 mars të vitit vijues, ia dorëzojnë KQZ-së raportin vjetor financiar në mënyrën e paraparë nga KQZ – ja (Neni 15).

Çdo raport financiar vjetor i subjekteve politike duhet ta përmbajë bilancin e gjendjes që e tregon pasurinë, pasqyrën e fitimit dhe të humbjeve, dhe pasqyrën që tregon çdo pagesë që i është bërë personit tjetër gjatë periudhës së përfshirë në raport. Raporti vjetor financiar duhet të përmbajë, po ashtu, edhe informata rreth bilancit bankar, regjistrin e të gjitha kontributeve, dhe faturat për të gjitha shpenzimet.

Në kuadër të transparencës, subjektet politike janë të obliguara të publikojnë dhe të mbajnë të publikuara të paktën për një vit në faqet e tyre zyrtare Raportin Vjetor Financiar të vitit paraprak dhe Raportin e Deklarimit Financiar të Fushatës së zgjedhjeve paraprake, si dhe t'i publikojnë versionet e tyre të shkurtuara në ndonjërin nga gazetatat ditore kombëtare.

Po ashtu, sa i përket kontrollit të brendshëm financiar, duke iu referuar gjatë gjithë kohës Ligjit 03/L-174, subjektet politike janë të detyruara ta definojnë qartë, me statut, të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike, si dhe për përgjegjësinë e organit përkatës për transaksione financiare (Neni 17).

Raportet Vjetore Financiare dhe Raporti i Deklarimit Financiar të Fushatës, auditohen sipas standardeve nga kompani të zgjedhura nga Kuvendi. Një auditor nuk mund të auditoj dy herë radhazi raportet financiare të të njëjtit subjekt politik. Procesi i auditimit të Raporteve vjetore financiare të subjekteve politike duhet të mbarojë më së largu deri më 15 qershor të vitit pasues. Gjithashtu, KQZ-ja duhet t'i publikojë të gjitha raportet vjetore financiare së bashku me deklaratën e auditimit të subjekteve politike në faqen zyrtare të saj (Neni 15).

Të gjithë personat dhe subjektet që marrin pjesë në procesin zgjedhor obligohen t'i respektojnë ligjet në fuqi dhe procesin zgjedhor, përfshirë edhe rregullat zgjedhore. Sipas nenit 2 të Rregullës zgjedhore Nr.14/2009 të KQZ-së që rregullon sanksionet dhe gjobat, KQZ-ja sipas rekomandimit të Zyrës mund të shqiptojë dënime për shkeljen e dispozitave të ligjit, kur ato nuk përbëjnë vepër penale dhe nuk janë në kompetencë të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), e që janë të dënueshme me një gjobë prej 200 deri në 2.000 Euro bazuar në nenin 126.1 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë nr. 03/L-073.

Pra, raportet financiare kontrollohen nga Zyra në përputhje me standardet e kontabilitetit që janë të zbatueshme në Kosovë. Në rast të mospërmbushjes së këtyre obligimeve ligjore për raportim, KQZ-ja sipas rekomandimit të Zyrës subjektet politike i gjobitë për vonesën e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar dhe i kategorizon sipas kriterit të përfaqësimit dhe afateve (Rregullore e KQZ-së nr. 14/2009, Neni 3).

Gjoha më e ulët e paraparë është 200 Euro, për mbajtjen jo të rregullt të shënimeve në librin e kontabilitetit për subjektet që nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, ndërsa 250 për subjektet që janë të përfaqësuara në Kuvend (Rregullore e KQZ-së nr. 14/2009, Neni 4). Gjoha më e lartë e paraparë është 2,000 Euro për fshehje ose falsifikim të shumës që është ndërmjet 3/4 deri 4/4 e kategorisë përkatëse për ato subjekte që janë të përfaqësuara në Kuvend, ndërsa për subjektet e papërfaqësuara në Kuvend kjo gjohë e ka vlerën 1,400 Euro (Rregullore e KQZ-së nr. 14/2009, Neni 7). Në rastet kur subjekti politik nuk mund të dëshmojë prejardhjen e mjeteve nga donacionet që kalojnë vlerën mbi 20,000 Euro, atëherë gjoha e shqiptuar ndaj tyre është trefishi i shumës së pranuar. Në fund, sipas Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, të gjitha gjobat e mbledhura derdhen në Buxhetin e shtetit (Neni 7). Pos dënimeve financiare, KQZ ka po ashtu edhe të drejtën që subjektet e padisiplinuara t'i ndëshkojë duke mos i certifikuar për të marrë pjesë në zgjedhje.



Albert Krasniqi

## **PJESA E TRETË**

# **SISTEMI ZGJEDHOR**





### 3. SISTEMI ZGJEDHOR

#### 3.1. Sistemi zgjedhor i kosovës

Kosova është Republikë Parlamentare ku votuesit zgjedhin anëtarët e parlamentit (deputetët) drejtpërdrejtë, përmes votimit të fshehtë, çdo katër vite. Kuvendi ka 120 deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë, bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre në zgjedhjet për Kuvend.

*Tabela 3: Sistemi zgjedhor i Republikës së Kosovës*

Popullsia (milionë)	Numri i ulëseve në legjislativ	Numri i zonave zgjedhore	Sistemi i listave të votimit	Pragu zgjedhor (%)	Kuotat gjinore (%)	Formula e kalkulimit për shpërndarjen e ulëseve	Ulëse të garantuara për pakicat etnike
1.7	120	1	Lista të hapura	5	30	Sainte-Laguë	20

Në zgjedhjet parlamentare të viteve 2001 dhe 2004, votimi për deputetë është bërë me sistem proporcional me lista të mbyllura. Ky sistem me përfaqësim proporcional dhe lista të mbyllura, i ka shërbyer qëllimit të vet në mandatin e parë, duke lejuar që partitë politike të konsolidohen në periudhën menjëherë pas luftës, mirëpo ky ishte vendim i gabueshëm për mandatin e dytë, meqë Kosovës i duhej të hynte në një fazë të re të zhvillimit demokratik (Dugolli dhe Malazogu, 2006). Një hap i madh demokratik pasoi në vitin 2007, kur zgjedhjet parlamentare u zhvilluan me lista të hapura, dhe zgjedhësit mund të votonin deri në 10 kandidatë. Parregullsitë që u shfaqën gjatë këtyre zgjedhjeve pjesërisht iu mvëshën zgjedhjes së 10 kandidatëve në një fletëvotim. Numri i madh i kandidatëve për t'u votuar krijoi konfuzion në mesin e votuesve dhe e rriti numrin e fletëvotimeve të pavlefshme (Berisha dhe

Morina, 2012). Ndryshimet e fundit në sistemin zgjedhor u bënë në vitin 2010. Në përpjekje për t'i zvogëluar parregullsitë gjatë votimit, numri i kandidatëve që mund të votoheshin u zvogëlua nga 10 në 5. Pragu zgjedhor për parti, koalicione dhe kandidatë të pavarur është 5% e votave të përgjithshme, ndërkohë që për partitë që përfaqësojnë pakicat kombëtare nuk ka prag zgjedhor. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton dispozitat e përgjithshme të sistemit zgjedhor në Kosovë dhe ky e definon të tërë vendin si një zonë e vetme zgjedhore me shumë kandidatë, nga të cilët 100 deputetë futen në parlament përmes përfaqësimit proporcional me lista të hapura, dhe 20 vende shtesë janë të rezervuara për deputetët e pakicave kombëtare. Tabela 2 ilustron zgjedhjet e përgjithshme në renditje kronologjike, nga viti 2001 deri në atë 2014, me një përmbledhje të disa specifikave të sistemit zgjedhor.

**Tabela 4:** Prezantimi i zgjedhjeve të përgjithshme nga viti 2001 deri në 2014

2001	2004	2007	2010	2014
Sistem proporcional	Sistem proporcional	Sistem proporcional	Sistem proporcional	Sistem proporcional
Lista të mbyllura	Lista të mbyllura	Lista të hapura (10 kandidatë)	Lista të hapura (5kandidatë)	Lista të hapura (5kandidatë)
Zonë e vetme	Zonë e vetme	Zonë e vetme	Zonë e vetme	Zonë e vetme
20 ulëse të rezervuara për minoritetet	20 ulëse të rezervuara për minoritetet	20 ulëse të rezervuara për minoritetet	20 ulëse të rezervuara për minoritetet	20 ulëse të garantuara për minoritetet
30% kuota gjinore	30% kuota gjinore	30% kuota gjinore	30% kuota gjinore	30% kuota gjinore

**Burimi:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

**Listat e hapura** janë një mundësi për votuesit që të vendosin se cilët kandidatë të partive politike do t'i përfaqësojnë. Taagepera (2007: 238-41) thekson se sistemi proporcional me lista të hapura favorizon grupet e nën-përfaqësuar, përfshirë gratë. Kriteri kryesor në votimin preferencial sipas Karvonen (2004) është që votuesve t'u mundësohet të zgjedhin në mes të partive, kandidatëve, apo të dyjave. Rezultatet e zgjedhjeve për Kuvend në vitin 2010 treguan se listat e hapura kanë patur një ndikim pozitiv, duke mundësuar që 39% e anëtarëve të Kuvendit të Kosovës të zgjedhen në saje të listave të hapura. Në anën tjetër, 61% e të zgjedhurve në Kuvend do të ishin zgjedhur, qoftë me lista të mbyllura, qoftë me të hapura. Ky efekt është më i theksuar te partitë e mëdha, ku 48% e deputetëve nga këto parti janë zgjedhur në saje të listave të hapura. Për më tepër, numri i deputetëve të zgjedhur përmes listave të hapura te partitë e mëdha është në rritje (D4D, 2011:24). Rezultate identike janë shënuar edhe në zgjedhjet e vitit 2014, ku 47 nga 120 deputetët janë zgjedhur falë listave të hapura, apo, shprehur në përqindje 39%, ndërsa, 73 deputetë apo 61% do të ishin zgjedhur, qoftë me lista të hapura, qoftë me ato të mbyllura.

**Grafiku 1:** Përqindja e deputetëve të zgjedhur falë listave të hapura në zgjedhjet e vitit 2010 dhe 2014.



Burimi: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ); kalkulimi është bërë nga autori.

**Votimi nga jashtë vendit** - Pothuaj 150 vite pasi që shteti Amerikan i Wisconsinit miratoi ligjin e parë që mundësoi votimin nga jashtë vendit, për ushtarët e vet që luftonin në Luftën Civile Amerikane, sot shumë demokraci e ofrojnë mundësinë e votimit nga jashtë për shtetasit e tyre që jetojnë jashtë (Ellis, 2007:11). Në shoqëritë e dala nga konflikti, me numër të madh të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, operationet e votimit nga jashtë janë duke u organizuar në një shkallë masive, për ta mundësuar përfshirjen e këtyre njerëzve në proceset elektorale dhe politike në vend.

Kosova gjendet në mesin e 115 vendeve dhe territoreve që kanë dispozita ligjore që zgjedhësve të saj u mundëson të votojnë nga jashtë vendit. Legjislacioni në fuqi u garanton votuesve me të drejtë vote që përkohësisht banojnë jashtë vendit, ose që janë zhvendosur dhe kanë të drejtë të votojnë, ta ushtrojnë këtë të drejtë. Për të hedhur fletëvotimin e tyre për zgjedhje, votuesit nga jashtë duhet të jenë të regjistruar si banorë të përhershëm në Regjistrin Qendror Civil, ose për zgjedhjet e fundit duhet të jenë të regjistruar si votues për votim nga jashtë (KQZ, 2013a). Votuesit duhet ta dorëzojnë të plotësuar Formularin për Regjistrim/Aplikim në mes të periudhës 25 ditë pas ditës së shpalljes së zgjedhjeve dhe 60 ditë para Ditës së Zgjedhjeve. Emrat e votuesve të regjistruar me sukses për të votuar nga jashtë vendosen në një listë të veçantë dhe largohen nga Lista e Votuesve që përdoret në vendvotime. Vende të ndryshme aplikojnë forma të ndryshme të votimit nga jashtë, në varësi të specifikave të vendit dhe koston financiare. IDEA (2007) liston pesë metoda të votimit nga jashtë: Votimi personal në misionet diplomatike apo vende të veçanta, votimi përmes postës, votimi i autorizuar, votimi elektronik, si dhe votimi përmes faksit. Nga të pesë këto metoda të njohura të votimit nga jashtë, në Kosovë votimi nga jashtë mundësohet vetëm përmes votimit me postë.

**Votimi me kusht** - Votimi me Kusht është praktikë që kryesisht përdoret në vendet


e pas-konfliktit me qëllim që votuesve të zhvendosur t'u mundësohet ushtrimi i të drejtës së votës. Një praktikë të tillë e ka ndjekur edhe Kosova që nga mbajtja e zgjedhjeve të para të lira. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (Neni 95) të gjithë votuesve që nuk mund të gjejnë emrin dhe mbiemrin në Listën e Votuesve, u mundëson të votojnë me kusht në vendvotim që lëshon fletëvotime me kusht në pajtim me rregullat e KQZ-së. Zërat që mbrojnë votat me kusht sot janë të pakët, kryesisht për shkak të potencialit të madh të tyre për manipulim dhe kohës së madhe që shpenzohet për t'i numëruar (D4D, 2011).

**Kuota gjinore** – Zbatimi i legjislacionit për kuotën gjinore ka për qëllim të hapë rrugë më të gjëra për pjesëmarrjen e grave në politikë, si dhe t'i ndihmoj gratë në tejkalimin e pengesave për pjesëmarrje politike (NDI, 2015). Dy nga llojet më të zakonshme të kuotave gjinore në zgjedhje janë kuotat e kandidatëve dhe vendet e rezervuara. *Kuotat e kandidatëve* specifikojnë përqindje minimale të kandidatëve për zgjedhje që duhet të jenë gra, dhe që duhen zbatuar për listat e partive politike të kandidatëve për zgjedhje. *Vendet e rezervuara* lënë mënjanë një numër të caktuar të ulëseve për gratë mes përfaqësuesve në një legjislaturë, të specifikuara, ose në kushtetutë, ose me legjislacion. Sot sistemet e kuotave synojnë të sigurojnë që gratë ta përbëjnë të paktën një «pakicë» prej %30 apo %40, ose synojnë “balancë gjinore” siç kërkohet në traktate dhe konventa të ndryshme ndërkombëtare. Kuotat mund të shihen si një masë e përkohshme, përderisa pengesat për hyrjen e grave në politikë të mos jenë tejkaluar (Dahlerup, 2006). Një lloj i tretë i kuotave që përdoret më rrallë, është *kuota gjinore-neutrale*. Sistemet e kuotave, megjithatë, mund të ndërtohen si të gjinisë-asnjënjë. Në këtë rast, kërkesa mund të jetë, për shembull, që asnjëra gjini nuk bën të zërë më shumë se 60% ose më pak se 40% të pozitave në listat e partive apo në ndonjë organ vendimmarrës. Përderisa kuotat për gratë përcaktojnë maksimumin e vendeve për burrat, kuotat gjinore-neutrale vendosin kufijtë për të dyja gjinitë. Rregullat e kuotave gjinore-neutrale nganjëherë përdoren edhe si zgjedhje strategjike, në mënyrë që të hedhin poshtë argumentet e kundërshtarëve të kuotave që thonë se ato janë diskriminuese ndaj burrave (Dahlerup, 2006).

Sipas Kushtetutës dhe legjislacionit elektoral në fuqi, sistemi i kuotës gjinore-neutrale është përzgjedhur të zbatohet edhe në Kosovë. Kushtetuta përcakton që 30% e vendeve në Kuvend të jenë të rezervuara për kandidatët e gjinisë më pak të përfaqësuar, kurse me legjislacion subjektet politike obligohen që në listat e kandidatëve të kenë jo më pak se 30% të një gjinie të caktuar, si dhe që të paktën çdo i treti kandidat duhet të jetë nga radhët e gjinisë më pak të përfaqësuar. Mosrespektimi i kuotës gjinore në listat e kandidatëve të partive politike sanksionohet me moscertifikim të pjesëmarrjes në zgjedhje. Zbatimi i kuotës gjinore është treguar i suksesshëm në Kosovë, pasi që në vazhdimësi janë shënuar trende pozitive të përfaqësimit të grave në Kuvend, bazuar në meritë. Shprehur nëpërqindje, periudha e pestë legjislative ka 32,5% të anëtarëve gra, dhe në sajë të kësaj në krahasim me vendet tjera Kosova

renditet në vendin e 27-të në botë sa i përket përfaqësimit të grave në parlament (IPU, 2015). Grafiku 2 ilustron zgjedhjen e grave në Kuvend në bazë të kuotës dhe meritës në renditje kronologjike në tri palë zgjedhjet e fundit.

**Grafiku 2:** Gratë deputete të zgjedhura në Kuvend 2007 - 2014



Burimi: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

**Ulëset e garantuara për pakicat kombëtare** – Aktualisht, në Kosovë janë të njohura shtatë grupe etnike si minoritete zyrtare: serbët (1.5%), boshnjakët (1.6%), turqit (1.1%), ashkalinjtë (0.9%), goranët (0.6%), egjiptasit (0.6%) dhe romët (0.5%) (ASK, 2012). Për të siguruar përfaqësimin e këtyre komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, Kushtetuta (Neni 64) ka paraparë që në kuadër të ndarjes së vendeve, 20 prej 120 vendeve të jenë të garantuara për komunitetet. Subjektet politike apo kandidatët e pavarur që janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura, me minimum 10 vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë. Ndërsa sipas logjikës së njëjtë, 10 vende të tjera janë të garantuara për komunitetet tjera, duke përfshirë nga një vend për komunitetin ashkali, egjiptian dhe rom, si dhe një vend shtesë që do t'i jipet njërit prej këtyre komuniteteve që fiton numrin më të madh të votave të përgjithshme. Për komunitetin boshnjak janë të garantuara tre vende, për komunitetin turk dy, dhe për komunitetin goran një.

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)** - është institucion i pavarur i themeluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës që ka për qëllim administrimin e proceseve zgjedhore. KQZ është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumeve, dhe shpall rezultatet e tyre. Në përmbushjen e këtyre detyrave dhe obligimeve kushtetuese, KQZ-ja mbështetet nga dy trupa administrative, dhe këto janë Sekretariati i KQZ-së dhe Zyra për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë, nga Kryesuesi i KQZ-së që emëron Presidenti i vendit nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të gjykatave me juridiksion apeli, dhe nga gjashtë anëtarë që emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend. Një anëtar emërohet nga deputetët e Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara apo të garantuara për komunitetin Serb të Kosovës dhe tre anëtarë nga deputetët e Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara apo të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë. Mandati i Kryesuesit të KQZ-së është shtatë vite dhe nuk mund të shërbejë në më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme. Ndërsa anëtarët e KQZ-së nuk mund të shërbejnë më shumë se tri mandate të njëpasnjëshme (Kushtetuta, Neni 139).

### 3.2. Njësitë zgjedhore

Një nga sfidat e sistemeve zgjedhore është balancimi i nevojës për të prodhuar institucione më efikase dhe funksionale, dhe asaj për të krijuar institucione që janë më përfaqësuese dhe llogaridhënëse ndaj qytetarit. Zgjedhja e drejtpërdrejtë e deputetit nga elektorati i një zone të caktuar zgjedhore, pa dyshim e bën deputetin më llogaridhënës ndaj zgjedhësve (meqë këta të fundit e kanë një adresë të saktë ku mund të kërkojnë përgjegjësi), por ndjenja e përgjegjësisë ekskluzive ndaj një grupi elektorale gjeografik në shtete të caktuara mund të bëjë që deputeti gjatë punës së tij t'u jap prioritet interesave të ngushta rajonale në hesap të interesave të përgjithshme dhe efektivitetit të qeverisë që ai e voton (Maliqi, 2011). Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i gjithë territori i Kosovës është përcaktuar si një zonë e vetme zgjedhore me shumë kandidatë dhe votimi bëhet në nivelin qendror.

### 3.3. Tipat e fletëvotimeve

Një tjetër dimension i rëndësishëm i sistemit zgjedhor është edhe struktura e fletëvotimeve. Dy nga llojet më të përdorura janë: *Fletëvotimi australian* (sipas emrit të origjinës) dhe sistemi *Fletëvotimi dhe zarfi*. Fletëvotimi Australian është fletëvotim në të cilin emrat e të gjitha partive konkurruese dhe kandidatëve janë të grupuara në një fletë të vetme, për t'u shënuar nga votuesit. Sistemi "Fletëvotimi dhe zarfi" kërkon shtypjen e një fletëvotimi të veçantë për çdonjërin nga partitë konkurruese

apo kandidatët, duke ftuar votuesit për të futur një letër të vetme në një zarf, i cili duhet të hedhet në kutinë e votimit. Në mes të këtyre dy llojeve ekziston edhe një zgjidhje e ndërmjetme: *Fletëvotimi francez*, që liston kandidatët që do të shënjohej nga votuesit. Ky lloj i fletëvotimit është përdorur në disa juridiksione ku përfaqësimi proporcional është i kombinuar me të drejtën e votuesve për të shprehur preferencat për kandidatët individualë në kuadër të listës së partisë (ACE, 1998).

Në Kosovë fletëvotimi është më afër tipit australian, që është një fletë e vetme e formatit A3 në anën e majtë të të cilës janë të renditura subjektet politike në bazë të numrit të përcaktuar nga shorti i hedhur paraprakisht. Renditja e subjekte politike në fletëvotim bëhet nga numri më i vogël deri te më i madhi. Përveç numrit të subjektit politik, në këtë anë figuron edhe simboli, akronimi dhe emri i plotë i subjektit politik. Ndërsa, në anën e djathtë të fletëvotimit janë të vendosur numrat e kandidatëve nga 1 deri në 110 (subjektet politike kanë të drejtë të përfshijnë në listat e tyre 10% më shumë kandidatë se numri i ulëseve për të cilat garohet). Votuesit mund t'i referohen edhe fletushkës së kandidatëve që gjendet në kabinën e votimit dhe tregojnë se cili numër korrespondon me emrin e kandidatit.

### 3.3.1. Për parlament

Deputetët e Kuvendit zgjedhen sipas sistemit proporcional me lista të hapura me mundësi të shprehjes së preferencave deri në pesë kandidatë të të njëjtit subjekt politik. Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, votuesi pajiset me një fletëvotim të vetëm për zgjedhje dhe e shënjon atë me votën për një subjekt politik. Votuesi, gjithashtu mund të shënoj deri në pesë kandidatë nga lista e subjektit politik. Nëse në një fletëvotim shënjohej më shumë se pesë kandidatë, atëherë numërohet vetëm vota e hedhur për subjektin politik.

Në mungesë të zonave, mundësia e përzgjedhjes së më shumë se një personi është iniciuar në mënyrë që të mënjanohet dilema e votuesve që të zgjedhin ose udhëheqësin e partisë ose personin lokal të preferuar. Sistemi me një përzgjedhje në fletëvotim vë lidhshërinë qendror kundër disa udhëheqësve me ndikim rajonal. Është vlerësuar se më shumë përzgjedhje mënjanohet konkurrenca e padrejtë si dhe rritet mundësia e grave dhe udhëheqësve lokal për të mbledhur më shumë vota. Mirëpo, megjithatë sistemi aktual favorizon udhëheqësit me ndikim që kanë qasje në media, në fonde dhe praktikisht krijon një garë me dy nivele, atë qendror dhe lokal (D4D, 2011: 23).

### 3.4. Përlllogaritja e votave në mandate

Shtete të ndryshme demokratike aplikojnë sisteme të ndryshme për zgjedhjen e institucioneve përfaqësuese siç është parlamenti. Mënyra si një shtet i përkthen votat e qytetarëve në mandate parlamentare përcaktohet nga faktorë të ndryshëm që ndërlidhen me specifikat e vendit: natyra e shtetit, traditat, përbërja demografike, ndarjet rajonale, etj. Gjithsesi, faktor vendimtar në përzgjedhjen e sistemit zgjedhor të një vendi shpesh herë nuk janë konsideratat mbi interesin e përgjithshëm publik apo vlerësimi se a u përshtatet një sistem i caktuar më së miri nevojave të një shteti. Jo rrallë faktor vendimtar në përzgjedhjen e një sistemi të caktuar është fakti që ky t'i favorizojë partitë që kanë ndikim në përzgjedhjen e tij, duke dëmtuar kështu në mënyra të ndryshme alternativat sfiduese dhe duke ngushtuar hapësirën demokratike në vend.

Ndarja e vendeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës është përcaktuar me Kushtetutë (Neni 64), dhe përfshinë njëqind vende midis të gjitha subjekteve politike të certifikuara në raport me numrine votave të vlefshme që kanë marrë ato; dhenjëzet vende janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, prej të cilave në minimum dhjetë vende janë të garantuara për subjektet që janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb (në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë), kurse subjektet tjera të cilët janë deklaruar sepërfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë në minimum numrin e vendeve tëgarantuara si në vijim: komuniteti rom një vend; komuniteti ashkali njëvend; komuniteti egjiptian njëvend; dhe njëvendshtesë i jepet komunitetit rom, ashkali, ose egjiptian, që ka numrin më të madh të votave tëpërgjithshme; komuniteti boshnjak tri vende, komuniteti turk dy vende dhe komunitetigoran një vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (Neni 111.2) përcakton që njëqind vendet e Kuvendit ndahen në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme që i ka fituar çdonjëri subjekt politik, në mesin e subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetin serb dhe komunitetet e tjera joshumicë dhe në mesin e subjekteve politike që nuk përfaqësojnë komunitetin serb dhe komunitetet joshumicë që kanë fituar së paku pesë 5% nga numri i përgjithshëm i votave të vlefshme në zgjedhjet për Kuvend.

Numri i përgjithshëm i votave të vlefshme të fituara nga çdonjëri subjekt politik në zgjedhjet për Kuvend pjesëtohet me 1, 3, 5 e kështu me radhë derisa numri i pjesëtuesve të shfrytëzuar t'i përgjigjet numrit të plotë të vendeve. Kjo metodë e ndarjes së vendeve është e njohur ndryshe edhe si formula *Sainte-Laguë*, dhe sipas saj ndarja e mandateve bëhet në mënyrë proporcionale me anë të koeficientit.



Numri total i votave të partisë pjesëtohet me numrin e vendeve që partia i ka të ndara, që fillimisht është 0 për të gjitha partitë. Partia me koeficientin më të lartë merr vendin e radhës dhe pastaj i rikalkulohet koeficienti i ri derisa të shpërndahen të gjitha mandatet.

Nëse pas ndarjes së vendeve kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i radhës i gjinisë tjetër në listën e rënditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%.

### **3.5. Përshtatshmëria e sistemit zgjedhor me standardet ndërkombëtare**

Korniza ligjore për zgjedhjet në Kosovë është e përcaktuar nga Kushtetuta, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligji për Zgjedhjet Lokale, si dhe Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike si legjislacion primar, por pjesë të caktuara për zgjedhjet lokale rregullohen edhe me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale si dhe Ligjin për Kufijtë Administrativ Komunal. Kushtetuta e Kosovës (Neni 81) Ligjin për Zgjedhjet Lokale si dhe atë për Kufijtë Administrativ i konsideron si pjesë të legjislacionit me Interes Vital, për ndryshimin ose shfuqizimin e të cilave kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë, si dhe të shumicës së deputetëve që janë të pranishëm dhe që votojnë, që mbajnë vende të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë. Për më tepër, asnjëri nga këto ligje nuk i nënshtrohen referendumit (Krasniqi, 2014: 6). Në Dispozitat themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Neni 18) përcaktohet që marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës. Në këtë rrafsh hyn edhe Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, që është pranuar nga të gjitha vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara, dhe që përcakton të drejtën universale për zgjedhje të vërteta. Neni 21 i Deklaratës Universale thotë se “çdonjëri ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet drejtpërdrejtë, ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur me vullnet të lirë.” I njëjti nen përcakton gjithashtu që zgjedhjet e lira janë baza e vetme për autoritetin e një qeverie: “Vullneti i popullit duhet të jetë baza e autoritetit të qeverisë; ky vullnet duhet shprehur nëpërmjet zgjedhjeve periodike të vërteta, që duhet të jenë të përgjithshme e të barabarta, me votim të fshehtë ose nëpërmjet procedurave të barasvlershme me votimin e lirë”.

Të drejtat e parashtruara në Deklaratën Universale rimerren e shtjellohen më gjerësisht në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), që është një traktat i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut. Duke qenë traktat, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike përbën një detyrim ligjor për shtetet, që janë të detyruar t'u përmbahen klauzolave të saj. Neni 25 i kësaj Konvente i njeh të drejtën çdo qytetari, pa dallim, të votojë dhe të konkurrojë për në administratën publike. ICCPR-ja gjithashtu kodifikon dhe shtjellon më tej një numër të madh të drejtash civile dhe politike të mishëruara në Deklaratën Universale.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut (ECHR) dhe Protokollat e saj të miratuara nga Këshilli i Evropës, në Nenin 3 të Protokollit të Parë të ECHR kërkon nga shtetet anëtare “Të zhvillojnë zgjedhje të lira në intervale kohore të arsyeshme, nëpërmjet votimit të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimeve të njerëzve në zgjedhjet parlamentare.” Në shtetet që janë anëtare të Këshillit të Evropës, çdo individ mund t'i drejtohet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke i kërkuar asaj të shqyrtojë shkeljet e kryera gjatë zgjedhjeve, me kusht që ndërkohë ata t'i kenë përdorur të gjitha mjetet ligjore të vendit. Duke qenë se Kosova ende nuk është anëtare e Këshillit të Evropës, qytetarët e saj nuk mund të referojnë çështje në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut kur konsiderojnë që të drejtat e tyre zgjedhore janë mohuar. Në vitin 2014, Kosova është anëtarësuar në Komisionin e Venecias, njërin prej trupave këshillëdhënës të Këshillit të Evropës. Një prej dokumenteve më të rëndësishme të këtij komisioni është “Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore”, që përcakton parimet e përbashkëta të trashëgimisë kushtetuese evropiane, që përbëjnë bazën e çdo shoqërie të vërtetë demokratike. Sipas këtyre parimeve, zgjedhjet duhet të respektojnë pesë rregullat themelore bazë: *votimi duhet të jetë universal, i barabartë, i lirë, i fshehtë, dhe i drejtpërdrejtë*. Përveç kësaj, zgjedhjet duhet të zhvillohen në mënyrë periodike. Këto parime përftohen nga parimet universale dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare për zgjedhjet. Qeveria e çdo vendi është përgjegjësjë kryesore dhe duhet të sigurojë respektimin e plotë të këtyre zotimeve (OSBE/ODIHR, 2006).

### 3.5.1. Votimi i fshehtë

Fshehtësia e votës është një aspekt i lirisë së zgjedhjes, qëllimi i të cilës është të mbrojtë zgjedhësit nga presioni me të cilin ata mund të ballafaqohen në rast se të tjerët mësojnë se për kë kanë votuar. Fshehtësia duhet të aplikohet për të gjithë procedurën – dhe veçanërisht në hedhjen e fletëve të votimit dhe numërimin e votave. (Komisioni i Venecias, 2002). Prania e më shumë se një personi në kabinën e votimit nuk duhet lejuar, duke qenë se komprometon fshehtësinë e votës.

Përrjashtime mund të bëhen vetëm në kushte të veçanta dhe me kërkesë të votuesve që kërkojnë ndihmë, p.sh. në rastet kur votuesit janë analfabetë ose me aftësi të kufizuara. Çdo votim jashtë një kabine votimi komprometon fshehtësinë e votës (OSBE/ODIHR, 2006). Zgjedhësit kanë të drejtë për t'ua pasur fshehtësinë e votës, por edhe duhet t'ua respektojnë fshehtësinë e votuesve tjerë. Mosrespektimi i kësaj fshehtësie duhet të ndëshkohet duke shpallur të pavlefshme çdo fletë votimi, përm-bajtja e të cilës është zbuluar.

Në Kosovë fshehtësia e votës është e garantuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe në rast të shkeljes sanksionohet me Kodin Penal. Sipas ligjit askush nuk ka të drejtë ta pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që ta zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim. Ndërkaq, sipas Kodit Penal, kushdo që cenon fshehtësinë e votimit dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj. Përderisa përdorimi i dhunës, kanosjes ose i ndonjë mënyre tjetër kërkon nga personi të tregojë se për kë ka votuar, dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit. Pra, korniza ligjore nuk ka mangësi sa i përket sanksionimit të pothuaj të gjitha llojeve të cenimit të fshehtësisë së votës, megjithatë efektiviteti i ligjeve varet plotësisht nga zbatimi i tyre. Fotografimi i votës, votimi i hapur, si dhe votimi familjar, janë disa nga format që hasen më së shpeshti në qendrat e votimit gjatë proceseve zgjedhore në Kosovë. Sipas një raporti të vëzhgimit nga organizatat vendore për monitorimin e zgjedhjeve “Demokracia në Veprim”, dukuria e votimit familjar është hasur në 33.1% të vendvotimeve (DnV, 2014: 21).

### **3.5.2. Votimi i përgjithshëm – Universaliteti**

Sipas Komisionit të Venecias, Votimi universal konsiston në të drejtën zgjedhore aktive (e drejta për të votuar) si dhe pasive (e drejta për t'u zgjedhur). Me fjalë të tjera, votimi i përgjithshëm kërkon që të gjithë qytetarëve, të aftë sipas ligjit, t'u jipet e drejta e votës. Procedura e regjistrimit të votuesve duhet të jetë efektive, e paanshme, jo diskriminuese dhe e saktë, duke u garantuar të gjithë qytetarëve, të aftë sipas ligjit, të drejtën për të votuar dhe ua mbron këtë të drejtë kundër votimit në grup. Nuk duhet kurrësi të vendosen taksa për votimet ose pagesa për regjistrim. Gjithashtu, nuk duhet të ketë kurrfarë kufizimesh në procesin e votimit për persona që u përkasin pakicave kombëtare, që janë gra, ose që u takojnë grupeve të ndryshme qytetarësh. Të gjithë votuesit, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara fizike, duhet të kenë qasje të pacenuar në qendrat e votimit ose në procedurat e tjera të votimit.

Kushtetuta e Kosovës i garanton të drejtën e votës çdo personi mbi moshën 18

vjeçare, me kusht që ta ketë emrin në Regjistrin Qendror Civil. Votimi është i mundur për të gjithë votuesit me të drejtë vote që përkohësisht banojnë jashtë vendit ose janë zhvendosur nga Kosova. Për të gjithë personat me nevoja dhe rrethana të veçanta, KQZ përmes Ekipeve Lëvizëse në ditën e zgjedhjeve organizon procesin e votimit. Votuesit e paraparë në këtë kategori janë votuesit e ngjuar në shtëpi (për arsye fizike apo shëndetësore), votuesit me lëvizje të kufizuar në ndonjë institucion (hospitalizim, njerëzit e moshuar apo të burgosurit), si dhe votuesit në rrethana të veçanta (të zhvendosur nga vendi afër vendvotimit të tyre apo për shkaqe sigurie).

### 3.5.3. Votimi i drejtpërdrejtë

Zgjedhjet e drejtpërdrejta nënkuptojnë zgjedhjen e legjislativit në mënyrë të drejtpërdrejtë, në përputhje me Nenin 3 të Protokollit Shtesë të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Po kështu, pushteti lokal, që është një komponent jetik i demokracisë, nuk mund të konceptohet pa organe të zgjedhura lokale. Nga ana tjetër, zgjedhja e drejtpërdrejtë nga populli e Presidentit në vende të ndryshme edhe pse bëhet shpesh në praktikë, varet nga zgjedhja kushtetuese e çdo shteti.

Pushteti legjislativ në Kosovë ushtrohet nga Kuvendi, dhe zgjedhjet drejtpërdrejtë nga populli (Kushtetuta, Neni 63). Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale garantohet me Kushtetutë (Neni 123), rregullohet me ligj dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale. Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura drejtpërdrejtë nga qytetarët. Presidenti i Kosovës zgjedhet nga Kuvendi me votim të fshehtë dhe ka mandat 5-vjeçar (Kushtetuta, Neni 86).

### 3.5.4. Votimi i barabartë

Barazia në çështjet elektorale përfshin aspekte të shumta. Disa prej tyre kanë të bëjnë me barazinë në votim, që është një parim që aplikohet në të tërë kontinentin, ndërsa disa të tjera shkojnë përtej këtij koncepti dhe mendohet se nuk reflektojnë ndonjë standard të përbashkët. Parimet që duhen respektuar në të gjitha rastet janë barazia në votën numerike, barazia sa i përket fuqisë elektorale dhe mundësive të barabarta. Nga ana tjetër, nuk mund të imponohet barazia e rezultateve të arritura, për shembull, nëpërmjet përfaqësimit proporcional të partive ose barazia gjinore (Komisioni i Venecias, 2002).

Në Kosovë votuesit me të drejtë vote janë të barabartë në ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar dhe për të hedhur numër të barabartë të votave në zgjedhjet e njëjta. Çdo qytetar i Kosovës ka të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur pa

diskriminim në bazë të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, gjinisë, besimit fetar apo bindjes politike, arsimit, përkatësisë sociale apo ndonjë kriteri tjetër të ngjashëm. Përkundër asaj që Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës rekomandon që pragu për zgjedhjet parlamentare të mos jetë më i lartë se 3%, në Kosovë pragu zgjedhor është 5% dhe për më tepër lartësia e pragut është e njëjtë si për subjektet politike apo koalicionet partiake ashtu edhe për kandidatët e pavarur. Vendosja e pragut zgjedhor për kandidatët e pavarur është në kundërshtim me parimin e barabarësisë dhe të drejtës për zgjedhje të lira të paraparë me Nenin 3 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### **3.5.5. Votimi i lirë**

Votimi i lirë kërkon që të gjithë qytetarët të gëzojnë të drejtat e tyre themelore të lirisë së shprehjes, shoqërimit, mbledhjes dhe lëvizjes së lirë. Votimi i lirë përfshin dy aspekte të ndryshme: formimi i lirë i vullnetit të zgjedhësit, dhe liria e shprehjes së këtij vullneti, do të thotë liria e procedurës së votimit dhe vlerësimi i saktë i rezultatit (Komisioni i Venecias, 2002). Vëzhguesit vendas, si ata të partive (përfaqësues të kandidatit ose të partisë) ashtu edhe ata që nuk janë të partive, lypset të jenë të lirë ta vëzhgojnë procesin zgjedhor në të gjitha fazat e tij, para, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve (OSBE/ODIHR, 2006).

Parimet themelore të Kushtetutës së Kosovës garantojnë lirinë e shprehjes që përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush, lirinë e tubimit paqësor si dhe lirinë e asociimit që ndërthet të drejtën e çdonjërit për të themeluar organizatë pa patur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete e ndonjë organizate. Cenimi i përcaktimit të lirisë së votimit është i sanksionuar edhe me Kodin Penal të Kosovës që përcakton që kushdo që me përdorimin e dhunës, kanosjes serioze, ryshfetit ose duke keqpërdorur varësinë ekonomike apo profesionale të votuesit ndikon në votuesit në Kosovë që të votojnë në mënyrë të caktuar ose të mos votojnë në zgjedhje dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në tre vjet. Sa i përket aspektit të vëzhgimit të lirë të zgjedhjeve, duhet cekur se si vëzhguesit vendor ashtu edhe ata ndërkombëtarë kanë qasje të pakufizuar përgjatë gjithë procesit të vëzhgimit. Organizatat e interesuara për vëzhgimin e zgjedhjeve duhet të dorëzojnë kërkesën për akreditim pranë KQZ-së jo më vonë se njëzetepesë ditë para ditës së zgjedhjeve. Deri më tani nuk janë regjistruar raste të refuzimit të paarsyeshëm të kërkesave për vëzhgim si dhe legjislacioni nuk vendos barriera jashtë praktikave ndërkombëtare.

### 3.5.6. Zgjedhjet periodike

Zgjedhjet periodike bëjnë të mundur që zgjedhjet të zhvillohen në intervale të rregullta kohore, siç përcaktohet me ligj. Periudha kohore midis dy zgjedhjeve nuk duhet të tejzgjatet në mënyrë të paarsyeshme. Përgjithësisht, shtatë vjet konsiderohen si maksimumi i arsyeshëm kohor midis dy zgjedhjeve për shefin e ekzekutivit, ndonëse pjesa më e madhe e vendeve kanë zgjedhur një interval kohe ndërzgjedhor që shkon nga katër deri në pesë vjet. Periudha pesëvjeçare përgjithësisht shihet si maksimumi i arsyeshëm kohor për zgjedhjet për dhomën e ulët të parlamenteve (OSBE/ODIHR, 2006).

Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës shpallen nga Presidenti pas konsultimit me partitë politike, dhe këto mbahen çdo katër vjet. Zgjedhjet nuk mund të mbahen më heret se gjashtëdhjetë ditë dhe jo më vonë se tridhjetë ditë para përfundimit të mandatit. Sipas kompetencave të Presidentit të përcaktuara me Kushtetutë, vendimi i Presidentit për të caktuar datën e zgjedhjeve bëhet jo më herët se gjashtë dhe jo më vonë se katër muaj para datës së zgjedhjeve.

Blerim Murtezi

**PJESA E KATËRT**

**ORGANIZIMI I  
SUBJEKTEVE POLITIKE  
DHE DEMOKRACIA  
E BRENDSHME PARTIAKE**





## 4. ORGANIZIMI I SUBJEKTEVE POLITIKE DHE DEMOKRACIA E BRENDSHME PARTIAKE

### 4.1. Korniza ligjore

Veprimtaria e partive politike në Kosovë është e garantuar përmes Nenit 44.1 të Kushtetutës, si akti më i lartë politik dhe juridik i vendit. Sipas këtij Neni, liria e asociimit ndërthen të drejtën e çdonjërit për të themeluar një organizatë pa patur nevojë të sigurojë leje për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.

Për sa i përket të drejtave zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, Kushtetuta parasheh që çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor (Neni 45.1, 2008).

Procedurat për regjistrimin e partive politike në Kosovë përcaktohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes Rregullës Nr. 01/2013 për regjistrimin dhe veprimin e partive politike. Me anë të kësaj Rregulle, KQZ rregullon edhe procedurat për pezullimin, ankesat, bashkimin dhe shkrirjen e partive politike, përmbajtjen e statutit të partisë, kuvendet dhe çregjistrimet e partive politike.

Ndërkaq, certifikimi i subjekteve politike dhe i kandidatëve të tyre rregullohet nga KQZ përmes Rregullës Nr. 08/2013. Për më shumë, kjo Rregull ka për qëllim të rregullojë edhe arsyet e refuzimit të kërkesës për certifikim, ankesat e aplikuesve për certifikim, shqyrtimin e aplikacioneve, tërheqjen apo zëvendësimin e kandidatëve të subjekteve politike, ruajtjen dhe verifikimin e të dhënave të tyre, pagesën e certifikimit dhe renditjen në fletëvotim.

Sipas nenit 14.1 të Rregullës Nr. 01/2013 të KQZ-së për regjistrimin dhe veprimin e partive politike, çdo parti e regjistruar politike ka statutin me të cilin rregullohen

veprimet e partisë si tërësi, duke përfshirë edhe degët e saj. Madje, me anë të nenit 14.2 të kësaj Rregulle parashihet se çfarë përfshin statuti i partisë së regjistruar.

Në relacion me demokracinë e brendshme në partitë politike, sipas këtij neni, ndër të tjera, statuti i partisë së regjistruar politike përfshin: procedurat përmes të cilave qytetarët mund të bëhen anëtarë dhe të pushojnë të jenë anëtarë të partisë, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve; procedurat që duhen zbatuar për caktimin e kandidatëve të partisë në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe të kuvendeve komunale; mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar; dhe krijimin e një organi për zgjidhjen e kontesteve brenda partisë lidhur me interpretimin e statutit. Mirëpo, modalitetet e këtyre procedurave brenda partiake përcaktohen nga vetë partitë politike.

Ligji për Financimin e Subjekteve Politike rregullon mënyrën, kushtet e financimit, administrimin, mbikëqyrjen, transparencën dhe raportimin për shpenzimin e pasurisë dhe të të ardhurave të subjekteve politike në Republikën e Kosovës, ndërsa Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligji për Zgjedhjet Lokale rregullojnë aspektet e organizimit të zgjedhjeve dhe të shpërndarjes së vendeve në Kuvend.

Pra, sa i përket kornizes ligjore për rregullimin e veprimtarisë së subjekteve politike në Kosovë sfida mbetet regjistrimi dhe certifikimi i partive politike vetëm në bazë të rregullave të lartëcekura, e jo në bazë të një ligji të veçantë. Kjo praktikë mund t'nxisë fare lehtë praktika jodemokratike brenda partive politike, siç janë shkeljet e dispozitave të rregullave në fuqi dhe marrja e vendimeve përmes rrugëve jo formale. Për shembull, Partia e Komunitetit Turk, KDTP, dhe Nisma për Kosovën nuk kanë respektuar vendimin e KQZ-së për ndalimin e vendosjes së afisheve në hapësirat publike. (Telegrafi, 2014). Gjithashtu, ka raste kur vetë kandidatët për deputet i thyejnë rregullat e KQZ-së. (Zeri, 2014). Për më shumë, është i mundshëm edhe ndikimi politik në punën e KQZ-së, për aq sa ky institucion është i përbërë nga përfaqësuesit e partive politike. Në lidhje me këtë, KQZ-ja, në të kalurën është akuzuar nga aktorë të ndryshëm politik se po kontrollohet nga Qeveria, respektivisht nga partitë në pushtet (Albeu, 2013).

## 4.2. Organizimi i brendshëm i subjekteve politike në Kosovë

Në përgjithësi, të gjitha partitë politike në Kosovë, pos LVV-së, mund të klasifikohen në një skemë të ngjashme të organizimit. Në aspektin statutor, mënyra e organizimit në PDK, LDK, dhe AAK është e bazuar në Degë dhe Nëndegë në nivelin bazë, kurse organet drejtuese të këtyre partive janë: Kuvendi (LDK, AAK) apo Konventa (PDK),

Këshilli Drejtues (PDK, AAK) apo Këshilli i Përgjithshëm (LDK), dhe Kryesia e Partisë në të gjitha subjektet e përmendura. Përndryshe, mënyra e organizimit në LVV është e ndarë në tre nivele; niveli i parë organizativ i përbërë nga Këshilli i Pikës, niveli i dytë organizativ i përbërë nga Këshilli i Qendrës, Kryesia e Qendrës, dhe Sekretariati i Qendrës, dhe niveli i tretë organizativ i përbërë nga Këshilli i Përgjithshëm, Kryesia, dhe Sekretari i Përgjithshëm.

Degët, nëndegët (LDK) por edhe seksionet (PDK), dhe aktivet (AAK) janë njësi të organizimit dhe të veprimit territorial, ku në të gjitha subjektet politike, Degët apo Qendra (LVV) paraqesin nivelin më të lartë të organizimit në nivel komune (Statuti i PDK-së, neni 21-23); (Stauti i LDK-së, neni 16.2); (Statuti i AAK-së neni 4); (Statuti i LVV-së, neni.5).

Kuvendi në LDK (Statuti, neni 17) dhe AAK (Statuti, neni 13), Konventa e Përgjithshme në PDK, (Statuti, neni 30) paraqet organin më të lartë partiak. Në LVV në nivelin e tretë organizativ si organ më i lartë vendimmarrës konsiderohet Këshilli i Përgjithshëm, meqë ky subjekt nuk ka Kuvend apo Konventë të Përgjithshme. Mospasja e një organi të tillë mund të arsyetohet me faktin që për çështjet e ndryshme si zgjedhja e kryetarit të LVV-së, zgjedhja e kryetarit të Qendrës, programin politik etj, aktivistët e LVV-së votojnë nëpërmjet demokracisë së drejtpërdrejtë, me parimin një aktivist një votë (Statuti, neni 28). Kjo nënkupton që ndryshe nga subjektet tjera ku vetëm delegatët e Kuvendit/Konventës mund të votojnë për çështjejt që kanë të bëjnë më subjektin e tyre politik, në LVV një gjë e tillë është e mundur për të gjithë aktivistët. Pra, gjatë mbajtjes së zgjedhjeve të brendshme partiake, çdo aktivist që posedon librezën e LVV-së mund të paraqitet në ndonjërin prej Qendrave të votimeve dhe të votojë për çështje tëaktuara.

Këshilli Drejtues (PDK, AAK) apo Këshilli i Përgjithshëm (LDK, VV) është organi më i lartë vendimmarrës midis dy Kuvendeve/Konventave (PDK, LDK, AAK) (Statuti i PDK-së, neni 38); (Stauti i LDK-së, neni 22); (Statuti i AAK-së neni 18); (Statuti i LVV-së, neni 61). Kryesia Qendrore është organi më i lartë politik-ekzekutiv në të gjitha subjektet politike (Statuti i PDK-së, neni 43); (Statuti i LDK-së, neni 28); (Statuti i AAK-së, neni 21); (Statuti i LVV-së, neni 68).

Ajo çfarë mund të konkullojmë është se subjektet politike në Kosovë e kanë të rregulluara në baza statutotre ndarjen e organeve dhe kompetencave. Mirëpo, siç do të mund ta shohim në vazhdim të kësaj analize, në praktikë, mënyra si funksionon modeli organizativ i subjekteve politike në Kosovë bën që pavarësia e nivelit lokal të jetë e kufizuar, ndikimi i grave, të rinjve, dhe komuniteteve të jetë i zbehtë, postet e rëndësishme publike të jenë të “rezervuara” për anëtarët e organeve të larta partiake, si dhe i bën vendimet e liderëve të partive politike të pakontestuar.

### 4.3. Të drejtat dhe kufizimet e anëtarëve

Thuajse të gjitha subjektet politike në Kosovë parashohin kushte të ngjajshme apo të përafërta për qytetarët që dëshirojnë të anëtarësohen në parti. Në përgjithësi, obligimet e anëtarëve të subjekteve politike apo aktivisteve (LVV) janë të ndërlidhura me çështjet si: respektimi i statutit të partisë, gatishmëria për të marrë pjesë në përcaktimin dhe në realizimin e politikës partiake, përmbajtja ndaj vendimeve dhe synimeve programore të partisë, ruajtja e nderit, autoritetit dhe interesave të partisë, pranimi i vendimeve të shumicës dhe respektimi i mendimit ndryshe, pagesa e kuotës së anëtarësisë, e kështu me radhë. Përndryshe, sipas statutit të LVV-së nuk mund të jenë anëtar ata/ato që janë përfshirë në keqëpërdorim fondesh publike, akte terroriste, shërbime intelegjente apo mbrojtje të ideologjive fashiste (Statuti, neni 17). Statuti i PDK-së, LDK-së, dhe AAK-në nuk i rregullon këto aspekte.

Edhe të drejtat e anëtarëve janë shumë të përafërta në subjektet e ndryshme politike. Si të tilla, këto të drejta kanë të bëjnë kryesisht me: të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet partisë, të drejtën për t'u propozuar si kandidat në listat zgjedhore për zgjedhje parlamentare apo komunale, të drejtën për të marrë nisma dhe për të dhënë propozime që janë në përputhje me statutin e partisë etj. (Statuti i PDK-së, neni 16 dhe 17); (Statuti i LDK-së, neni 8 dhe 11); (Statuti i AAK-së neni 6); (Statuti i LVV-së, neni 22 dhe 27).

Sa i përket kufizimeve, në përgjithësi, anëtarët e subjekteve politike, nuk kanë të drejtë dhe mund të përjashtohen nga partia nëse: abuzojnë me vlerat themelore dhe objektivat e partisë, kryejnë veprime të cilat e sjellin partinë në situatë të palakmueshme apo diskredituese, veprojnë kundër kandidatëve të partisë së vetë në zgjedhjet parlamentare, lokale apo në nivele të tjera; ose nëse i përkrahin subjektet e tjera politike dhe kandidatët e tyre në zgjedhje.

Për masat disiplinore që mund të merren ndajë ndonjë anëtarin të partive politike, apo aktivisti (LVV) i cili i ka thyer parimet e lartcekura janë përgjegjëse Komisionet Disiplinore në bashkëpunim me Organet Qendrore apo organi që e ka pranuar anëtarin si në rastin e PDK-së (Statut, neni 17). Këto masa disiplinore kryesisht rezultojnë me vërejtje, pezullim të statusit së anëtarësisë për një kohë, dhe përjashtimin e anëtarëve nga radhët e partisë. Aktivistët e LVV mund të ballafaqohen me një masë të veçantë që nuk shqiptohet tek partitë tjera e cila mund të ju kërkojë atyre dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar ndaj Lëvizjes ose ndaj një aktivisti të saj (Statuti, neni 88). Sfidë në LVV konsiderohet të jetë edhe zbatimi i tërësishëm i demokracisë së drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesve sepse aktivistët janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Pikës dhe nëse mungojnë më shumë se tre herë humbin këtë status duke i shndërruar në simpatizantë (Statuti, neni 21). Sipas statutit të

LDK-së, anëtarët e saj mund të përjashtohen nga partia nëse e sjellin LDK-në në situatë të palakmueshme apo diskredituese, por nuk nuk bëhet e kjo se çfarë nënkupton situata e palakmueshme apo diskredituese.

Në praktikë, subjektet politike në Kosovë ballafaqohen me situata ku anëtarët heqin dorë nga statusi i tyre në parti si pasojë e pakënaqësive të llojeve të ndryshme. Në të shumtën e rasteve anëtarët që japin dorëheqje nga një subjekt politik më pas i bashkohen një subjekti tjetër politik apo themelojnë subjekt të ri politik (Krasniqi et al, 2012;5). Gjithashtu, kemi raste edhe kur anëtarët e një subjekti politikë përjashtohen nga vet subjekti (Telegrafi, 2015). Kjo shpie në përfundim se subjektet politike në Kosovë nuk kanë të krijuar një klimë demokratike brenda tyre dhe se tolerimi i fraksioneve brenda partiake është vështirë i tolerueshëm. Për shembull, mospajtimet në LDK bënë që pak para zgjedhjeve parlamentare në vitin 2007, një grup i anëtarëve të kësaj partie të ndahet dhe të krijojë subjektin e ri politikë të quajtur Lidhja Demokratike e Dardanisë (Gazeta Jeta në Kosovë, 2011). Pothuajse rast identik ndodhi edhe në PDK në vitin 2014 me ç'rast dy anëtar që mbanin poste të larta brenda partisë e krijuan subjektin e tyre politik të quajtur Nisma për Kosovën (Kosova Live, 2015).

#### **4.4. Funkcionimi dhe ndikimi i nivelit lokal**

Organizimi në nivel lokal, nuk shërben vetëm si kornizë për t'ia shprehur gatishmërinë e anëtarëve, por edhe si organizator i punës së subjekteve politike në terren, më së shumti gjatë periudhës së zgjedhjeve (Cular, 2004:37). Në të gjitha subjektet politike, Degët apo Qendra (LVV) paraqesin nivelin më të lartë organizativ në nivel komune. Për sa i përket pavarësisë së nivelit lokal në përzgjedhjen e kandidatëve për poste publike në nivel lokal, pothuajse sipas të gjitha statuteve të këtyre subjekteve politike, lista e kandidatëve për poste politike propozohet apo zgjedhet nga organet e Degëve të Partisë dhe miratohet në organet më të larta vendimmarrëse si Këshilli i Drejtues (AAK, PDK) apo Këshilli i Përgjithshëm (LDK), dhe në raste kërkohet edhe miratimi nga Kryetari i Partisë.

Në PDK, kandidatët për zgjedhje Komunale i propozon Kryesia e Partisë, ndërsa vendimin për miratimin e listës e merr Këshilli Drejtues i partisë (Statuti, neni 46) duke mos i lënë degëve kështu as rolin e propozuesit. Ndryshe nga PDK, në LDK është Kryesia e degës organi që vendos për listën e kandidatëve për këshilltarë të Asamblesë Komunale (Statuti, neni, 45.4). Kryesia e AAK-së me shumicë të thjeshtë votash miraton listën e Këshillit Drejtues (varësisht nga niveli i organizimit)

të kandidatëve, për këshilltarë në Kuvendin Komunal ndërsa pas aprovimit nga Kryesia, listat e kandidatëve i dërgohen për aprovim Këshillit Drejtues të AAK-së, në formë propozimi nga Kryetari i AAK-së (Statuti, neni 22.2). Në LVV lista e krijuar me kandidatë pas shqyrtimit nga Këshilli i Qendrës kalon në votim dhe në bazë të votave të fituara krijohet edhe lista zyrtare me kandidatët për Këshilltarë në Asamblenë Komunale (Statuti, neni 82.2).

Sa i përket nominimit për Kryetar Komune në PDK, kandidatët propozohen nga Komisioni për Burime Njërëzore (Statuti, neni 50), ndërsa vendimin për listën përfundimtare e merr Kryesia e Partisë (Statuti, neni 46&50). Kryesitë e Degëve në LDK propozojnë kandidatët për kryetar komune, kandidatura e të cilëve më pas miratohet nga Kryesia e partisë (Statuti, neni 30). Kryesia në AAK me shumicë të thjeshtë votash miraton listën e Këshillit Drejtues të kandidatëve për kryetarë të komunave. Pas aprovimit nga Kryesia, listat e kandidatëve i dërgohen për aprovim Këshillit Drejtues të AAK-së, në formë propozimi nga Kryetari i AAK-së (Statuti, neni 22). Kandidatët për Kryetar Komune në radhët e LVV propozohen ose vet-propozohen duke i mbledhur 1/5 e firmave të aktivistëve të një qendre ose duke i mbledhur 1/5 e firmave të delegatëve të Këshillit të Qendrës ku më pas kandidati për Kryetar Komune zgjidhet me votim në pika nga të gjithë aktivistët e komunës përkatëse (Statuti, neni 82.3).

Marrë parasysh numrin e kryetarëve të degëve që janë anëtarë të Këshillit Drejtues/Përgjithshëm në subjektet politike, dhe kufizimet statutore, me përjashtim të LVV-së, mund të themi që ndikimi i tyre në këtë trup të rëndësishëm organizativ është mjaft i zbehtë. Vetëm 19 anëtar (14%) nga 138 sa ka Këshilli Drejtues i PDK-së janë kryetar të degeve. Edhe në LDK, vetëm 27 anëtar (24%) nga 110 anëtar në Këshillin e Përgjithshëm janë kryetar të degëve. Situatë e njëjtë është edhe në AAK, ku 12 (12%) nga 100 anëtarët e Këshillit Drejtues janë kryetarë të degëve (KIPRED, Databazë e brendshme krahasuese). Çfarë mbetet edhe më shqetësuese, është fakti që statuti i LDK-së ua ndalon kryetarëve të degëve të drejtën për të votuar në mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm (Statuti, neni 23.7). Një gjë të tillë e ndalon edhe statuti i PDK-së (Statuti, neni 40). Në AAK një kufizim i tillë nuk është i paraparë me statut. Ndërsa LVV e përcakton qartë në statut që Këshilli i Përgjithshëm përbëhet nga Kryetarët e Qendrave dhe Delegatët e Qendrave (Statuti, neni 66).

Megjithëse statuti nuk ua ndalon, Kryetarët e Degëve janë të përfaqësuar në numër shumë të vogël në Kryesitë e subjekteve politike në Kosovë. Kjo gjë lë të kuptohet që ata kanë pak ose fare hiç ndikim në organin më të lartë ekzekutiv brenda partiak. Në PDK, 6 (20%) nga 30 anëtarët e Kryesisë janë kryetar dege. Në LDK, 6 (31%) nga 19 anëtarët e Kryesisë janë kryetar dege. Në AAK, 8(15%) nga 51 anëtarët e Kryesisë janë kryetar dege. Në LVV, 3 (21%) nga 17 anëtarët e Kryesisë janë koordinators të Qendrave (KIPRED, Databazë e brendshme krahasuese). Duhet cekur

gjithashtu që sipas statutit të LVV-së anëtar të Kryesisë nuk mund të jenë Kryetarët e Komunave, Këshilltarët Komunal, Deputetët, dhe anëtarët e Kabinetit Qeveritar (Statuti, neni 68.3).

Kufizimet e nivelit lokal mund të vërehen edhe nga këndvështrimi i koalicioneve para dhe pas zgjedhore ngase kompetencat për lidhjen e koalicioneve i përkasin organeve më të larta partiake. Në LDK, Kryesia e partisë vendosë për koalicione para dhe pas zgjedhore në nivel lokal (Statuti, neni 30) ndërsa në PDK për një gjë të tillë vendosë Këshilli Drejtues i partisë (Statuti, 42.14). Në AAK, është poashtu Këshilli Drejtues që shqyrton dhe miraton koalicionin në nivel lokal, mirëpo si të tilla, koalicionet duhet të jetë të miratuara paraprakisht nga Kryesia (Statuti, 18.7). Përndryshe, në LVV më parë ka mundur të ketë ndikim më të madhë të nivelit lokal në lidhjen e koalicioneve ngase anëtarët përmes parimit një aktivist një votë, kanë vendosur për koalicionet parazgjedhore me subjektet tjera politike, përveç në rastin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme, ku një vendim i tillë merrret nga Këshilli i Përgjithshëm i Lëvizjes (Statuti, neni 28). Mirëpo, në zgjedhjet e fundit të brendshme të mbajtura në vitin 2015, anëtarët përmes votimit, një aktivist një votë, kanë vendosur që këtë të drejtë të ia kalojnë Këshillit të Përgjithshëm (Vetëvendosje, 2015).

Në bazë të statuteve, delegimi i anëtarëve nga niveli lokal në Kuvendin Qendrorë (LDK, AAK), Konventën e Përgjithshme (PDK), dhe Këshillin e Përgjithshëm (LVV) është suksesshëm i aplikueshëm. Kuvendin e Qendror të AAK-së (Statuti, neni 14) dhe të LDK-së (Statuti, neni 42.3) e përbëjnë delegatët e degëve, të zgjedhur në Kuvendet e degëve. Delegatët e strukturave të Qendrës në Këshillin e Përgjithshëm të LVV-së zgjidhen me shumicë të thjeshtë votash të të gjithë anëtarëve të Këshillit të Qendrës (Statuti, 50.1). Konventën e Përgjithshme të PDK-së e përbëjnë edhe delegatët e zgjedhur përpjesëtimisht me numrin e votave të fituara në zgjedhjet e fundit (Statuti, neni 31).

**Tabela 5:** Kimi i nivelit lokal në nivelin qendror

Ndikimi i Nivelit Lokal në:						
Subjektet Politike	Kuvendin/Konventën Qëndror		Këshillin Drejtues/Përgjithshëm		Kryesinë Qëndrore	
	Sipas Statutit	Në Praktikë	Sipas Statutit	Në Praktikë	Sipas Statutit	Në Praktikë
<b>PDK</b>	I mundshëm	I mundshëm	Deri dikund i mundshëm	I kufizuar	I mundshëm	I kufizuar
<b>LDK</b>	I mundshëm	I mundshëm	I kufizuar	I kufizuar	I mundshëm	I kufizuar
<b>LVV</b>			I mundshëm	I mundshëm	I mundshëm	I kufizuar
<b>AAK</b>	I mundshëm	I mundshëm	I mundshëm	I kufizuar	I mundshëm	I kufizuar

Megjithëse delegimi i përfaqësuesve në Kuvendin/Konventen e përgjithshme të subjekteve politike është i rregulluar me statut, format joformale të vendimmarrjes janë të shpeshta dhe të fuqishme. Lideri dhe njerëzit e afërt me të ushtrjnë më tepër fuqi se sa u përcaktohet me statut. Vendime të rëndësishme për partinë merren në takime joformale (Jeta në Kosovë, 2012); (Lajmi, 2014); (Info Arkiva, 2013); (Blic, 2015). Këto forma joformale të vendimmarrjes shpesh paraqiten si mënyra kryesore e marrjes së vendimeve më të rëndësishme për partinë, duke i vënë në hije të gjitha organet e partisë dhe kërkesat e dala nga dokumentet themelore të partisë (Krasniqi et al, 2012).

#### **4.5. Roli i grave, të rinjëve, dhe komuniteteve në vendimmarrjen e partive politike**

LDK-ja përmes Statutit të saj parasheh Forumin e Gruas (FGLDK) dhe Forumin e Rinisë (FRLDK) si organe që kanë për detyrë realizimin e politikave të LDK-së në fushat në të cilat veprojnë dhe krijimin e politikave të qëndrueshme në fushat përkatëse (Statuti, neni 38). Organizimi dhe zgjedhjet e këtyre dy organeve rregullohen me rregullore të veçanta të cilat aprovohen nga Këshilli i Përgjithshëm i Partisë (Statuti, neni 45.5).

PDK-ja në statutit e saj përcakton taksativisht organizimin brenda partiak të grave dhe rinisë përmes Gruas Demokratike (GD) dhe Rinisë Demokratike (RD). Roli normativ i këtyre organizatave është promovimi i ideve, vlerave dhe vizionit PDK-së në grupet shoqërore në të cilat veprojnë, ndërsa puna e tyre rregullohet me rregullore të veçanta që miratohen nga kryesia e partisë (Statuti, neni 55).

AAK ka si formë të organizimit partiak të grave dhe të rinjve, Aleancën e Gruas të Kosovës (AGK) dhe Aleancën e të Rinjve të Kosovës (ARK) të cilat kanë strukturat e tyre dhe mund të zgjedhin akte por të cilat duhet të jenë në përputhje dhe kohezion me statutin e partisë (Statuti, neni 4).

LVV ndërkaq nuk parasheh formimin e organizatave të rinisë dhe të grave përbrenda strukturave të saj. Mirëpo, në nivelin lokal dhe atë nacional janë të parapara sekretariatet e gruas aktiviste, me çrast këto sekretariate kanë statusin e sekretariateve statutore, duke qenë njëherazi pjesë e sekretariatit të qendrave dhe sekretariatit të përgjithshëm (Statuti, neni 77).

Sa i përket përfaqësimit së Rinisë dhe Grave në organet vendimmarrëse të partisë në nivel lokal, statuti i PDK-së parasheh që kryetarët e Degëve të RD-së dhe GD-



së duhet të përfaqësohen në mënyrë *ex-officio* në Kryesitë e Degëve (Statuti, neni 24). Edhe në LDK përfaqësimi i kryetarëve të degëve të FRLD-së dhe GFLD-së në kryesitë e degëve është i rregulluar në mënyrë *ex-officio* (Statuti, neni 45.3). AAK është e vetmja parti politike në Kosovë që përveç që ka përfaqësim të AGK dhe ARK në kryesitë e degëve, ka paraparë edhe kuotën për gra dhe të rinj në që duhet të përfaqësohen në Këshillin Drejtues (Gjini, 2015).

Në nivelin qendror, përkatësisht në Kryesinë e Partisë, statuti i PDK-së parasheh përfaqësimin e Kryetarit të RD-së dhe Kryetares së GD-së. Gjithashtu, anëtarët e Kryesive Qendrore të RD-së dhe GD-së janë anëtarë të Kongresit të Përgjithshëm të PKD-së. Megjithatë, përfaqësimi i RD-së dhe GD-së në Këshillin Drejtues nuk është i paraparë i paraparë me statut. Por, prapë se prapë, 33 nga 110 anëtarët (30.0%) e Këshillit Drejtues të PDK-së janë gra (KIPRED, Databazë e brendshme krahasuese).

Në Kryesinë Qendrore të LDK-së është i paraparë përfaqësimi i Kryetarit të FRLDK-së dhe FGLDK-së (Neni 29.3). Në statutin e LDK-së gjithashtu kërkohet përfaqësimi i grave dhe të rinjve në Kuvendin e Përgjithshëm, por nuk parashihet ndonjë kuotë e përfaqësimit. Kryetari i FRLDK-së dhe FGLDK-së mund të merr pjesë në mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm të LDK-së por pa të drejtë vote, përveç nëse ata nuk janë anëtar të zgjedhur të këtij organi (Neni 23.7). Përkundër mungesës se kuotave, 22 nga 100 (22%) anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm janë të gjinisë femërore (KIPRED, Databazë e brendshme krahasuese).

Më lartë theksuam se LVV nuk ka brenda strukturës së saj organizatë të rinisë dhe grave, por, në aspektin faktik, 3 nga 15 (20%) të anëtareve të Kryesisë së LVV janë gra. 23.6% të anëtarëve në Këshillin e Përgjithshëm janë poashtu gra, ndërsa në Sekretariatit e Përgjithshëm ato përbëjnë 36.6% të anëtarësisë (KIPRED, Intervistë, 2015).

Në AAK, kemi rastin e vetëm ku parashihet kuota për përfaqësimin e grave dhe të rinjve në Këshillin Drejtues. Kështu, AKG dhe ARK përfaqësohen me nga 5 anëtarë në këtë organ (KIPRED, Intervistë, 2015) Përndryshe, në praktikë përfaqësimi i grave në Këshillin Drejtues e kalon kuotën ngase 25 (25%) nga 100 anëtarët janë gra. Për sa i përket gjendjes faktike të përfaqësimit, në Kryesinë e AAK-së gratë janë të përfaqësuar me 21.56%, apo 11 nga 51 anëtarët e saj (KIPRED, Databazë e brendshme krahasuese).

Siç mund të shihet, partitë parashohin organizime brenda-partiake për gratë dhe të rinjtë, përveç LVV që ka vetëm sekretariatit për çështje gjinore. Megjithatë, ato nuk kanë ndërtuar sistem të politik-bërjes partiake për rininë dhe gratë por më shumë thirrën në kulturën e konsultimeve brenda partiake (Peci, 2015). Këto rrethana kanë bërë që trajtimi i të rinjve dhe grave si në programet partiake ashtu edhe në ato zgjedhore të jetë shumë i vonë. Përfaqësimi i grave, në leadershipin e

partive politike nuk është i përkthyer proporcionalisht edhe në politik-bërje gjë që vë në pah disproporcionin e përfaqësimit vendimmarrës në raport me kapacitetin e politik-bërjes brenda partive politike në Kosovë (Peci, 2015).

Partitë politike të Kosovës, nuk kanë të zhvilluar sistem të politikë-bërjes për komunitetet etnike, dhe poashtu nuk kanë asnjë sektor partiak që merret me këto çështje. Politikë-bërja në këtë fushë është sporadike dhe reaktive, e cila është më tepër përgjigje ndaj kërkesave të përfaqësuesve politik të komuniteteve etnike në qeveri dhe parlament, dhe presionit të bashkësisë ndërkombëtare, se sa të krijimit të ideve dhe politikave pro-aktive të trajtimit të problemeve të tyre. Poashtu, një hendikep i madh është mos-ekzistenca e asnjë sektori politikë-bërës brenda partiak që do të merrej me komunitetet etnike. Në esencë, politika ndaj komuniteteve etnike në Kosovë, nga partitë me shumicë shqiptare trajtohet në praktikë si politikë qeveritare dhe legislative, dhe jo si politikë brenda-partiake (Peci, 2015).

#### 4.6. Zgjedhja e kandidatëve për poste publike

Një nga parimet bazë të demokracisë së brendshme të një subjekti politik është nominimi i kandidatëve për të garuar në zgjedhjet për poste publike, por, edhe për poste brenda partisë. Rekrutimi dhe selektimi i kandidateve është një detyrë kryesore për subjektet politike, sepse profilet e subjekteve politike përgjatë zgjedhjeve, dhe përderisa janë në detyrë, përcaktohen në masë të madhe nga kandidatët që janë zgjedhur dhe në atë mënyrë që qendron legjitimiteti i tyre (Scarrwo, 2005).

Pothuajse sipas të gjitha statuteve të këtyre subjekteve politike, lista e kandidatëve për poste politike propozohet apo zgjedhet nga organet e Degëve të Partisë dhe miratohet në organet më të larta vendimmarrëse si Këshilli i Përgjithshëm Drejtues, Kryesia e Përgjithshme apo Këshilli i Qendrës, varësisht nga emërtimi që subjektet politike ua bëjnë organeve të brendshme partiake, dhe në raste kërkohet edhe miratimi nga Kryetari i Partisë. Pra, subjektet politike që dëshirojnë të përfshijnë një rreth të gjerë të përkrahësve në proces, në përgjithësi mbështeten në mekanizmin e nominimit nga organet e partisë. Sipas statutit të PDK-së, kandidatët për deputet propozohen nga Komisioni për Burime Njerëzore (Statuti, neni 50) ndërsa pëlqimin përfundimtar e jepë Kryesia (Statuti, neni 46.11). Procedurë pothuajse e njëjtë është edhe në LDK, ku në bazë të listes iniciale të degëve, pas propozimit të Kryesisë, Këshilli i Përgjithshëm përcakton listën përfundimtare të kandidatëve të LDK-së për deputet në Kuvendin Kombëtar (Statuti, neni 24.1). Edhe në AAK, Këshilli Drejtues miraton listën për deputetë në Kuvendin e Kosovës, por, propozimi

i listës së kandidatëve bëhet nga Kryetari i partisë (Statuti, neni 18.6). Këshilli i Përgjithshëm i LVV miraton listën përfundimtare të kandidatëve për zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës me çrast  $\frac{3}{4}$  e listës së kandidatëve për deputetë zgjidhet nga Këshillat e Qendrave dhe duhet të jetë e përbërë me aktivistë të LVV (Statuti, neni 83.1) ndërsa edhe Kryetari i LVV i propozon kandidatët për deputet, të cilat miratohen me shumicë votash në mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm (Statuti, neni 83.6). Në praktikë, një numër i konsiderueshëm i kandidatëve për deputet janë edhe anëtar të Këshillit Drejtues/Përgjithshëm, organe të cilat marrin vendimin përfundimtar për listat e kandidatëve. Për të qenë më konkret, 55 (35%) nga 138 anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm në PDK kanë qenë kandidat për deputet nga radhët e kësaj partie në zgjedhjet e fundit në Kosovë. Në LDK, 39 (35%) nga 110 anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm kanë qenë kandidat për deputet në zgjedhjet e fundit. Në AAK, 37 (37%) nga 100 anëtarët e Këshillit Drejtues kanë qenë kandidat për deputet në zgjedhjet e fundit nacionale në Kosovë.

Në PDK, 25 (80%) e anëtarëve nga 31 sa ka gjithsej Kryesia Qendrore kanë qenë kandidat për deputet në zgjedhjet e fundit nacionale në Kosovë. Në LDK, 13 (68%) nga 19 anëtarët e Kryesisë kanë qenë kandidat për deputet në zgjedhjet e fundit. Në AAK, 32 (63%) nga 51 anëtarët e Kryesisë kanë qenë kandidat në zgjedhjet e fundit nacionale në Kosovë. Edhe në LVV, 8 (57%) nga 14 anëtarët e Kryesisë kanë qenë në mesin e kandidatëve për deputet në zgjedhjet e fundit. (KIPRED, Databazë e brendshme krahasuese). Këto të dhëna më së miri tregojnë që anëtarët e Kryesisë përveç funksionit të rëndësishëm që kanë në parti, të njëjtit kandidohen edhe për poste të larta shtetërore, siç është posti i deputetit. Për sa i përket nominimit për postin e Kryeministrit dhe ministrave, në PDK Kryetari së bashku me Kryesinë jep propozimin përfundimtar për listën e kandidatëve për ministra (Statuti, neni 37) me çrast edhe pëlqimi përfundimtar jepet nga Kryesia (Statuti, neni 46). Në LDK zgjedhja e kandidatëve për kryeministër bëhet me propozim të Kryesisë dhe me vendim të Këshillit Drejtues/ Përgjithshëm (Statuti, neni 24). Përderisa në AAK një gjë e tillë nuk është e përcaktuar me statut, kandidatët e LVV- së për Kryeministër propozohen nga  $\frac{1}{5}$  e Këshillit të Përgjithshëm dhe zgjidhen me shumicë të thjeshtë votash nga ky Këshill (Statuti, neni 85). Në praktikë, të gjithë të nominuarit për kryeministër në zgjedhjet e fundit nacionale në Kosovë janë liderë të subjekteve politike përkatëse. Njëherit, po të njëjtit janë edhe udhëheqës të organeve kompetente për propozimin dhe zgjedhjen e kandidatit për Kryeministër.

## 4.7. Roli i liderit të partisë

Në bazë të statuteve të subjekteve politike në Kosovë ndikimi i Kryetarit në procesin e vendimmarrjes brenda partiake por edhe jashtë saj është mjaft i fuqishëm. Në praktikë, subjektet politike nuk kanë një historik demokratik për sa i përket zgjedhjes së Kryetarit të partisë. Statuti i PDK-së përkufizon Kryetarin si udhëheqës që përfaqëson unitetin e të gjitha anëtarëve të partisë. Kryetari zgjedhet nga Konventa e Përgjithshme dhe mandati i tij zgjat katër vjet (Statuti, neni 36). Përveç që përfaqëson PDK-në në organe vendore dhe ndërkombëtare, Kryetari i PDK-së ka një set të kompetencave si në vijim: thërret dhe udhëheq mbledhjet e Kryesisë dhe të Këshillit Drejtues, së bashku me Kryesinë jep propozimin përfundimtar për listën e kandidatëve të PDK në Parlamentin e Republikës së Kosovës, së bashku me Kryesinë, me akt të veçantë, propozon përjashtimin nga PDK e të gjithë atyre që veprojnë në kundërshtim me politikat e PDK dhe nuk i përmbahen disiplinës partiake, në konsultim me Kryesinë dhe Këshillin Drejtues vendos të hyjë në koalicion para ose pas zgjedhor etj (Statuti, neni 37).

Kryetari i LDK-së zgjidhet në Kuvendin e partisë, me votim të fshehtë, me më shumë kandidatë. Njëherazi, LDK është subjekti i vetëm që me statut kërkon të ketë dy apo më shumë kandidat në garën për kryetar të partisë (Statuti, neni 25.1). Kryetari i LDK-së njëkohësisht është Kryetar i Kuvendit, i Këshillit të Përgjithshëm dhe i Kryesisë (Statuti, neni 25). Kryetari i LDK-së ndër të tjera është kompetent për ta përfaqësuar partinë brenda dhe jashtë vendit, për t'i udhëhequr punët e LDK-së dhe organëve të saj si të Kuvendit, Këshillit të Përgjithshëm dhe të Kryesisë, për të marrë vendime dhe qendrime politike e kështu më rradhë (Statuti, neni 25).

Edhe në AAK, Kryetari përfaqëson partinë në të gjitha nivelet. Kryetari i AAK-së udhëheq dhe thërret mbledhjet e Këshillit Drejtues dhe të Kryesisë, emëron këshilltarët e vet, emëron anëtarët e kabinetit të tij dhe e cakton delegacionin në takimet zyrtare etj (Statuti, neni 23). Kryetari i AAK-së ka edhe të drejtën e Kooptimit, që nënkupton që Kryetari i AAK-së (në të gjitha nivelet e organizimit) ka të drejtën të propozojë rritjen e anëtarëve të Kryesisë në çdo kohë dhe sipas nevojës (Statuti, neni 54).

Kryetari i LVV-së është përfaqësuesi më i lartë politik i cili e drejton Kryesinë mirëpo nuk mund të mbajë asnjë pozicion tjetër drejtues dhe të deleguar brenda strukturës së Lëvizjes. Për sa i përket detyrave, ndër të tjera Kryetari i LVV-së, i thërret dhe i drejton mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të Kryesisë së Lëvizjes, i cakton detyrat e anëtarëve të Kryesisë, e mbikëqyr punën e organeve ekzekutive dhe të organeve këshilluese të Lëvizjes (Statuti, neni 72). Në rast të

zgjedhjes së kryetarit të LVV-së si kryeminister, duhet te jap dorëheqje nga posti i kryetarit. (Statuti, neni 72.5).

Prej themelimit të saj në vitin 1999 e deri më sot, PDK-ja ka pasur vetëm një kryetar i cili në zgjedhjet e brendshme nuk ka pasur asnjëherë kundërkandidat për postin e të parit të partisë. (Gazeta Jeta ne Kosove, 2014). Madje edhe njeriu i dytë me i votuar në PDK pas liderit i cili haptazi kundërshtoi procesin e vendimmarrjes brenda partisë, nuk u kandidua për kryetar në zgjedhjet e brendshme të mbajtura në vitin 2012. Në vend të kësaj, ai themeloi një parti të re politike duke u ndarë komplet nga PDK-ja. (Kosova Live, 2015).

Në LDK zgjedhjet e brendshme me më shumë se një kandidat kanë filluar në vitin 2006, vetëm pas vdekjes së liderit të pakontestueshëm deri atëherë. Në zgjedhjet vijuese në Kuvendin e LDK-së, të mbajtura në vitin 2006 ishin dy kandidat për kryetar të partisë, mirëpo ai Kuvend nuk i ngjau aspak një Kuvendi demokratik pasi që përfundoi me konflikt verbal dhe fizik në mes të delegatëve. Përndryshe, në Kuvendin zgjedhor të mbajtur në vitin 2010 zgjedhjet në LDK u konsideruan si demokratike dhe në to u zhvillua një garë e rregullt në mes të dy kandidatëve për Kryetar të partisë (Evropa e Lirë, 2010).

Në zgjedhjet e fundit të mbajtura këtë vit kishte shumë paqartësi. Edhe pse statuti i LDK-së kërkonë që të ketë më shumë se një kandidat për kryetar të partisë, në zgjedhjet e fundit, kandidatja për kryetare të LDK-së nuk arriti t'a sfidojë liderin aktual, njëherit kryeminsiter i vendit dhe kandidat për të parin e partisë, sepse paraprakisht nuk kishte marrë 51% të votave për tu kandiduar për kryetare të LDK-së. Kjo praktikë e votimit për tu kandiduar u kundërshtua nga kandidatja në fjalë duke aluduar se po i mohohet e drejta për të qenë kandidate për kryetare të partisë, e drejtë e garantuar me statut të LDK-së. Si i vetmi kandidat, lideri i LDK-së u zgjedhë me aklomacion edhe për katër vjet e ardhshme në krye të partisë. (Zëri, 2015)

LVV-ja është themeluar më 12 qershor të vitit 2005. Aktivitetin e saj e kishte filluar si nismë qytetare, për t'i hyrë garës elektorale në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010. Që nga themelimi, e deri në vitin 2015 lider ishte themeluesi i saj. Këtë vit, LVV e ndryshoi kryetarin përmes votimit të drejtpërdrejt nga anëtarët, mirëpo, në zgjedhje kishte vetëm një kandidat për kryetar duke mos pasur kështu ndonjë garë të mirëfilltë që do të ofronte më shumë alternativa politike prej kandidatëve të ndryshëm (Vetëvendosje, 2015).

AAK-ja është themeluar më 2 maj 2000 si koalicion i 5 partive. Pas tërheqjes së dy partive nga koalicioni, AAK në vitin 2001 u regjistrua si parti e vetme e jo si koalicion. Që nga themelimi e deri më tani ka të njëjtin Kryetar. Madje edhe kur Kryetari i AAK-së për disa vite nuk mund ta ushtronte postin e tij për shkak se

ishte në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, AAK-ja nuk zgjodhi ndonjë Kryetar të ri. Edhe pas kthimit të tij, zgjedhjet e brendshme më shumë ishin formale ngase asnjëherë nuk kishte kundërkandidat për të marrë postin e Kryetarit të Partisë. Kundër-kandidat për kryetar të partisë nuk pritet të ketë as në zgjedhjet e brendshme të parapra të mbahen këtë vit (Albeu, 2015).

Violeta Haxholli

**PJESA E PESTË**

**FUSHATA  
E ZGJEDHJEVE  
PARLAMENTARE 2014  
NË KOSOVË**





## **5. Fushata e Zgjedhjeve Parlamentare 2014 në Kosovë**

### **5.1. Kuadri ligjor për organizimin dhe financimin e fushatës parazgjedhore**

Kroniza ligjore për fushata zgjedhore në Kosovë, është e përcaktuar nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe Ligji për Financimin e Subjekteve Politike, ligje këto të miratuara në vitin 2008 respektivisht 2010. Krahas legjislacionit primar, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) kishte miratuar në vitin 2013 katër rregulla zgjedhore, respektivisht Kodin e mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, kufizimin e shpenzimeve të fushatës dhe deklarimin financiar, rregullën fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike dhe rregulloren mbi financimin e subjekteve politike dhe sanksionet.

Sipas ligjit mbi zgjedhjet e përgjithshme “Aktivitet i Fushatës Politike” do të thotë çfarëdo tubimi ose fjalimi politik, mbledhje, prezantim publik, ose ndonjë aktivitet i përgatitur për të propaganduar mesazh politik në lidhje me zgjedhjet. Ky ligj përcakton edhe kuptimin e “Periudhës së fushatës”, që nënkupton periudhën prej tridhjetë (30) ditëve për fushatën zgjedhore të subjekteve politike që përfundon një (1) ditë para ditës së zgjedhjeve (Ligji Nr. 03/L-073, neni 3). Pavarësisht kësaj, fushata e zgjedhjeve të 8 qershorit 2014 zgjati vetëm dhjetë ditë. Ky afat u përcaktua nga KQZ si rezultat i shpërndarjes së Kuvendit me datën 7 maj 2014 dhe shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme nga presidentja një ditë më vonë.

Përderisa në ligjin për zgjedhjet e përgjithshme nuk është përcaktuar kuptimi i “para-fushatës” zgjedhore, projektligji për zgjedhjet e përgjithshme<sup>2</sup>, e definon

2 Ky projektligj është miratuar në lexim të parë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në prill të vitit 2014.

“Periudhën e Para-Fushatës Zgjedhore”, si periudha kohore që fillon nga shpallja e zgjedhjeve deri në ditën para fillimit të periudhës së fushatës zgjedhore, gjatë së cilës nuk mund të ndërmerret asnjë aktivitet i fushatës zgjedhore (Projektligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 3). Një mosdefinim i para-fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme, në zgjedhjet solli deri tek ndërmarrja e veprimeve dhe aktiviteteve të parakohshme të fushatës politike nga subjektet politike, të cilat mund të konsiderohen si propagim politik.

Për më tepër, Komisioni i Pavarur për Media (KPM) ka dhënë pesë vërejtje për publikim të spoteve reklamuese politike apo deklarime partiake para fillimit zyrtar të fushatës (Raport i Misionit të Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve – EU EOM, 2014:2). Megjithatë, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP), ankesat për vendosjen e posterëve/banerëve me elemente të fushatës zgjedhore në rrugë publike para fillimit zyrtar të saj, ka vendosur t’i shpallë të palejueshme, nën arsyetimin se as me Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme e as me rregullat zgjedhore nuk janë paraparë sanksione për veprimet e tilla (Vendimi Nr. 54/2014 i PZAP, 2014).

Ndalesa e ndërmarrjes së aktiviteteve të fushatës vlen edhe pas periudhës kur zyrtarisht mbyllet fushata, më saktësisht njëzetekatër (24) orë/ një ditë para ditës së zgjedhjeve si dhe gjatë procesit të votimit (Ligji Nr. 03/L-073, neni 36). Gjatë zgjedhjeve të fundit në Kosovë, PZAP ka pranuar 252 ankesa lidhur me periudhën para fushatës zgjedhore, periudhën gjatë fushatës zgjedhore, për thyerjen e heshtjes zgjedhore, për ditën e votimit si dhe rezultatin preliminar, për të cilat ka marrë vendime, duke u bazuar në veprimet e ndaluara, të përcaktuara në LZP dhe rregullat zgjedhore të lartpërmendura. Kështu nga PZAP u evidentuan rreth 70 shkelje nga subjektet politike dhe u shqiptuan gjopa për subjektet politike në vlerë prej 89.200 Euro (raportim i PZAP në Koha Net, më 13 qershor 2014).

Në ligjin për zgjedhjet e përgjithshme është e qartë se aktivitetet e rregullta zgjedhore duhen të ndërmerren vetëm gjatë interвалit kohor sa zgjatë fushata zgjedhore, dhe jo jashtë tij. Megjithatë, ky ligj nuk i parashihet decidivisht veprimet e parafushatës. Por, një interpretim logjik i ligjit për zgjedhjet e përgjithshme lë të kuptohet se në kohën e para fushatës nuk lejohet propagimi politik (Koha.net, 2014). Përveç tjerash, Ligji për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës përcakton edhe kornizate shpenzimeve për fushatë (Ligji Nr. 03/L-073, neni 3) dhe rregullon kufizimet e shpenzimeve për fushatë dhe obligimet për publikim financiar. Shpenzimet e fushatës së fundit zgjedhore në Kosovë janë kufizuar me rregullën zgjedhore 12/2013, dhe nuk mund të tejkalojnë 0.5 EUR për votues të regjistruar (Vendimi Nr. 903/2014 i KQZ-së, 2014). Detajet e raportimit të shpenzimeve të fushatës rregullohen me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP) dhe Rregullën Zgjedhore 12/2013.

Në përputhje me LFSP, Kuvendi i Republikës së Kosovës mund të ndajë mjete nga buxheti i shtetit për Fondin e financimit të fushatave zgjedhore, por jo më shumë se 0.05% të buxhetit. 90% të Fondit ndahen në bazë të numrit të vendeve në Kuvend, kurse 10% ndahen proporcionalisht për subjektet politike të posa regjistruara dhe të certifikuar për zgjedhjet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Në fillim të vitit 2014, KQZ ndau fondin mbështetës vetëm për tremujorin e parë të vitit (Vendimi Nr. 203-2014 i KQZ-së, 2014), ku përfitues të fondit ishin subjektet politike që ishin të përfaqësuara në legjislaturën e IV-të të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Mirëpo, pasi që zgjedhjet e 8 qershorit 2014 ishin të parakohshme, subjekteve politike nuk u janë ndarë para shtesë për pjesën tjetër të vitit (Raport i Misionit të Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, 2014:15), dhe për pasojë subjektet politike të përfaqësuara më parë në Kuvend mbetën pa asnjë fond mbështetës.

Me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike në vitin 2013, u shtuan edhe disa subjekte prej të cilave u ndalohej ndihma financiare subjekteve politike si p.sh. ndërmarrjet private gjersa janë në marrëdhënie kontraktuale për ofrimin e mallrave dhe kryerjen e shërbimeve me institucionet e Republikës së Kosovës, organizatat jo qeveritare, organizatat humanitare, organizatat fetare dhe organizatat sindikale (...) (Ligji Nr. 04/L-212, neni 6: paragrafët 1.6; 1.7; 1.8; 1.9). Sipas ligjit, poashtu asnjë donacion nuk mund të bëhet drejtpërdrejtë për kandidatin, por duhet të kalojë përmes subjektit politik.

Detyrimi për dorëzimin e Raportit Financiar të Fushatës është i përcaktuar si në LZP (Ligji Nr. 03/L-073, neni 40.1), ashtu edhe në LFSP (Ligji Nr. 03/L-174, neni 14: paragrafi 1.4). Sipas rregullës zgjedhore 12/2013, ky raport i dorëzohet Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike, jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve. Në pajtim me rregullën zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme dhe të jashtëzakonshme (Rregulla zgjedhore Nr. 15/2013, neni 3.2), periodha e mbulimit të raportimit financiar të fushatës është nga dita e shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme apo jashtëzakonshme e deri në ditën e zgjedhjeve.

Ndryshimi i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, ka sjellur edhe detyrimin për subjektet politike, që të publikojnë Raportin Financiar të Fushatës më së largu gjashtë (6) muaj pas ditës së mbajtjes së zgjedhjeve, dhe atë ta mbajnë së paku një vit në faqen e tyre zyrtare dhe ta publikojnë versionin e tyre të shkurtuar në njërin nga gazetaret kombëtare. Aktualisht<sup>3</sup>, edhe pse ende nuk ka kaluar një vit nga zgjedhjet e fundit të përgjithshme, nga katër subjektet kryesore politike (Partia Demokratike e Kosovës-PDK, Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK, Lëvizja Vetëvendosje-LVV dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK), vetëm dy nga to, LDK (Raporti Financiar i Fushatës së LDK-së, 2014) dhe LVV (Raporti Finan-

3 Qasja për herë të fundit në uebfaqet zyrtare të subjekteve politike të lartpërmenduar më 27.04.2015.

ciar i Fushatës së LVV-së, 2014) kanë të publikuar në faqen e tyre zyrtare raportet financiare të fushatës së fundit zgjedhore. Rrjedhimisht, të gjitha subjektet politike që nuk kanë publikuar raportet e tyre janë duke shkelur ligjet e përmendura më parë. Për më tepër, mospublikimi i raporteve financiare vë në pah mungesën e transparencës së subjekteve politike karshi votuesve të tyre.

Raportet Financiare të Fushatës përveç se dorëzohen nga subjektet politike në KQZ, ato i nënshtrohen procesit të auditimit në pajtim me standardet e kontabilitetit në Kosovë. Në pajtim me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike, auditimi kryhet nga auditorë të cilët i përzgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike nëpërmjet një thirrje të hapur publike për aplikim. Kriteret në bazë së të cilave përzgjedhen këta auditorë, janë të përcaktuara në ligj (Ligji Nr. 04/L-212, neni 11).

Për subjektet politike që nuk paraqesin Raportin Vjetor Financiar dhe Raportin e Deklarimit Financiar të Fushatës në afatin e paraparë me ligj, ligjvënësi ka paraparë gjobë me dhjetë përqind (10%) të shumës së realizuar nga Fondi në vitin paraprak dhe me gjobë ditore prej 0.01 % të shumës së gjobës bazë, deri në paraqitjen e raportit. Në anën tjetër, subjektet politike që nuk kanë marrë mjete nga fondi, gjobiten me gjobë bazike prej njëmijë (1000) Eurosh dhe me gjobë ditore prej 0.01 % të shumës së gjobës bazë, deri në paraqitjen e raportit (Ligji Nr. 04/L-212, neni 12). Për më tepër, të gjitha subjektet politike të cilat nuk paraqesin raportet në afatet e parapara me ligj, ato humbin të drejtën për të përfituar mjete nga Fondi për vitin e ardhshëm.

## 5.2. Programet e subjekteve politike për zgjedhjet e qershorit

Fushata e zgjedhjeve parlamentare të qershorit 2014 në Kosovë nuk dalloi shumë nga fushatat e zgjedhjeve të kaluara. Edhe këtë herë aktivitetet e partive politike u karakterizuan me premtime shumë ambicioze dhe objektiva vështirë të arritshme.

Programet e subjekteve më të mëdha politike vunë në pah edhe mungesën e qartë të profilizimit të tyre. Vërehej se shumica e këtyre subjekteve akoma funksiononin në sistemin e “Catch all Party”, që nënkupton të gjitha ato parti të cilat nuk kanë skemë të qartë programore dhe ideologjike mirëpo mundohen që përmes disa mekanizmave ad hoc të joshin grupe të njerëzve që vijnë nga shtresa të ndryshme të shoqërisë (Kirchheimer, 1966). Kështu, atyre u mungonte përcaktimi adekuat ideologjik, i cili është shumë i nevojshëm jo vetëm për subjektet politike të cilat do të kishin një format bazik të politikë-bërjes, mirëpo edhe për vet qytetarët për shkak

se në këtë formë është më e lehtë për ata (qytetarët) që t'i identifikojnë, orientojnë dhe avokojnë interesat e tyre në nivele të vendimmarrjes.

Subjektet politike më të mëdha garuese në zgjedhjet e qershorit, si Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Lëvizja Vetëvendosje dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) përpiluan programet e tyre qeverisëse që përshkruanin zgjidhje potenciale për problemet e shumta që i brengosnin shumicën e qytetarëve të vendit. Programet e partive politike dukeshin të hartuara në atë mënyrë që të jenë të kënaqshme për secilën shtresë të shoqërisë. Kurse, shprehja “zhvillim ekonomik” ishte emëruesi i përbashkët i pothuajse të gjitha subjekteve politike.

Programet e subjekteve më të mëdha politike karakterizoheshin nga njëra tjera në disa aspekte (Shih tabelën 1). P.sh PDK me programin e quajtur Misioni i Ri – kishte për qëllim, siç pohonte, zhvillimin e hovshëm ekonomik, themelimin e Fondit të Punësimit për krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe përshpejtimin e integritimit Euro-Atlantik (Programi qeverisës i PDK-së, 2014). Kjo do të bëhej përmes disa hapave si, investimi në bujqësi, në industri, në fuqizimin e sektorit privat dhe tërheqjes së investimeve të huaja. Kështu, qëllimi bazë ishte tendenca për të fuqizuar ndërmarrjet e vogla/mesme, për të zëvendësuar importin me produkte vendore. Megjithatë, kur bëhet fjalë për sistemin tatimor, në programin e këtij subjekti nuk definohej qartë se cila formë e tatimeve do të përdorej (Programi qeverisës i PDK-së, 2014).

Programi i LDK-së për dallim nga subjektet tjera kishte si pikë qendrore zhvillimin ekonomik dhe një pjesë e madhe e programit të këtij subjekti trajtonte këtë fushë (Programi qeverisës i LDK-së, 2014). LDK-ja, si një parti tashmë e profilizuar e qendrës së djathtë, përmes programit të saj, orientoi objektivat e saj kundrejtë zhvillimit të sektorit privat, më saktësisht në zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogle e të Mesme (NVM). Kjo ndodhi për dy arsye; a) sepse 99% e ndërmarrjeve në Kosovë janë NVM (Programi qeverisës i LDK-së, 2014) dhe b) sepse NVM-të punësojnë 80% të të punësuarve në sektorin privat dhe në këtë formë synote rritjen e elektoratit të partisë. Përderisa PDK e LDK bënë premtime për mundësinë e zhvillimit të NVM-ve, AAK, përmes programit “Drejtimi i ri” pretendonte diçka më të madhe. Në funksion të zhvillimit ekonomik mendohej përdorimi i resurseve natyrore (industria e rendë), thithja e investimeve të huaja direkte dhe për më tepër do të bëhej përshtatja e politikave kreditore dhe kushtet për koncensionim të pasurive (Programi qeverisës i AAK-së, 2014). E gjithë kjo përmes zhvillimit të minierave dhe energjetikës. Politikë e drejtëpërdrejtë e Alenacës në këtë fushë do të ishte edhe ndërtimi i termocentraleve të reja si p.sh “Kosova C” ( Programi qeverisës i AAK-së, 2014).

Ndërkaq për dallim prej partive te tjera, Lëvizja Vetëvendosje theksoi platformën e saj për zhvillimin e ndërmarrjeve prodhuese dhe zhvillimin e industrisë në një formë më ndryshe. Në programin e tij ky subjekt synonte që përmes fuqizimit të kompanive publike të fillojë rivitalizimin e ekonomisë së Kosovës. (Programi i shkurtë LVV-së, pika 52). Megjithatë, programi i saj ishte paksa kontradiktor. P.sh përderisa, në një nga objektivat e programit të Lëvizjes Vetëvendosje në aspektin ekonomik ishin edhe lehtësirat për diasporën shqiptare për të investuar në kompani publike e private (Programi i shkurtë i LVV-së, pika 49), ata shfaqeshin kundër çdo lloj privatizimi dhe dhënie me koncesion të ndërmarrjeve publike (Programi i shkurtë LVV-së, pika 56)

**Tabela 6:** Pikëpamjet programore të subjekteve politike në pesë fusha

	Politikat tatimore	Shëndetësia	Politika e jashtme	Arsimi	Zhvillimi Ekonomik
PDK	Sigurimi i një sistemi të thjeshtë tatimor, (mirëpo nuk precizohet qartë se cili sistem do të përdoret). Ulje e normave tatimore, përmes të cilave synohet stimulimi i bizneseve.	Reformim i sektorit të shëndetësisë, zbatimi i sigurimit shëndetësor. Financim adekuat dhe i qëndrueshëm i shëndetësisë.	Ruajtja e sovranitetit, integritetit territorial dhe rendit kushtetues. Forcimi i diplomacisë ekonomike. Normalizimi marrëdhënieve me Serbinë. Njohja e pavarësisë së Kosovës dhe integrimi në BE, NATO dhe OKB.	Aftësimi i nxënësve, studentëve dhe mësimit dhënë sipas ofertave të tregut të punës.	Krijimi i fondit për punësim (200.000 vende të reja të punës) Lehtësira fiskale dhe financiare. Fuqizimi i dialogut publiko-privat.
LDK	Përdorimi i një sistemi të thjeshtë tatimor, nëpërmjet shpërndarjes së barrës tatimore proporcionalisht.	Zhvillimi dhe avancimi i sistemit shëndetësor, Sistemi i financuar përmes shtimit të fondeve publike, dhe partneritetit publiko-privat.	Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare Integrimi mbarëshqiptar dhe bashkëpunimi i ngushtë me komuna shqiptare në rajon.	Sistemi arsimor gjithëpërfshirës dhe shkollim në përputhje me tregun e punës. Adoptim të sistemit "Life-long-learning" dhe zhvillim i sektorit privat të arsimit.	Zhvillim ekonomik përmes zhvillimit të sektorit privat, me fokus në mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla e të mesme (NMV).
LVV	Sistemi i tatimit progresiv.	Sigurim shëndetësor për të punësuarit e sektorit publik - i menaxhuar nga kompani publike.	Mbrojtja e interesave të Kosovës dhe kombëtare të shqiptarëve. Politikë e jashtme unike me Shqipërinë. Qasje ndryshe për shtetet që respektojnë shtetësinë e Kosovës prej atyre që nuk e bëjnë atë.	Arsimi publik në të gjitha nivelet duhet të jetë falas për të gjithë. Krijimi dhe financimi i instituteve shkencore.	Rritje ekonomike, e punësimit, dhe e mirëqenies. Zëvendësimi i importit me produktet vendore. Kundër privatizimit dhe koncesionimit të ndërmarrjeve publike

AAK	<p>Nuk do të ketë rritje të normave të tatimeve, por do të ketë shtrirje të mbledhjes së obligimeve fiskale.</p> <p>Bizneset e reja që hapin 10 vende pune do të lirohen nga tatimi në fitim për 3 vitet e para të punës.</p>	<p>Themelimi i fondit publik të sigurimeve shëndetësore të financuar nga Ministria e Shëndetësisë.</p> <p>Ligji i ri për reformë në shëndetësi dhe shërbime kualitative për qytetarët.</p>	<p>Diplomacia si një instrument për sjellje të investimeve.</p> <p>Ruajtje dhe forcim të marrëdhënieve me SHBA-të.</p> <p>Integrim në BE.</p>	<p>Dyfishim të buxhetit për arsim.</p> <p>Adoptimi i sistemit Life-long-learning dhe depolitizim i arsimit të lartë.</p>	<p>Zhvillim i mbështetur në resurse natyrore (industrinë e rëndë).</p> <p>Sigurimi i investimeve të huaja direkte.</p> <p>Themelimi i fondit garantues për bizneset e vogla dhe të mesme.</p>
-----	---	--	---	--	---

*Burimi: Programet qeverisëse të subjekteve politike respektive për vitin 2014.*

Pavarësisht pikëpamjeve të ndryshme të këtyre subjekteve mbi fusha të ndryshme, disa nga pikat e përbashkëta të programeve të tyre, ishin investimet potenciale dhe hapja e vendeve të reja të punës, të cilat në realitet ishin vështirë të arritshme. Me nivel të papunësisë në vend me diku rreth 44% prej të cilëve rreth 70% të rinjë të papunë (Raport i UNDP-së, 2014), PDK dhe AAK premtoan 200.000 vende të reja të punës secila, ndërsa LDK 120.000 të tilla. Fakti se pse punësimi në ato shifra ishte vështirë i arritshëm lidhet me kapacitetet e dobëta ekonomiko-administrative të Kosovës për të realizuar premtimet mbi ato shifra (Raportet e Komisionit Evropian për Kosovën).

Subjektet më të mëdha politike shpалosën programet e tyre kryesisht në bastionet e tyre kryesore rajonale dhe orientuan strategjinë e tyre në dy fronte: njëri kishte të bënte me ruajtjen e votave nëpër bastionet e tyre amë, ndërsa tjetri në mundësinë e zgjerimit të elektoratit të tyre në rajone të reja. Kështu, në rastin e PDK-së shembulli më tipik për të ilustruar këto fronte është edhe deklarata e kryetarit të kësaj partie dhe ish-kryeministrit Thaçi e bërë në rajonin e Skenderaj-it ku deklaroi se “*Vota kundër PDK-së është votë kundër Drenicës*” (fjalimi i kryetarit të PDK-së, Skenderaj, Maj 2014). Fronti i dytë u pasua nga një numër i madh i vizitave të kryetarit të kësaj partie nëpër komuna ku kjo parti nuk kishte numër aq të madh të votave krahasuar me subjektet e tjera politike. Pëveç PDK-së, kryesisht strategjia e shumicës së subjekteve më të mëdha politike që garonin në këto zgjedhje, u orientua në frontin e dytë.

Mungesa e precizimit të programeve qeverisëse mbi rajone specifike la hapësirë për manovrimet me premtime përgjatë fushatës. P.sh PDK premtoante investime në spitalet, bizneset e qyteteve të ndryshme etj, por ato projekte nuk figuronin në programin e këtij subjekti (fjalim i H.Thaçit në Ferizaj, më 3 qershor 2014). Përrjashtim nga ideja e premtimeve për investime të mëdha nuk pati as LDK-ja (Programi Qeverisës i LDK-së, 2014), megjithatë, programi i LDK-së kishte deri diku përputhje mes asaj që premtohej përgjatë fushatës dhe asaj çfarë shkruhej në program. Për ilustrim,

përgjatë fushatës në Anamoravë (Gjilan) ky subjekt premtoi autostradën Prishtinë-Gjilan-Bujanovc projekt ky i cili përshkruhej edhe në programin e këtij subjekti.

Po ashtu, në programet e subjekteve politike mungonin detajet lidhur me mënyrën e realizimit të objektivave të tyre. Kjo reflektohej edhe në premtimet që subjektet politike dhanë gjatë fushatës së tyre parazgjedhore. Për ilustrim, AAK-ja, gjatë shpalosjes së programit të saj në regjionin e Anamoravës premtonte zhvillim ekonomik, mirëpo duke mos e specifikuar se në çfarë forme do të arrihej ai dhe në cilin sektor do të koncentroheshin investimet (AAK, fushata në Gjilan, Qershor 2014).

### **5.3. Ndikimi i vendimeve të qeverisë në fushatën parazgjedhore**

Fushata e zgjedhjeve parlamentare të 8 qeshorit 2014 në Kosovë u karakterizua ndër të tjera edhe me një sërë vendimesh të marra nga Qeveria e Kosovës (QeK) në krye me Partinë Demokratike të Kosovës (PDK)-në. Me këto vendime PDK kishte për qëllim rritjen dhe ruajtjen e elektoratit të saj në zgjedhje. PDK ishte shtytëse e shumicës së vendimeve të votuara nga qeveria e Kosovës ndërsa edhe pse qeveria përbëhej edhe nga partnerë të tjerë qeverisës si, Aleanca Kosova e Re (AKR), Partia e Drejtësisë (PD) dhe Partitë e Minoriteteve, ndikimi i tyre në qeveri ishte më i ulët.

Para caktimit të datës së 8 qershorit 2014 si datë për mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare, data tjera konsideroheshin si potenciale për mbajtjen e zgjedhjeve, që në muajt e parë të vitit. Prandaj, edhe qeveria kishte filluar të marrë vendime të mëdha që nga fillimi i muajit shkurt 2014.

Kështu, në mbledhjen e saj të 5 shkurtit qeveria aprovoi Projektligjin për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (Vendimi Nr.01/169 i QeK, 2014), i cili parashihet të ketë implikime buxhetore në vlerë prej 24 milion Euro në vit (Buxheti i Kosovës, 2015). Si parti e krahut të luftës, veteranët vazhdonin të ishin një nga grupet më të rëndësishme dhe më me ndikim të PDK-së.

Përveç kësaj kategorie të popullësisë, qeveria shenjoj edhe një pjesë tjetër të madhe të elektoratit, përkatësisht popullatën e punësuar në sektorin publik. Kështu, me 10 Mars, Qeveria mori vendim për rritjen e pagave për 25% për të gjitha të punësuarit në sektorin publik. Për 25% u rriten edhe pensionet dhe kompensimet për disa kategori tjera të personave (Vendimi Nr. 01/176 i QeK, 2014).

Në kuadër të përfitimeve për të punësuarit në sektorin publik, katër ditë më vonë qeveria aprovoi edhe projekt marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e ashtëquajtur Kontrata Kolektive (Vendimi Nr.02/177 i QeK, 2014). Po në këtë



mblledhje, qeveria ndryshoi edhe vendimin e saj të 10 marsit për rritjen e pagave, duke përjashtuar nga ky vendim zyrtarët e lartë publik. Për më tepër, mjetet e parapara për rritjen e pagave të këtyre zyrtarëve të përjashtuar nga kjo rritje, do të destinoheshin për krijimin e një programi në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë për shërimin e fëmijëve të sëmurë nga kanceri, leukemia dhe sëmundje tjera të ngjashme (Vendimi Nr. 03/177 i QeK, 2014).

Përveç vendimeve nga të cilat përfitonin kategori të caktuara të popullsisë, Qeveria mori po ashtu vendim për krijimin e zonave të lira ekonomike që kishin për qëllim tërheqjen e investimeve të huaja dhe vendore, përmirësimin e kushteve për zhvillim të bizneseve dhe ngritjes së standardit të jetesës dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Kështu, në mblledhjen e 18 marsit u morr vendim për krijimin e Zonës së Lirë Ekonomike në Zonën Kadastrale të Gjakovës (Vendimi Nr.02/178 i QeK, 2014). Ky propozim erdhi nga partneri në koalicion qeverisës i PDK-së, Aleanca Kosova e Re (AKR) e cila qeveriste komunën e Gjakovës, që nga zgjedhjet lokale të dhjetorit 2013, ndërsa kryetarja e kësaj komune para marrjes së këtij posti ishte edhe zëvendës-kryeministere në qeverinë në detyrë. Po në këtë mblledhje të qeverisë, u krijua edhe Zona e Lirë Ekonomike në Zonën Kadastrale të Mitrovicës (Vendimi Nr. 03/178 i QeK, 2014), ndërsa më 28 mars u mor vendim edhe për krijimin e Zonës së Lirë Ekonomike në Zonën Kadastrale të Prizrenit (Vendimi Nr. 01/180 i QeK, 2014). Në të dy këto qytete PDK synonte ruajtjen dhe rritjen e votave të elektoratit të saj.

Përveç vendimit të lartpërmendur, i cili mjetet nga përjashtimi i zyrtarëve të lartë publik nga rritja e pagave i destinonte për shërimin e fëmijëve të sëmurë (Vendimi Nr. 03/177 i QeK, 2014), më 2 prill qeveria mori edhe një vendim tjetër, për të ndarë 1 milion Euro për shërimin e këtyre fëmijëve (Vendimi Nr. 17/181 i QeK, 2014). Ky vendim mund të sillte edhe vota potenciale për partinë tjetër të koalicionit qeverisës, PD-në, njëri nga anëtarët e së cilës ishte edhe Ministër i Shëndetësisë. Po ashtu në po të njëjten mblledhje të qeverisë, u morr vendim për ndarjen e shumës prej 150 mijë Euro në vit për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve, që përfshinte shfrytëzimin e të hollave për nevojat e strehimit, riintegrimin të grave dhe fëmijëve, kompensimin e viktimave, edukimin kundër dhunës në familje dhe zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (Vendimi Nr. 18/181 i QeK, 2014).

Në po këtë mblledhje u morr edhe një vendim shumë i rëndësishëm për një kategori tjetër të popullësisë, të konsiderueshme në numër, përkatësisht nxënësit dhe studentët e Kosovës. Ky vendim kishte të bënte me uljen e pagesave për semestra për 50%, për studentët e studimeve Bachelor dhe Master në Universitetet publike dhe ulja e pagesave për 50% për ushqim në Mensë dhe strehim në Konvikte (Vendimi Nr.19/181 i QeK, 2014).

Përveç përjashtimit të zyrtarëve të lartë publik nga rritja e pagave, në mbledhjen e 11 prillit të qeverisë, u vendos edhe për përjashtimin nga rritja e pagave edhe për udhëheqësit, anëtarët e bordeve dhe të emëruarit e tjerë të të gjitha agjencive dhe institucioneve të pavaruara të emëruar dhe zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës (Vendimi Nr. 02/182 i QeK, 2014).

Në vazhden e vendimeve të natyrës sociale, Qeveria mori edhe një vendim që preku drejtpërdrejt buxhetin e familjeve kosovare me asistencë sociale, përkatësisht rreth faturave të energjisë elektrike. Në mbledhjen e saj më 18 prill, qeveria me vendim i rekomandoi Bordit të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), që të analizonte mundësinë që këtyre familjeve t'u shlyeshin borxhet ndaj KEK-ut (Vendimi Nr.02/183 i QeK, 2014).

Përveç veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Qeveria mori një vendim tjetër i cili ndikonte në një kategori tjetër, atë të burgosurve dhe të përndjekurve politik. Kështu në mbledhjen e saj të 22 prillit qeveria vendosi që mjete në vlerë prej 5 milionë Euro për vitin 2014, të transferoheshin për kompensimin e të burgosurve dhe të përndjekurve politik (Vendimi Nr.02/184 i QeK, 2014).

Disa ditë më vonë, përkatësisht më 25 prill 2014 qeveria aprovoi edhe projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve rreth Forcave të Armatosura të Kosovës (Vendimi Nr.04/185 i QeK, 2014). Poashtu, po në këtë ditë qeveria përfshiu në rend të ditës benefite të mëtutjeshme për nxënësit dhe studentët, duke vendosur që të gjithë studentët që fillonin studimet në Universitetin Publik të kenë falas vitin e parë të studimeve. Më tej, numri i studentëve që përfitonin bursa do të rritej nga 1000 në 1500. Gjithashtu, për familjet kosovare që kishin më tepër se një student në universitete do të paguanin vetëm për njërin nga këta student, kurse të tjerët do të studionin falas (Vendimi Nr.07/185 i QeK, 2014).

Sa më shumë që afrohej data e zgjedhjeve të 8 qershorit qeveria shpejtonte me marrjen e vendimeve të mëdha që synonin mbajtjen dhe rritjen e votave në zgjedhje. Vetëm në një nga mbledhjet e saj qeveria mori edhe vendimet si në vijim. Më 23 Maj 2014, vetëm dy javë para mbajtjes së zgjedhjeve, qeveria mori vendim për themelimin e një komisioni qeveritar i cili kishte për detyrë kryerjen e analizave përkatëse për themelimin e Fondit për punësim dhe zhvillim (Vendimi Nr.04/189 i QeK, 2014).

Edhe marrëdhëniet me Shqipërinë u vunë në shërbim të fushatës, dhe në të njejtën ditë qeveria mori vendim për themelimin e të ashtëquajturës, Task Forca Ndërinstitucionale për Lehtësimin e Lëvizjes së Personave, Mjeteve dhe Mallrave në Kufirin Kosovë – Shqipëri (Vendim Nr. 05/189 i QeK, 2014).<sup>4</sup>

4 Kjo task forcë u themelua me qëllim të përshpejtitimit të lëvizjes së pasagjerëve, mjeteve të transportit, tranzitimit të mallrave Kosovë- Shqipëri dhe anasjelltas, përshpejtimin dhe thjeshtësimin e kontrolleve policore të migracionit, unifikimin dhe njohjen reciproke të dokumenteve të kontrollit

Me qëllim të tërheqjes së elektoratit nga rajone që për shumë kohë kishin qenë bastione të subjekteve tjera politike, një nga vendimet e qeverisë ishte edhe inicimi dhe zhvillimi i procedurave ligjore për themelimin e Komunës së re të Kijevës, Komoranit, Rugovë të Pejës si dhe Hogosht të Kamenicës (Vendim Nr. 12/189, 2014).

Ky numër i madh vendimesh të marra nga qeveria, e udhëhequr nga koalicioni në krye me PDK-në, i mundësoi kësaj të fundit që të shfrytëzonte kapitalin dhe mjetet institucionale në favor të fushatës së saj parazgjedhore. Në fund, edhe rezultati zgjedhor nxorri të parën në zgjedhje pikërisht këtë parti.

#### **5.4. Hapësira mediale për fushatën parazgjedhore të subjekteve politike**

Fushata për zgjedhjet e 8 qershorit 2014 në Kosovë zyrtarisht filloi më 28 maj dhe u vendos që të zgjaste vetëm 10 ditë. Ky shkurtim pati ndikim negativ në mbulimin mediatik të fushatës, pasi subjektet politike blenë në mënyrë masive programet e sponzoruar, duke kufizuar kështu mbulimin jo-komercial të fushatës dhe duke shtyrë subjektet politike që të bëjnë fushatë para fushatës. Kështu ato filluan aktivitetet dhe lobimin në media dhe më gjerë, shumë kohë para se fushata të fillonte zyrtarisht. Kjo ndodhi si rezultat edhe i mangësive ligjore të cilat nuk përcaktonin decidivisht sjelljet e subjekteve politike para fushatës. Kjo situatë minoi edhe mbulimin e barabartë të subjekteve politike dhe panshmërinë e mediave (Raporti i EU EOM, 2014:17). Sipas raporteve ndërkombëtare, subjektet e vogla politike kishin pasur mbulueshmëri më të ulët mediale gjatë fushatës parazgjedhore nga televizionet kryesore në vend. P.sh Aleanca Kosova e Re (AKR) dhe NISMA patën mbulueshmëri më të vogël në edicionet e lajmeve të RTV21 dhe Klan Kosova (Raporti i EU EOM, 2014:18).

Hapësira e sponzoruar në televizione ishte mjeti më i përdorur nga subjektet politike në fushatën parazgjedhore. Aktivitetet e sponzoruar patën hapësirën më të madhe në televizionet kryesore duke minimizuar kështu mbulimin jo-komercial (Raporti i EU EOM, 2014:18). Ndërsa, hapësira më e madhe e programit të sponzoruar ishte nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). (Raporti i EU EOM, 2014:18). Sipas raportimeve të organizatave të shoqërisë civile nga monitorimi

---

fitosanitar dhe peshën e mallit, si dhe realizimin e ndërhyrjeve emergjente infrastrukturore dhe procedural në funksion të rritjes së fluksit të pasagjerëve dhe të mallrave. Poashtu, edhe projektimin e ndërhyrjeve afatmesme me synim të krijimit të një terminali të përbashkët doganor-poligor.

i mediave gjatë fushatës së zgjedhjeve parlamentare 2014, nuk ishte vërejtur ndonjë anshmëri e dukshme e tyre në mbulimin jo-komercial të aktiviteteve të subjekteve politike (Raport i Demokracia në Veprim - DnV, 2014:66). Megjithatë, vërehet se ka pasur disa dallime në përqindje të mbulimit nga mediat e ndryshme. P.sh aktivitetet e fushatës së PDK-së ishin transmetuar më shumë në televizionet kryesore, për dallim nga subjektet tjera politike. Poashtu, radiotelevizioni Publik i Kosovës (RTK1) i kishte dhënë hapësirën më të madhe PDK-së për dallim nga subjektet tjera garuese në zgjedhjet e qershorit (Raport i DnV, 2014:17). Edhe EU EOM nga analiza e monitorimit ka gjetur se PDK-së i është dhënë më shumë hapësirë në edicionet e lajmeve të mbrëmjes në RTK, për më tepër ende pa filluar zyrtarisht fushata parazgjedhore (Raport i EU EOM, 2014:17). PDK ka pasur edhe numrin më të madh të spoteve dhe transmetimeve të sponsoruara në këtë televizion, me gjithsej 321 spote dhe 11 prezantime për dallim nga koalicionet dhe subjektet tjera (Raport i DnV, 2014:19). Ky televizion është akuzuar vazhdimisht nga subjektet e tjera politike dhe shoqëria civile për afërsinë me partinë në pushtet, PDK. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) renditej e dyta sa i përket raportimeve të aktiviteteve nga fushata zgjedhore nga RTK1, megjithsej 137 spote dhe 4 transmetime të sponsorizuara ndërsa, AAKme 113 spote dhe asnjë transmetim të sponsorizuar. Sa i përket raportimeve të aktiviteteve të fushatës, PDK ka pasur hapësirën më të madhe edhe në televizionet tjera si Klan Kosova (Raport i EU EOM, 2014:6) dhe Radio Televizioni 21 (RTV21) (Raport i EU EOM, 2014:13) Ndërsa, vetëm në televizionin Koha Vizion (KTV) ky subjekt ka pasur mbulueshmëri shumë të vogël në krahasim me televizionet e lartpërmendura (Raport i EU EOM, 2014:8). Kjo mund të jetë për faktin se ky televizion ka kundërshtuar disa herë politikat e qeverisë së kaluar e udhëhequr nga kolacioni në krye me PDK-në. Ndërsa, edhe EU EOM ka konstatuar se “*Grupi KOHAKanë pasur qëndrim të qartë negativ ndaj PDK-së*” (Raport i EU EOM, 2014:18).

Sa i përket mediave të shkruara, hapësira e cila iu rezervua subjekteve politike garuese në zgjedhjet e 8 qershorit, shfaqti edhe afërsinë e përfolur të këtyre mediave me subjektet respektive politike. P.sh Gazeta Kosova Sot, numrin më të madh të artikujve rreth fushatës e pati për PDK-në (Raport i DnV, 2014:27). Afërsia e kësaj gazete me këtë parti u dëshmuar edhe me anëtarësimin e drejtoreshës së kësaj gazete dhe emërimin e saj në pozitën e nënkryetarës së kësaj partie disa javë para mbajtjes së zgjedhjeve (Zëri, 2014). E natyrës së ngjashme ishte edhe situata me kalimin e kryeredaktorit të Bota Press në LDK (Indeksonline, 2014), ndërsa po në këtë gazetë hapësira më e madhe i ishte dhënë LDK-së në artikujt rreth fushatës parazgjedhore (Raport i DnV, 2014:20). Nga mediat e shkruara vetëm Koha Ditore kishte mbuluar deri diku në mënyrë të barabartë me artikuj informativ të gjitha subjektet politike garuese në zgjedhje. (Raport i DnV, 2014:25).

## PËRFUNDIM

Përshkrimi dhe analiza e sistemit politik, atij partiak dhe zgjedhor, e demokracisë brendapartiake në partitë politike të Kosovës, si dhe e fushatave që i zhvillojnë partitë politike të Kosovës, që janë dhënë në punimin tonë, ofrojnë një varg konkluzionesh interesante dhe të rëndësishme për çështjet e shqyrtuara.

Së pari, janë përmendur specifikat e zhvillimit historik të sistemit politik që përvojën e Kosovës në zhvillimin e këtij sistemi e bëjnë specifike dhe të dallueshme nga përvojat e vendeve të tjera. Këtu duhet theksuar para së gjithash faktin e analizuar që viti 1989 në Kosovë nuk e shënoi kalimin nga sistemi njëpartiak në atë shumëpartiak, si në vendet e tjera ish-komuniste, por kalimin nga një sistem njëpartiak komunist në një sistem njëpartiak të djathtë. Në vendet e tjera, që nga viti 1989 e tutje, partitë komuniste kaluan në opozitë, ndërkaq, në Kosovë ato u zhdukën fare. Ndërkohë që regjistrimi i partive të reja ishte i mundshëm dhe i lejuar – dhe shumë parti të tjera të reja edhe u regjistruan dhe e filluan veprimtarinë politike – ato asnjë herë nuk ia dolën t’i bëheshin opozitë e mirëfilltë Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), që ishte partia e parë që u shfaq me rastin e kalimit në sistemin shumëpartiak, dhe në dy zgjedhjet që u mbajtën gjatë viteve 1990 ato së bashku nuk i fituan as 5% të votave. Krijimi i opozitës së mirëfilltë ndaj LDK-së ndodhi vetëm pas Konferencës së Dejtonit, kur qasja e saj lidhur me përpjekjet për pavarësimin e Kosovës u sfidua nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), nga e cila, më vonë, dolën partitë e reja që morën pjesë në krijimin e skenës shumëpartiake të Kosovës së pasluftës. Me fjalë të tjera, skena shumëpartiake në Kosovë u krijua si pasojë e mospajtimeve të brendshme lidhur me mënyrën e pavarësimit të Kosovës, jo si pasojë e vetëdijes për ndonjë nevojë të fuqishme për liberalizimin dhe demokratizimin e saj – edhe pse, duhet theksuar, LDK-ja, me përqendrimin e saj në aktivitetin qytetar bëri shumë në përparimin e liberalizimit të shoqërisë kosovare.

Po ashtu, është theksuar që problemi kryesor i sistemit të tashëm politik të Kosovës është pozita tejet e fuqishme (faktike) e Qeverisë së Kosovës ndaj pozitës së Presidentit dhe Kuvendit, dhe, posaçërisht, ndaj gjyqësorit. Në tryezën e rrumbullaket me temë “Subjektet Politike në Kosovë: Demokracia e Brendshme, Sistemi Politik dhe Fushata Zgjedhore” që KIPRED-i e organizoi gjatë qershorit 2015 si një nga aktivitetet e zhvilluara në kuadrin e programit të RRPP-së, njëri nga pjesëmarrësit (Jakup Krasniqi nga subjekti NISMA) këtë problem e theksoi për mrekulli duke thënë që sot Kosova është republikë qeveritare, jo republikë parlamentare. Një ide që është sugjeruar për zgjidhjen e këtij problemi është ajo e përzgjedhjes së Presidentit të Kosovës me votim, jo nga Kuvendi. Këtu nuk është sugjeruar që Kosova

të kalojë në sistem presidencial – ndonjë kompetencë shtesë që do të mund t'i jipej Presidentit do të duhej të mendohet, jo si kompetencë që e rrit fuqinë e tij/saj, por si një që Presidentit do t'i mundësonte ta kundërbalancojë pothuaj gjithëpushtetshmërinë e Qeverisë në një mënyrë më të efektshme.

Gjashhtëmbëdhjetë vite pas luftës dhe shtatë vite pas shpalljes së pavarësisë, Kosova përballet me mungesë të demokracisë së mirëfilltë në sistemin partiak të saj. Ndërkohë që baza juridike lidhur me krijimin dhe funksionimin e partive politike të Kosovës është në përputhje me praktikën më të mira të kohës, ekzistojnë shpërputhje serioze sa i përket dinamikave brendapartiake dhe nevojave të mirëfillta të shoqërisë. Problemi kryesor qëndron në atë që mekanizmat për garantimin e respektimit të legjislacionit lidhur me funksionimin e partive politike nuk janë të fuqizuara deri në atë masë sa të jenë në gjendje t'i mbikëqyrin në mënyrë të efektshme veprimet dhe veprimtaritë e partive politike, dhe t'i sanksionojnë ato kur bëjnë shkelje të ligjeve. Kjo është ajo që mundëson zhvillimin e praktikave jodemokratike brenda partive politike kosovare. Fakti që skena politike e Kosovës është e tillë që ardhja në pushtet e partive të reja është tejet e vështirë pa lidhjen e koalicioneve me partitë më të vjetra, e vështirëson tej mase ndryshimin për të mirë të gjendjes ekzistuese – nevoja e partive të reja për të lidhur koalicione me të vjetrat, bën që partitë e reja të jenë të detyruara “t'i respektojnë rregullat e lojës,” d.m.th. t'i përvetësojnë praktikën jodemokratike. Po ashtu, një nga faktorët e tjerë të shumtë të analizuar është edhe ai që anëtarë të caktuar të partive politike kanë kontrollimin e plotë të fuqisë së partisë: lideri partiak dhe njerëzit rreth tij kanë më tepër fuqi se që ju takon me statut, dhe këta mjaft shpesh marrin vendime duke i anashkaluar të gjitha organet e partisë së tyre dhe konkluzionet që dalin nga dokumentet bazë të partisë. Është e qartë që vendimmarrja joformale është një pengesë tejet e zymtë për demokratizimin e partive politike.

Sa i përket sistemit zgjedhor, janë treguar dhe analizuar faktorët që kanë ndikuar në atë që Kosova ta përvetësojë sistemin që e ka, dhe është treguar si ky sistem zgjedhor, më tutje, ndikon në rrjedhat e tashme politike të partive të Kosovës. Janë trajtuar ndryshimet në sistemin zgjedhor të pasluftës – kalimi nga sistemi me lista të mbyllura në atë me lista të hapura me 10 kandidatë, dhe kalimi i mëpastajmë në listat e hapura me nga 5 kandidatë. Pjesa lidhur me sistemin zgjedhor të Kosovës e ofron një pasqyrë sistematike të qartë të tipareve të ndryshme të këtij sistemi.

Demokracia brendapartiake përballet me një varg problemesh serioze: në këtë punim janë përmendur dhe analizuar më të rëndësishmet, siç janë shmangia e fërkimeve brendapartiake, kompetencat e kufizuara të strukturave në nivelin lokal, pjesëmarrja e dobët e grave, të rinjve dhe komuniteteve në partitë politike të Kosovës, ndikimi tejet i fuqishëm i organeve qendrore dhe, posaçërisht, i liderëve partiakë, si dhe mbajtja e posteve të rëndësishme publike nga udhëheqësitë e partive.

Partitë politike të Kosovës nuk e kanë zhvilluar kulturën e lejimit të fërkimeve brendapartiake. Si pasojë, anëtarët e pakënaqur me partitë e tyre politike, shumë më shpesh e braktisin partinë dhe i bashkëngjiten ndonjë partie tjetër, apo, edhe krijojnë parti të reja, se që përpiqen të bëjnë ndonjë ndryshim brenda partisë që i takojnë. Nga ana tjetër, niveli lokal brenda partive politike të Kosovës ka më tepër rol propozues se vendimmarrës. Në baza statutore kjo është posaçërisht e theksuar tek ndikimi i nivelit lokal në Këshillin Drejtues/të Përgjithshëm, ndërkaq, ndikimi në Kuvend/Konventë është paksa më i madh. Po ashtu, gara për liderë të partive nuk i përmbush kriteret e një gare korrekte dhe demokratike. Në shumicën e rasteve, liderët nuk kanë konkurrencë në zgjedhjet e brendshme, dhe këta janë të prirur të ushtrojnë presione të ndryshme joformale gjatë tyre. Po ashtu, punimi vjen në përfundim që korniza ligjore lidhur me fushatat zgjedhore të partive politike të Kosovës është joadekate për adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Këtu janë posaçërisht të theksuara problemet që kanë të bëjnë me definimin ligjor të veprimeve të partive para dhe gjatë fushatës, si dhe ato që kanë të bëjnë me përgjegjshmërinë dhe transparencën e tyre lidhur me shpenzimet gjatë fushatës. Për këtë arsye, punimi propozon amandamentimin e ligjeve përkatëse, ashtu që në mënyrë eksplicite të definohen dhe sanksionohen shkeljet nga ana e partive politike gjatë fushatës. Këtu është posaçërisht i rëndësishëm krijimi i kushteve për sanksionimin e subjekteve politike për mostransparencë financiare, ashtu që brenda tyre të rritet ndjenja e nevojës për llogaridhënie për shpenzimet e bëra. Ndër të tjera, në pjesën për fushatën, trajtohen premtimet vigane që partitë politike e kanë zakon t'i japin gjatë fushatave zgjedhore, që nuk përkojnë me mundësitë e shtetit. Po ashtu, gjatë fushatës partitë politike japin vetëm në vija të vrazhda programet e tyre për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve, pa dhënë shpjegime të hollësishme si do t'i përmbushin këto qëllime.

Njëri nga problemet më të zymta të Kosovës sa i përket fushatave parazgjedhore të partive politike është ai që partitë në pushtet këtë e shfrytëzojnë për promovimin e tyre gjatë fushatës. Kësisoj, në zgjedhjet e fundit (qershor 2014), që nga fillimi i vitit e deri në disa ditë para zgjedhjeve, Qeveria e Kosovës ndërmoi mbi njëzet vendime që targetonin kategori të ndryshme të popullsisë me qëllim të marrjes së votave të tyre për partinë në pushtet. Kjo jo vetëm që pati implikime të mëdha dhe të dëmshme për buxhetin e shtetit, por edhe e dëmtoi jashtëzakonisht shumë garën e drejtë zgjedhore midis partisë në pushtet dhe subjekteve të tjera politike të Kosovës. Në fund, ky punim, pos përfundimeve që i ofron lidhur me çështjet e shqyrtuara, e ofron një bazë të mirë për krahasimin e mënyrës si këto çështje janë të rregulluara në Kosovë, me mënyrën si këto janë të rregulluara në vendet e tjera të rajonit – punimi që e ofron këtë krahasim do ta vijojë punimin e tashëm.

## Literatura

- Abazi, B. (2015). Intervistë verbale. (L. Peci, Intervistues) Prishtinë, Kosovë.
- Agani, Fehmi (1999) Pavarësia: Gjasa dhe Shpresë. Pejë: Dukagjini.
- Agani, Mentor (2015, forthcoming) The Integration of Kosovo's Political Parties in International Political Party Organizations: An Explanation of the Delay. Prishtina: KIPRED and KAS.
- Agani, Mentor (red.) (2012) Civil Society in Kosovo Since 1999. Prishtinë: RRPP and CPC.
- Agani, Mentor and Istrefi, Remzije (2011) The Promise of 1989 – Kosovo's Lost Treasure., fq. 177-202, në: Hayoz, Nicolas, Jesien, Leszek, Koleva, Daniela (red.), 20 Years After the Collapse of Communism: Expectations, Achievements and disillusion of 1989. Bern: Peter Lang.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (2012). Regjistrimi i popullsisë së Kosovës. <http://esk.rks-gov.net/rekos2011/?cid=2,40> (28.03.2015).
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (2013) Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore 2013 në Kosovë [https://ask.rks-gov.net/dmdocuments/LFS\\_ALB%202014.pdf](https://ask.rks-gov.net/dmdocuments/LFS_ALB%202014.pdf) (data e qasjes)
- Ahtisaari, Martti (2007) The Comprehensive Proposal for Kosovo Status Settlement.
- Albeu (2013). Nisin zgjedhjet në AAK, Haradinaj pa rivalë. Prishtinë, Kosovë. Marrë nga: <http://www.albeu.com/kosove/nisin-zgjedhjet-ne-aak-haradinaj-pa-rivale/192757/>
- Albeu (2013). Qeveria po kontrollon KQZ-në. Prishtinë, Kosovë. Marrë nga: <http://www.albeu.com/kosove/qeveria-po-kontrollon-kqz-ne/122750/>
- Berisha, D. dhe Morina, R. (2012). Zgjedhjet për Qytetarin. Prishtinë: KIPRED.
- Carothers, Thomas (2006) Confronting the Weakest Link. Aiding Political Parties in New Democracies. [http://carnegieendowment.org/files/carothers\\_fes\\_review.pdf](http://carnegieendowment.org/files/carothers_fes_review.pdf) (data e qasjes)
- Cular, G. (2004). Organisational Development of Parties and Internal Party Democracy in Croatia . Politicka misao , XLI, pp. 28-51.
- D4D (2011). Zbërthimi i trendëve zgjedhore 2000-2010. Prishtinë: Demokraci për Zhvillim.



- Dahlerup, D. (2006). *Gratë, Kuotat dhe Politika*. Londër: Routledge.
- Daskalovski, Z. (2012). Demokracia e brendshme partiake në Kosovë. Prishtinë, Kosovë: Qendra për Hulumtim dhe Ndërtim të Politikave.
- Daskalovski, Zhidas (2012) Demokracia e brendshme partiake. Konrad Adenauer Stiftung. Qendra për hulumtim dhe ndërtim të politikave. Prishtinë.
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.(1948). Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.
- Demokracia në Veprim (DnV) (2014, Korrik). Monitorimi i Mediave, Fushata Zgjedhore 2014. Prishtinë, Kosovë. I qasshëm në: <http://www.demokracianeveprim.org/publikime/MM-ALB-2014.pdf>
- DnV (2014).Zgjedhje të jashtëzakonshme me sfida të zakonshme.Prishtinë: Demokracia në Veprim.
- Dugolli, I. dhe Malazogu L. (2006). Trendet e Votimit 2000-2004. Prishtinë: KIPRED.
- Ehrke, Michael (2010) Organisations Based on Political Convictions or Management Agencies for the Government? Social Democratic Parties in Central and Southeast Europe. Friedrich Ebert Stiftung. <http://library.fes.de/pdf-files/id/ipa/07059.pdf> (data e qasjes)
- Ellis, A. (2007). Votimi nga jashtë: Manuali ndërkombëtar IDEA. Stockholm, Suedi: IDEA Ndërkombëtare.
- European Network of Election Monitoring Organizations (2010), <http://goo.gl/d7VyZT> (data e qasjes)
- European Union External Action (2013) Kosovo and Serbia reach landmark deal <http://goo.gl/mjfUxL> (data e qasjes)
- Evropa e Lirë (2010). Isa Mustafa zgjidhet kryetar i LDK-së. Prishtinë, Kosovë. Marrë nga: <http://www.evropaelire.org/content/article/2212983.html>
- Gallagher, M. (2005). *Politika e sistemeve zgjedhore*. Oxford: Oxford University Press.
- Gazeta Blic (2015). Arben Gecaj thotë se në VV nuk pati zgjedhje, por thjesht emërime. Prishtinë, Kosovë. Marrë nga <http://gazetablic.com/arben-gecaj-thotes-ne-vv-nuk-pati-zgjedhje-por-thjesht-emerime/>
- Gazeta jeta në Kosovë (2011). Nexhat Daci kryetarë i LDD-së. Prishtinë, Kosovë. Marrë nga: <http://gazetajnk.com/?cid=1,975,88>
- Gazeta Jeta në Kosovë (2015). Shqetësime se PDK në Drenas Favorizon Strukturën Aktuale. Prishtinë, Kosovë. Marrë ngaf <http://gazetajnk.com/?cid=1,3,3798>

Gazeta Jeta në Kosovë (2015). Zgjedhje- Levizje e sigurt për Thaqin. Prishtinë, Kosovë. Marrë nga <http://gazetajnk.com/?cid=1,3,3852>

Gratë në parlamentet: Klasifikimi botëror. (n.d.). <http://www.ipu.org/wmn-e/classif.htm> (08.02.2015)

Gjini, A. (2015). Intervistë Verbale. (L. Peci, Intervistues) Prishtinë, Kosovë.

Hofmeister, Wilhelm, dhe Grabov, Karsten (2013). Partitë politike, funksioni dhe organizimi në shoqëritë demokratike. Fq. 94-115. Xhemaj, Bashmir, Partitë Politike në Kosovë, Konrad Adenauer Stiftung. Prishtinë.

Horowitz, D. (2003). Sistemet zgjedhore dhe qëllimet e tyre: udhërrëfyes për vendimmarrësit.

Indeksonline (2014, Prill 22). Bajrush Morina i bashkohet LDK-së. Marrë nga: <http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=94250>

Info Arkiva (2015). Quhen parregullsi zgjedhjet e AAK-së, njoftohet Haradinaj. Prishtinë, Kosovë. Marrë nga <http://www.arkivalajmeve.com/Quhen-parregullsi-zgjedhjet-e-AAK-se-njoftohet-Haradinaj.1047337077/>

Iniciativa Kosova për Stabilitet (2011) Abetarja e Pushtetit: Libërth mbi politikën, njerëzit dhe partitë në Kosovë, Prishtinë <http://goo.gl/UJEScR> (data e qasjes)

International Court of Justice (2010) Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo <http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15987.pdf>

International Crisis Group (2001) Kosova, zgjedhje historike <http://goo.gl/8tXi95> (data e qasjes)

Jeta në Kosovë (2015). Shqetësime se PDK në Drenas Favorizon Strukturën Aktuale. Prishtinë, Kosovë. Marrë nga Gazeta Jeta në Kosovë: <http://gazetajnk.com/?cid=1,3,3798>

Karta Evropiane për Vetë-Qeverisjen Lokale (ETS 122).

Karvonen, L. (2004). Votimi preferencial: Incidenca dhe efektet. IPSP.

Katz, R. (1980). Teoria e partive dhe sistemet zgjedhore. Baltimore: John Hopkins University Press.

Kodi i praktikës së mirë në çështjet zgjedhore: Udhëzimet dhe raporti shpjegues: Miratuar nga Komisioni i Venecias në sesionin e tij të 52-të (të Venecias 18-19 tetor 2002). (2003). Strasburg: Këshilli i Evropës.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

Koha (2014) KQZ certifikon 30 parti politike për zgjedhjet e 8 qershorit <http://koha.net/?id=27&l=10821> (data e qasjes)

Koha.net (2014, Maj 19). Para-fushata zgjedhore shkel ligjin. Deklaratë e Fisnik Korenica. Marrë nga: <http://koha.net/?id=27&l=10664>

Komisioni Evropian (2012) Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin mbi Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës, Bruksel <http://goo.gl/6ha4TZ> (data e qasjes)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2011) Rezultatet e Përgjithshme nga KQZ, Prishtinë, Kosovë <http://goo.gl/EB0xSO>(data e qasjes)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2014) Rezultatet e Certifikuara nga KQZ, Prishtinë, Kosovë <http://goo.gl/BZLzgr> (data e qasjes)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2014). Vendimi Nr. 203-2014 për caktimin e lartësisë së mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike për (3)mu-jorin e parë 2014. I qasshëm në: [http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/Vendime\\_iagaqytplp.pdf](http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/Vendime_iagaqytplp.pdf)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2014). Vendimi Nr. 903/2014 për kufizimin e shpenzimeve të fushatës të subjekteve politike. I qasshëm në: [http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/Vendim%20per%20kufizimin%20e%20shpenzimeve%20te%20fushates%20te%20SP-ve\\_tkxtdgyiaw.pdf](http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/Vendim%20per%20kufizimin%20e%20shpenzimeve%20te%20fushates%20te%20SP-ve_tkxtdgyiaw.pdf)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2015) Rregullat zgjedhore <http://www.kqz-ks.org/sq/rregullat-zgjedhore> (data e qasjes)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2015) Themelimi dhe organizimi <http://www.kqz-ks.org/sq/themelimi-dhe-organizimi> (data e qasjes)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2015) Zgjedhjet e përgjithshme <http://goo.gl/DfWLyO> (data e qasjes)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2015) Zyra për RPPC, Prishtinë, Kosovë <http://goo.gl/FsKoNr> (data e qasjes)

Komisioni Qendror Zgjedhor (2013, Korrik 3). Rregulla zgjedhore Nr. 11/2013, Kodi i mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit dhe e tyre dhe kandidatët. Prishtinë, Kosovë. E qasshme në [http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/11\\_tkgfyjmmjg.PDF](http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/11_tkgfyjmmjg.PDF)

Komisioni Qendror Zgjedhor (2013, Korrik 3). Rregulla zgjedhore Nr. 12/2013, Kufizimi i shpenzimeve të fushatës dhe deklarimi financiar. Prishtinë, Kosovë. E qasshme në [http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/12\\_skpqycwllj.PDF](http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/12_skpqycwllj.PDF)

Komisioni Qendror Zgjedhor (2013, Korrik 3). Rregulla zgjedhore Nr. 15/2013. Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parakohshme. Prishtinë, Kosovë. E qasshme në: [http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/15\\_trbwdujpcm.PDF](http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/15_trbwdujpcm.PDF)

Komisioni Qendror Zgjedhor (2013, Korrik 3). Rregulla zgjedhore Nr. 15/2013. Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parakohshme. Prishtinë, Kosovë. E qasshme në: [http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/15\\_trbwdujpcm.PDF](http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/15_trbwdujpcm.PDF)

Komisioni Qendror Zgjedhor (2013, Korrik 3). Rregulla zgjedhore Nr. 13/ 2013 Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike. Prishtinë, Kosovë. E qasshme në [http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/13\\_siywfrtqbc.PDF](http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/13_siywfrtqbc.PDF)

Komisioni Qendror Zgjedhor (2015, Janar 23). Rregulla zgjedhore Nr. 14/ 2013 mbi Financimin e subjekteve politike dhe sanksionet. Prishtinë, Kosovë. E qasshme në [http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/14-2015\\_al\\_yzastrluki.PDF](http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/14-2015_al_yzastrluki.PDF)

Konventa Evropiane për Mbrotjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Strasburg:Këshilli i Evropës.

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. (1966).Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

Kosova Live (2014). Nisma për Kosovën mbajti tubimin e themelimit të saj. Prishtinë, Kosovë. Marrë nga: <http://www.kosovalive360.com/nisma-per-kosoven-mbajti-tubimin-e-themelimit-te-saj.html>

KQZ. (2015). Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Marrë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve: [www.kqz.org](http://www.kqz.org)

Krasniqi, A. (2014).Zgjedhjet Lokale në Kosovë 2013, Vështrim i përgjithshëm dhe rekomandimet për reformën zgjedhore. Prishtinë: KIPRED.

Krasniqi, Albert dhe Shala, Krenar. (2012). Fuqizimi i shtetësisë së Kosovës nëpërmjet demokratizimit të partive politike. (A. Arifaj, Ed.) Prishtinë, Kosovë: Kosovar Institute for Policy Research and Developmnet - KIPRED.

Krasniqi, Albert, dhe Shala, Krenar (2012) Fuqizimi i shtetësisë së Kosovës nëpërmjet demokratizimit të partive politike. (A. Arifaj, Ed.). Kosovar Institute for Policy Research and Developmnet. <http://goo.gl/XHx29F> (27.03.2015)

Krasniqi, J. (2015). Intervistë Verbale. (L. Peci, Intervistues) Prishtinë, Kosovë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008), Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008.

Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008). Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 15 Qershor 2008.

Kuvendi i Republikës së Kosovës (2014, Prill). Projektligji për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Prishtinë, Kosovë. I qasshëm në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-265.pdf>

Lajmi (2015). Në prag të Kuvendit zgjedhor tw LDK-së, ndarje e akuza për manipulime. Prishtinë, Kosovë. Marrë nga Lajmi.net: <http://lajmi.net/ne-prag-te-kuvendit-zgjedhor-te-ldk-se-ndarje-e-akuza-per-manipulime/%20LDK>

Lëvizja Vetëvendosje. Nis votimi për zgjedhjet e brendshme të Lëvizjes Vetëvendosje. Marrë nga: [http://www.vetevendosje.org/news\\_post/nise-votimi-per-zgjedhjet-e-brendshme-te-levizjes-vetevendosje/](http://www.vetevendosje.org/news_post/nise-votimi-per-zgjedhjet-e-brendshme-te-levizjes-vetevendosje/)

Lidhja Demokratike e Kosovës (2014, Mars). Këshilli i Ekspertëve. Programi Qeverisës i Lidhjes Demokratike të Kosovës. I qasshëm në: <http://www.ldk-ks.eu/public/uploads/pdf/tresh-1401819799.pdf>

Ligi Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale. Republikae Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale. Republikae Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme. Republikae Kosovës.

### **Databaza e Brendshme Krahasuese e KIPRED është krijuar nga:**

Lista e anëtareve të Këshillit Drejtues të PDK-së. Marrë nga: <http://pdk.info/sq-al/udh%C3%ABheqja/keshillid>

Lista e anëtareve të Këshillit të Përgjithshëm të LDK-së. Marrë nga: <http://www.ldk-ks.eu/Al/organizimi/kryesia/>

Lista e anëtareve të Kryesisë në LDK. Marrë nga: <http://www.ldk-ks.eu/Al/organizimi/keshilli-pergjithshem/>

Lista e Anëtareve të Kryesisë së LVV. Marrë nga: [http://www.vetevendosje.org/news\\_post/u-zgjedh-kryesia-e-re-e-levizjes-vetevendosje/](http://www.vetevendosje.org/news_post/u-zgjedh-kryesia-e-re-e-levizjes-vetevendosje/)

Lista e anëtareve të Kryesisë së PDK-së. Marrë nga: <http://pdk.info/sq-al/udh%C3%ABheqja/kryesia.aspx>

Lista e kandidatëve për deputet nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Marrë nga: <http://www.ldk-ks.eu/Al/lista-e-kandidateve-te-ldk-se/>

Lista e kandidatëve për deputet nga rradhët e LVV-së. Marrë nga: <http://melevizjen.com/?reqp=1&reqr=nzcdYzylM3WcpzSkLz3pv5vMKD>

Lista e kandidatëve për deputet nga rradhët e PDK-së. Marrë nga:

Lista e Koordinatorëve të Qendrave të LVV: Marrë nga: <http://www.vetevendosje.org/qendrat-e-vetevendosjes/>

Lista e kryetarëve të Degëve nga rradhët e LDK-së. Marrë nga: <http://www.ldk-ks.eu/Al/organizimi/deget/>

Lista e kryetarëve të Degëve nga rradhët e LDK-së. Marrë nga: <http://pdk.info/sq-al/ballina.aspx>

Lista të pranuarë përmes emailit: Lista e Kryetarëve të Degëve, anëtareve të Kryesisë, anëtareve të Këshillit Drejtues në AAK.

Malazogu, Leon, dhe Gautam, Brenna (2014) Busolla ideologjike e Kosovës. Friedrich Ebert Stiftung. Demokracia për Zhvillim. <http://goo.gl/ycwgho> (data e qasjes)

Malcolm, Noel (2002) Kosovo: A Short History. London: Pan Books.

Maliqi, A. (2011).Krahasimi i sistemeve zgjedhore në rajon. Prishtinë: KIPRED.

Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (2014) <http://goo.gl/Qj4sE5> (data e qasjes)

Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EOM) (2014, Korrik 7). Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë. Raporti Përfundimtar. Kosovë. I qasshëm në: [http://eeas.europa.eu/eueom/missions/2014/kosovo/pdf/eu-eom-kosovo-2014-final-report\\_sq.pdf](http://eeas.europa.eu/eueom/missions/2014/kosovo/pdf/eu-eom-kosovo-2014-final-report_sq.pdf)

NDI (2015).Tejkalimi i Pengesave për Pjesëmarrjen e Grave në Politikë. Prishtinë.

Network, T. E. (2012). Parties and Candidates. The Electoral Knowledge Network.

Organizata e Kombeve të Bashkuara (2004) Draft dokument – Plani i implementimit të standardeve për Kosovën <http://goo.gl/OnWecN> (data e qasjes)

OSCE, Political Party Guide (2000) Municipal Elections Kosovo, Department of Democratization <http://goo.gl/4agKXL> (data e qasjes)

Pack, Doris (2007) Ad Hoc delegation to observe the parliamentary elections in Kosovo. <http://goo.gl/Bj83Za> (data e qasjes)

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (2014). Vendimi A Nr. 54/2014. I qasshëm në: <http://pzap.rks-gov.net/repository/docs/5.Anr.%2054%20Vendim.pdf>

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (2014). Vendimi A Nr. 308/2014. I qasshëm në: [http://pzap.rks-gov.net/repository/docs/A308\\_Vendim.pdf](http://pzap.rks-gov.net/repository/docs/A308_Vendim.pdf)

Peci, L. (2015). Vendimmarja dhe politikbërja në partitë politike të Kosovës; Gratë, rinia, dhe komunitetet etnike. Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED). Qershor, 2015.

Programi i shkurtë i LVV-së. Parimet dhe prioritetet programore të Lëvizjes VETËVENDOSJE!. 100 pika që ndryshimi i Kosovës i bashkon. I qasshëm në:

[http://www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2013/09/programi\\_i\\_shkurte.pdf](http://www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2013/09/programi_i_shkurte.pdf)

Qeveria e Republikës së Kosovës (2014, Maj 23). Vendimet Nr.04/189, 05/189, dhe 12/189 të Qeverisë së Kosovës. Të qasshme në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_se\\_189-te\\_te\\_Qeverise\\_se\\_Republikes\\_se\\_Kosoves\\_2014.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_189-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2014.pdf)

Qeveria e Republikës së Kosovës (2014, Mars 10). Vendimi Nr.01/176 i Qeverisë së Kosovës. I qasshëm në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi\\_i\\_mbledhjes\\_se\\_176-te\\_te\\_Qeverise\\_2014.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi_i_mbledhjes_se_176-te_te_Qeverise_2014.pdf)

Qeveria e Republikës së Kosovës (2014, Mars 14). Vendimet Nr. 02/177, 03/177 të Qeverisë së Kosovës. Të qasshme në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi\\_i\\_mbledhjes\\_se\\_177-te\\_te\\_Qeverise\\_2014.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi_i_mbledhjes_se_177-te_te_Qeverise_2014.pdf)

Qeveria e Republikës së Kosovës (2014, Mars 18 ). Vendimet Nr.02/178, 03/178 të **Qeverisë së Kosovës. Të qasshme në:** [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi\\_i\\_mbledhjes\\_se\\_178te\\_te\\_Qeverise\\_2014.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi_i_mbledhjes_se_178te_te_Qeverise_2014.pdf)

Qeveria e Republikës së Kosovës (2014, Mars 28 ). Vendimi Nr.01/180 i Qeverisë së Kosovës. I qasshëm në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi\\_i\\_mbledhjes\\_se\\_180-te\\_te\\_Qeverise\\_2014.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi_i_mbledhjes_se_180-te_te_Qeverise_2014.pdf)

Qeveria e Republikës së Kosovës (2014, Prill 11). Vendimi Nr. 02 /182 i Qeverisë së Kosovës. I qasshëm në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi\\_i\\_mbledhjes\\_se\\_182-te\\_te\\_Qeverise\\_2014.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi_i_mbledhjes_se_182-te_te_Qeverise_2014.pdf)

Qeveria e Republikës së Kosovës (2014, Prill 18). Vendimi Nr.02/183 i Qeverisë së Kosovës. I qasshëm në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi\\_i\\_Mbledhjes\\_se\\_183-te\\_te\\_Qeverise\\_se\\_Republikes\\_se\\_Kosoves\\_2014.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi_i_Mbledhjes_se_183-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2014.pdf)

Qeveria e Republikës së Kosovës (2014, Prill 2). Vendimet Nr.17/181, 18/181, 19/181 të Qeverisë së Kosovës. Të qasshme në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi\\_i\\_mbledhjes\\_se\\_181-te\\_te\\_Qeverise\\_2014.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi_i_mbledhjes_se_181-te_te_Qeverise_2014.pdf)

Qeveria e Republikës së Kosovës (2014, Prill 22). Vendimi Nr. 02/184 i Qeverisë së Kosovës. I qasshëm në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi\\_i\\_Mbledhjes\\_se\\_184-te\\_te\\_Qeverise\\_se\\_Republikes\\_se\\_Kosoves\\_2014.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi_i_Mbledhjes_se_184-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2014.pdf)

Qeveria e Republikës së Kosovës (2014, Prill 25). Vendimet Nr.04/185, 07/185 të Qeverisë së Kosovës. Të qasshme në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi\\_i\\_Mbledhjes\\_se\\_185-te\\_te\\_Qeverise\\_2014.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi_i_Mbledhjes_se_185-te_te_Qeverise_2014.pdf)

Qeveria e Republikës së Kosovës (2014, Shkurt 5). Vendimi Nr. 01/169 i Qeverisë së Kosovës. I qasshëm në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi\\_i\\_mbledhjes\\_se\\_169-te\\_te\\_Qeverise\\_2014.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi_i_mbledhjes_se_169-te_te_Qeverise_2014.pdf)

Qeveria e Republikës së Kosovës (2014, Shkurt 5). Vendimi Nr.01/169 i Qeverisë së Kosovës. I qasshëm në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi\\_i\\_mbledhjes\\_se\\_169-te\\_te\\_Qeverise\\_2014.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi_i_mbledhjes_se_169-te_te_Qeverise_2014.pdf)

Rambouillet Accords (1999) Interim Agreement for Peace and Self-Government in Kosovo, <http://www.alb-net.com/kcc/interim.htm>

Republika e Kosovës (2008, Qershor 5). Ligji Nr. 03/L-072 për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës. Prishtinë, Kosovë.

Republika e Kosovës (2008, Qershor 5). Ligji Nr. 03/L-072 për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës. Ligji për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës. Prishtinë, Kosovë.

Republika e Kosovës (2008, Qershor 5). Ligji Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Prishtinë, Kosovë.

Republika e Kosovës (2008, Qershor 5). Ligji Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Ligji për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Prishtinë, Kosovë.

Republika e Kosovës (2008, Qershor 5). Ligji Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Prishtinë, Kosovë. I qasshëm në: [http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/ligji\\_per\\_zgjedhjet\\_e\\_pergjithshme\\_ne\\_republiken\\_e\\_kosoves\\_ibreqwhqh.pdf](http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/ligji_per_zgjedhjet_e_pergjithshme_ne_republiken_e_kosoves_ibreqwhqh.pdf)

Republika e Kosovës (2010, Nëntor 11). Rregullore Nr. 14/2009 Sanksionet dhe Gjobat. Prishtinë, Kosovë.

Republika e Kosovës (2010, Shtator 16). Ligji Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike. Ligji për financimin e subjekteve politike. Prishtinë, Kosovë.

Republika e Kosovës (2010, Shtator 16). Ligji Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike. Ligji për financimin e subjekteve politike. Prishtinë, Kosovë.

Republika e Kosovës (2010, Shtator 16). Ligji Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike. Prishtinë, Kosovë. I qasshëm në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-174-alb.pdf>

Republika e Kosovës (2013, Korrik 2). Rregullën Nr. 1/2013 për regjistrimin dhe veprimin e partive politike. Rregull për regjistrimin dhe veprimin e partive politike. Prishtinë, Kosovë.

Republika e Kosovës (2013, Korrik 2). Rregullën zgjedhore Nr. 8/2013 certifikimi i subjekteve politike dhe i kandidatëve të tyre . Certifikimi i subjekteve politike dhe i kandidatëve të tyre . Prishtinë, Kosovë.



Republika e Kosovës (2013, Korrik 2). Rregullore Nr. 1/2013 për regjistrimin dhe veprimin e partive politike. Prishtinë, Kosovë.

Republika e Kosovës (2013, Korrik 2). Rregullore Nr. 11/2013 Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politke, mbështetësit e tyre dhe kandidatëve. Prishtinë, Kosovë.

Republika e Kosovës (2013, Korrik 2). Rregullore Nr. 12/2013 përkufizimi i shpenzimeve të fushatës zgjedhore dhe deklarimi financiar. Prishtinë, Kosovë.

Republika e Kosovës (2013, Korrik 31). Ligji Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058. Prishtinë, Kosovë. I qasshëm në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20ndryshimin%20e%20ligjit%20per%20financimin%20e%20subj%20politike.pdf>

Rezultatet e Sistemit të Menaxhimit. (n.d.). [http://aceproject.org/ace-en/topics/vc\(26.03.2015\)](http://aceproject.org/ace-en/topics/vc(26.03.2015)).

Rregulla zgjedhore Nr. 03/2013 (2013a) Votimi jashtë Kosovës. KQZ.

Rregulla zgjedhore Nr. 04/2013 (2013b) Votimi i personave me nevoja dhe rrethana të veçanta. KQZ.

Saraqia, T. (2015). Interviste Verbale. (L. Peci, Intervistues) Prishtinë, Kosovë.

Scarow, S. (2005). Implementing Intra Party Democracy. Washington, U.S. : National Democratic Intitute - NDI.

Statuti i AAK-së.

Statuti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (2008) <http://goo.gl/cdWxYL> (data e qasjes)

Statuti i LDK-së. Prishtinë, Mars 2012.

Statuti i Lëvizjes Vetëvendosje! (2012) <http://goo.gl/NAuN6k> (data e qasjes)

Statuti i Lëvizjes Vetëvendosje. [www.vetvendosje.org](http://www.vetvendosje.org)

Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (2012) <http://goo.gl/VXIZOWf> (data e qasjes)

Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (2013) <http://pdk.info/Partia/Statuti.aspx>

Statuti i PDK-së. Prishtinë, 2013. Taagepera, R. (2007). Parashikimi i madhësisë së partive: Logjika e sistemit të thjeshtë zgjedhor. New York dhe Oxford: Oxford University Press.

Telegrafi (2014), KDTP dhe NISMA shkelin rregullat e KQZ-së. Prishtinë, Kosovë. Marrë nga: <http://www.telegrafi.com/lajme/kdtp-dhe-nisma-shkelin-rregullat-e-kqz-se-2-45493.html>

Telegrafi. (2015). Vetëvendosje i përjashton nga partia Ajnishahe Halimin dhe Arben Gecajn. Prishtinë, Kosovë. Marrë nga Telegrafi: <http://www.telegrafi.com/lajme/vetevendosje-i-perjashton-nga-partia-ajnishaha-halimin-dhe-arben-gecajn-2-61154.html>

The Constitution of the Republic of Kosovo, <http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Constitution.of.the.Republic.of.Kosovo.pdf>

The electoral Knowledge Network (2012) Parties and Candidates. ACE Project, <http://aceproject.org/ace-en/pdf/pc/view> (data e qasjes)

The UN Resolution 1244 (1999), <http://www.refworld.org/cgi-bin/texis/vtx/rwmain?docid=3b00f27216>

Uebfaqja zyrtare e LDK-së(2014, Korrik 23). Raporti Financiar i Fushatës së Subjektit Politik për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme Nacionale 2014. Lidhja Demokratike e Kosovës. I qasshëm në: <http://www.ldk-ks.eu/public/uploads/pdf/tresh-1406471166.pdf>

Uebfaqja zyrtare e LVV-së (2014, Korrik). Raporti Financiar i Fushatës së Subjektit Politik për Zgjedhjet e Përgjithshme 2014. Lëvizja Vetëvendosje. I qasshëm në: <http://www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2013/09/Raporti-financiar-Zgjedhjet-e-pergjithshme-20141.pdf>

Vizion Plus (2014) Kosovë, historiku i zgjedhjeve, <http://vizionplus.al/kosove-historiku-i-zgjedhjeve/> (data e qasjes)

Weller, Marc (2008). The Vienna negotiations on the final status for Kosovo International Affairs 84: 4 659–681 <http://www.iss.europa.eu/uploads/media/cp114.pdf> (data e qasjes)

Xhemaj, Bashmir (2012) Reforma Zgjedhore: Demokracia tek zonat dhe listat? Instituti i Prishtinës për Studime Politike. <http://goo.gl/tjwi0S> (data e qasjes)

Zëri (2013) Kamishi thyen rregullat e KQZ-së. Prishtinë. Kosovë. Marrë nga: <http://old.zeri.info/artikulli/36179/kamishi-thyen-rregullat-e-kqz-se>

Zëri (2014, Maj 14). Drejtoresha e “Kosova Sot”, Margarita Kadriu, bëhet nënkryetare e PDK-së. Marrë nga: <http://old.zeri.info/artikulli/34231/drejtoresha-e-kosova-sot-margarita-kadriu-behet-nenkryetare-e-pdk-se>

Zëri (2015) Zgjedhjet në LDK; Isa Mustafa zgjidhet kryetar. Marrë nga <http://www.zeri.info/aktuale/35135/live-zgjedhjet-ne-ldk-isa-mustafa-zgjidhet-kryetar-foto-video/>

Zëri i Amerikës (2010) Shpallen rezultatet paraprake të zgjedhjeve parlamentare në Kosovë, <http://goo.gl/RKd33U> (data e qasjes)

Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike (2006).Manual për vëzhgimin e Zgjedhjeve: Botimi i pestë. Varshavë: OSBE.

## Lista e tabelave

**Tabela 1:** Partitë garuese në zgjedhjet qendrore, 2014

**Tabela 2:** Partitë e përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës bazuar në rezultatin e zgjedhjeve të fundit qendrore, 2014

**Tabela 3:** Sistemi zgjedhor i Republikës së Kosovës

**Tabela 4:** Prezantimi i zgjedhjeve të përgjithshme nga viti 2001 deri në 2014

**Tabela 5:** Kimi i nivelit lokal në nivelin qendror

**Tabela 6:** Pikëpamjet programore të subjekteve politike në pesë fusha

**Grafiku 1:** Përqindja e deputetëve të zgjedhur falë listave të hapura në zgjedhjet e vitit 2010 dhe 2014.

**Grafiku 2:** Gratë deputete të zgjedhura në Kuvend 2007 - 2014

## KONTRIBUTET

### Mentor Agani

Mentor Agani është hulumtues i lartë në Institutin Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave - KIPRED. Para se të bashkangjitej si hulumtues i lartë, z. Agani ishte Kryetar i Bordit të Drejtorëve të KIPRED-it. Ai është po ashtu edhe ligjërues në Departamentin e Sociologjisë dhe në Departamentin e Shkencave Politike, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës, si dhe në Kolegjin Universitar Dardania - Departamenti i Shkencave Politike dhe i Administratës Publike.



Z. Agani i ka mbaruar studimet e doktoraturës në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin Filozofik, Departamenti i Sociologjisë (2012-2009), me tezën e doktoratës: Gellneri dhe Andersoni për kombin dhe nacionalizmin. Ai e ka patur po ashtu bursën Fulbright për studimin hulumtues “Revolucioni francez dhe ai amerikan në veprën e Alexis de Tocqueville” në Universitetin e Harvardit (2006-2007). Z. Agani e ka titullin master në Çështjet Shtetërore dhe Ndërkombëtare nga Universiteti i Pitsburgut, GSPIA, dhe po ashtu titullin master në Elektronikë dhe Telekomunikacion (1996).

### Gent Gjilkolli

Gent Gjilkolli është i angazhuar në kërkimin dhe zhvillimin e politikave që ndërlidhen me marrëdhëniet ndërkombëtare, çështjet e sigurisë, si dhe partitë politike.

Përvoja profesionale e Gentit është e lidhur kryesisht me sektorin e shoqërisë civile, duke përfshirë edhe kontributin trevjeçar në sektorin publik. Që nga



viti 2012, Genti është pjesë e Institutit KIPRED, ku angazhimin kryesor e ka pasur në hulumtimin e marrëdhënieve të Kosovës me vendet rajonale, dhe tani është i angazhuar edhe në programet e demokratizimit të partive politike si dhe në hulumtimin e çështjes së sigurisë së vendit.

Studimet Bachelor i ka përfunduar në Ankara University, në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe tash është duke vijuar studimet e magjistraturës në po të njëjtin universitet dhe drejtim.

## **Albert Krasniqi**

Albert Krasniqi i është bashkangjitur KIPRED-it që në vitin 2007, ku përveç hulumtimeve në fushën e politikave publike, merret edhe me menaxhim e projekteve dhe me trajnime për demokratizim të brendshëm të partive politike.

Gjithashtu, ai ka qenë pjesë e ekipit të KIPRED-it në mbështetje të Kuvendit të Kosovës për themelimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, dhe ngritjen e kapaciteteve të këtij komisioni. Studimet për BA në Filozofi, Alberti i ka kryer në Universitetin e Prishtinës, ku edhe është në përfundim të studimeve për MA në Shoqëri Civile dhe Zhvillim Lokal. Alberti është certifikuar si Vëzhgues afat-shkurtër i zgjedhjeve nga OSCE/ODIHR, për Asistencë efektive zgjedhore nga EC dhe UNDP, si dhe për Vëzhgim të Zgjedhjeve nga BRIDGE.



## **Blerim Murtezi**

Blerim Murtezi është pjesë e stafit hulumtues në Institutin Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave - KIPRED që nga viti 2013. Blerimi është i fokusuar në programin për subjektet politike dhe zgjedhjet, dhe në programin për marrëdhënie me jashtë dhe siguri. Studimet Bachelor i ka përfunduar në fushën e Administrimit Publik, dhe gjithashtu ka ndjekur studimet në Gjuhë dhe Letërsi Angleze në Universitetin e Prishtinës. Studimet Master me fokus të veçantë në fushën e Politikave Publike do t'i përfundojë pranë Universitetit të Arkansas në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



## Violeta Haxholli

Violeta është hulumtuese në Institutin Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave – KIPRED. Fokusi i saj primar brenda institutit janë zhvillimi i politikave publike, sundimi i ligjit dhe integrimi evropian. Para se t'i bashkohej KIPRED-it, Violeta ka bërë praktikë në Kuvendin e Republikës së Kosovës në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, në projektin për Fuqizimin e Kuvendit të Kosovës i financuar nga USAID-i dhe i zbatuar nga NDI (Institut Kombëtar Demokratik).



Violeta ka përfunduar studimet “Bachelor” në Shkenca Politike në Universitetin e Prishtinës (2009-2012). Ajo tani është duke ndjekur studimet master në Universitetin e Prishtinës, në programin Integrimi Evropian dhe Administrata Publike. Përveç kësaj, ajo ka përfunduar disa programe akademike të ofruara nga disa OJQ lokale dhe organizata ndërkombëtare, si Programin Veror të ofruar nga Universiteti Amerikan në Kosovë, Shkolla për Integrim Evropian e organizuar nga KFOS dhe KCSE, Akademia Politike nga FES etj.

### *Ky punim u editua nga:*

## Lulzim Peci

Lulzim Peci ka fituar titullin e M.A. në Marrëdhëniet Ndërkombëtare në Institutin Universitar Ortega y Gasset në Madrid (Spanjë). Ai është themeluesi kryesor dhe Drejtor Ekzekutiv i KIPRED-it. Në të kaluaren, z. Peci ka shërbyer si Ambasador i Kosovës në Stockholm nga dhjetori 2009 deri në qershor të vitit 2013.





Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

324(496.51)

Sistemi zgjedhor dhe partiak në Kosovë : perspektiva e zhvillimit të demokracisë brendapartiake / redaktor Lulzim Peci. – Prishtinë : KIPRED, 2015. – 137 f. : ilustr.; 23 cm.

Literatura : f. 115-132

1. Peci, Lulzim

**ISBN 978-9951-14-049-2**











**BALKAN COMPARATIVE  
ELECTORAL STUDY:**  
IMPACT OF PERSONAL VOTE  
ON INTERNAL PARTY DEMOCRACY

ISBN 978-9951-14-049-2



9 789951 140492